Rrallë në jetë mund të ndodhë të njohësh një njeri aq të këndshëm dhe erudit sa Vladimir Marku. Jashtë të gjitha konvencioneve dhe manive tipike shqiptare të të dukurit, Ladi përpiqet të japë e të marrë gjithçka është jetësore në marrëdhënie me njerëzit. I panegociushëm si edhe në këtë libër, realist e kompromentues.

Mimoza AHMETI



Vladimir Marku

Polonia, Unë

Dhe

Bjondet

(Libër alternativ)

Tiranë 2007

Vladimir Marku

Polonia, unë dhe bjondet

(Pasi të lexohet ky libër, në Shqipëri do të ketë modë floku në përputhje me personalitetet e vajzave)

Kariera e gruas është burri.

Tiranë 2007

Autori : Vladimir Marku

Titulli: Polonia, unë dhe bjondet

Redaktimi letrar: Lirka Mata

Redaktimi gjuhësor: Lirka Mata

© Vladimir Marku

Shtypur në shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese “Marlin Barleti”

Polonia, unë dhe bjondet

Poloni, Mragowo, Guesthouse “Edita”.

Nga i njëjti autor:

Fjalori i Naftës (Anglisht – Shqip)

A – Z of Vladimir (poems)

Kapitulli i Fundit – Roman

The Last Chapter – novel

Mona Liza qan – poezi

Unë dhe ti – poezi

Sikur ta dija – poezi

Libri i fallit

Libri i magjisë

Ky libër do të më bëjë me armiq. M'u bë vonë!

"Le të jem i krimbur në mëkatin e të qënit krenar" - Amal

“Ngjyra e flokut është zjarri i shpirtit.”

McCracken

Rregulli 26: Në një bisedë me një femër, për femrat, mashkulli duhet, shprehimisht, ta përjashtojë bashkëbiseduesen, dhe çfarë i përmban asaj libri i shtëpisë, nga çdo përgjithësim jo të këndshëm që ai u bën femrave. Ato nuk e ndjejnë veten mjaftueshëm të përjashtuar nga fjala ‘përgjithësim’.

Matematika e romancës

Burrë i zgjuar + grua e zgjuar = romancë

Burrë i zgjuar + grua debile = marrëdhënie e shkurtër seksuale

Burrë debil + grua e zgjuar = martesë

Burrë debil + grua debile = shtatëzani

Në vend të parathënies

Amal, do të përpiqem t'u përgjigjem pyetjeve tuaja me disa komente. Gratë e kanë të vështirë të jenë të hapura, të sinqerta, transparente me burrat sepse ato janë të dobta, të brishta (vulnerable). Të qënit vulnerable është shumë e rrezikshme për femrën prandaj **ato i manipulojnë përgjigjet.**

Jo vetëm me burrat ato janë të tilla, por me këdo. Gruaja është vulnerable në më shumë drejtime se një. Ajo është e tillë fizikisht dhe emocionalisht. Ne gratë rrezikojmë shansin tonë, rrezikojmë të humbasim burrin tonë që mund të "rrëmbehet" nga një grua që ka pamje më të mirë. Shoqëria dhe televizioni e manipulojnë gruan që ajo të ndihet në këtë mënyrë. Gruaja me figurën më të mirë dhe më e bukura zakonisht e fiton BURRIN. Mendoj se është e vështië të shikosh tej këtyre gjërave artificiale.

Unë i vlerësoj fjalët e mira që thua për gratë, por gratë, pjesa më e madhe e tyre, janë krijesa shumë të pasigurta dhe **bëjnë lojëra me burrat** për të fshehur pasiguritë e tyre. Me këtë dua të them se **NE nuk jemi të ndershme me ta për veten tonë nga frika se bëjmë ose lemë një përshtypje të keqe tek ta.**

Besoj që edhe burrat mund të jenë të tillë. Thënia e preferuar e burrit tim ishte "Jeta është thjesht një lojë". Unë kam parë në pakot e lodrave të fëmijëve një copë pusulle që thotë "Kush ka më shumë lodra, fiton lojën e jetës". Zëvendësoni fjalën lodra me fjalën grua. Gratë e dinë se si janë shumica e burrave dhe ato i ulin standartet e tyre vetëm e vetëm për ta patur ATË. Edhe unë e bëra një gjë të tillë dhe jam penduar. Jo më.

Ti Amal më pyet: “Vulnerable për çfarë? Frikë nga kush dhe për çfarë? Çfarë fitojnë gratë në fund të fundit nga kjo?”

Mendoj se unë jam një shembull i mirë i asaj se çfarë fitojnë. Nuk fitojnë asgjë. Burri im thoshte: “E kush mund ta kuptoj një grua?”

Mendimi im është se burrat dhe gratë janë krijuar për të plotësuar njeri tjetrin. Nëse dikujt i mungon diçka tjetri e kompenson. Gratë kanë shumë gjëra që u mungojnë, por burrave u nevojitet kjo grua për t’u balancuar. A kanë kuptim këto për ty, Amal?

Ti Amal më pyet se përse duhet që një ëndërr të jetë gjithmonë më e mirë se realiteti, duke pranuar se është e vërtetë dhe e dhimbshme. Besoj që ne jemi të gjithë egoista, kush më shumë e kush më pak. Nuk do të jemi kurrë perfekt pavarësisht nga përpjekjet që bëjmë, por ama ka qënë një person i vetëm perfekt. (Besoj se e ka pasur fjalën për Jesus Christ – shën.im).

Doris – USA (Kentucky)

Dita e parë

Lajkatare më je

Në dritare më sheh

Sa me qejf këndonte i ziu për atë që kishte humbur! Jashtë binte shi i imët. Nuk e shihja, por e dija që binte tinëzisht. Nga xhameria e ballkonit shikoja pyllin dhe liqenin në rrëzë të tij. Shikoja poshtë pishinën blu që miklohej nga pickimet e shiut. Sa shtruar e kishte marrë! O shi, nuk erdha në Poloni dhe në këtë vend të fshehur mes pyjeve e liqeneve në majë të një kodërze, diku në veri, që të rri brenda. Ja e lexova Kodin për një ditë, po tani? Nuk mora libra

me vete, sepse planet e mia kishin qënë më të guximshme, me aksione thriller, tip “Amal”, ku do ta pësonin shumë peshq e do të turpëroja shumë peshkaxhinj.

Në fakt m’u dhanë ca shenja. Vizën e mora fol e qesh, madje falas. Ambasada të tjera të ashtuquajtura të vendeve të qytetëruara pasi të ‘qajnë’ një sasi të konsiderueshme Eurosh që në aplikim, të thonë pas një jave, jo, nuk të thonë gjë, por të sikterisin që te porta e jashtme me një vulë në pasaportë « Refuzohet ». Asnjë shpjegim bindës. Eurot, për arsye të pakapshme edhe nga mendja më racionale, nuk të kthehen, duke kontribuar në ca piramida të fshehura. Unë e quaj racizëm të pastër dhe genocid, por meqënëse kemi një pushtet të popullit dhe për popullin, nuk ka kush të ngrejë zërin për këtë shtresëzim të specieve, sepse janë të zënë me qepje brekësh të shqyera. Ndërkohë ne largohemi nga portat e disa ambasadave si qen të rrahur e të grabitur, në mes të ditës, me kulturë, nga drejtësia e kollarisur. Tani, ca ambasada kanë mësuar edhe përrallat tona dhe i përdorin kundër nesh. E dini atë përrallën e gomarit dhe ujit të ngrohtë e të ftohtë ?

- I ke dhënë ujë gomarit sot ? (e kap prej veshi)
- Po.
- Ç’ujë i ke dhënë?

Dhe sidoqë të përgjigjesh, të ftohtë apo të ngrohtë, ai që të ka kapur prej veshi, zakonisht një më i madh, që është mjeshtër në shkulje veshi, ta jep veglën e audios në dorë. Po ashtu, nëse nuk ke para, nuk të jep kush vizë, por, edhe në ke shumë para të vërtetueshme, përsëri nuk ta japin vizën. Kur nuk ke, do të rrish atje të gjesh një punë. I pabesueshëm. Kur ke, do rrish atje, se ke para për të ndenjur. I pabesueshëm.

“Sie haben Ihren Willen zur Rückkehr nicht hinreichend deutlich gemacht.”

“Sie haben bei der Antragstellung unschlüssige Angaben zu Ihrem Antrag gemacht.”

Pavarësisht se ke një ftesë të ligjshme e të rregullt nga Panairi Ndërkombëtar i Librit në Frankfurt, je Drejtor Didaktik në një qendër të sukseshme gjuhësh, je anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë me shtatë libra, brenda dhe jashtë vendit, ke financa të respektueshme, ke qënë në Gjermani edhe dy herë të tjera, ke punuar për kompanitë gjermane të naftës, ke qënë në Amerikë, Angli, Austri …, paguan sigurimin shëndetësor për udhëtimin, rezervon fluturimin, rezervon hotelin etj etj., përsëri je i pabesueshëm. Shajzen!

Deri në Rinas çdo gjë vajti fjollë, por në Rinas na u desh të prisnim ca, kështu që u nisëm me vonesë. Piloti i dha ca gaz, por prapë ishim vonë. Prapa kisha një familje shqiptarësh me fatin tim të keq, dy kalamaj të vegjël të këqinj, që ma zunë sanduiçin e avionit në fyt. Sa të këqinj janë kalamajtë e vegjël sot! Dikur ne ishim të urtë, aq të urtë sa mamaja na thoshte « Sa më shumë rriteni, aq më shumë dhiteni » Kjo tregon ama që të vegjël ishim të urtë. Kurse këta, veç zgurdhës së lartë, gjuajnë edhe me shqelma prapa kolltukut tim. Desh u ngrita për pak që të bërtisja ‘Mbaje o shofer se do zbres’. Kur haja atë sanduiçin e varfër m’u kujtuan ca kohë jo shumë të largëta kur fluturimi me avion ishte festë e vërtetë, me stjuardesa të bukura që të luteshin e vinin me radhë të të sillnin pije e dhurata. O zot!

Budapesti nuk më zhgënjeu, madje më priti si VIP të vërtetë, me furtunë e stuhi, siç më kishte pritur edhe pesë herë të tjera më parë. Avioni i shkretë shkundej nga furtuna aty mbi pistë dhe nuk ja mbante bishti që të ngrihej. Ishte një avion i vogël, tip i padëgjuar nga unë.

Shpresoj të jemi vonuar nja një orë aty. Bravo Budapesti, mik si gjithmonë. Hej, po lajmi më i keq ishte fshehur përsëri prapa. Mooos! Dy shtriga greke! Çfarë të kam bërë, o zot, që më ndëshkon kaq rëndë? Ato, nuk e di se nga kishin dëgjuar atë thënien që po të qeshësh të zgjatet jeta, por si duket të përpunuar. Po të qeshësh kot e me zë sa më të lartë, kilometrat e jetës të shtohen katërfish dhe ato kishin vendosur të bëheshin të pavdekshme në kurrizin tim. Vdekshi ishallah! I uroja me zemër. Ndërsa ato i shtonin vetes dekada. Kalova të gjithë arsenalin e sharjeve të turpshme në greqisht (të paturpshme nuk di) në mendjen time, por, pas çdo sharjeje, krakërimat e të qeshurave të tyre bëheshin gjithmonë e më sfiduese. U nervangrita shumë. Bushtrat! Gjitonet e qenit, nuk më lanë rehat as këtej. Edhe frika nga fluturimi gjithë kohën mes reve të nxira nuk ma hoqi acarimin, por ama ua hoqi atyre paksa të qeshurat. Sanduiçin e dytë, akoma edhe më i varfër se i pari, e hëngra pa qejf, për konformitet.

Kur zbarkova, më në fund, thashë shpëtova nga peripecitë. Nuk prisja të më priste njeri këtej kontrollit të pasaportave. Gabova. Unë vdes të gaboj. Konsullja kishte përdorur kartën diplomatike për të hyrë e për të dalë sëbashku shpejt e shpejt. Ho mi, i thashë. Pritëm çantën e cila mbriti qull nga shiu sikur të kishte qënë mbi avion. Obobo librat, thashë, se rrobat punë e madhe. Kisha marrë ca kopje nga librat që kam shkruar për t'ua dhuruar bibliotekës kombëtare në Varshavë dhe universitetit ku bëhej edhe shqip.

Aeroporti "F. Shopen" i Varshavës është shumë afër qytetit dhe mbritëm shumë shpejt. Çfarë prisja të shihja nga Varshava? Një kryeqytet lindor? Jo Budapestin, se ai ha bukë veç andej nga perëndimi.

- Ku i keni plehrat nëpër rrugë? - pyeta Valin. Ajo qeshi.
- Mos kërko kot, tha.

Shtëpia e saj ishte pranë ambasadës, në një lagje periferike. Nuk po u besoja syve nga çfarë po shikoja. Model rregulli, disipline, pastërtije, organizimi e blerimi. Që të hyje në lagjen ku shoqja ime kishte shëpinë, taksia që kishim marrë duhet të kalonte një postbllok me roje me uniformë dhe një tra me kod. E gjithë lagjja ishte e rrethuar me kangjella dhe kishte disa pika hyrjeje, të gjitha me porta me kod sigurimi. Çfarë bëhet kështu? As e kisha dëgjuar dhe as e kisha parë këtë gjë diku, pavarësisht se kisha dëgjuar shumë. Lagje të rrethuara me kangjella, kode sigurimi, roje sigurimi, lulishte. E përkryer.

- Çdo lagje kështu është?
- Po, më tha. Çdo lagje. Dhe çdo pallat është gjithashtu me kod hyrjeje.

Do të shihja më vonë edhe parqe të mëdhenj, me liqene të vegjël, me pista e teleferikë për dëborën e dimrit. U mahnita.

Refuzova një darkë jashtë nga pjesa e vjetër e qytetit. Në mëngjes u ngrita me një dhimbje therëse koke të stilit 24 orësh. Ku ma gjeti atë ditë që do të udhëtoja rreth katër orë me autobuz. Kur më dhemb koka jam njeriu më i mërzitshëm në botë që ua prish edhe të tjerëve ditën. Dola nga parku pranë duke ecur ngadalë, që të mos trondisja trurin që ishte mbledhur e përplasej pas qosheve të kafkës. Ka qoshe kafka? Se mos e di njeri. Një çun po peshkonte në liqen. Dy burra peshkonin matanë liqenit. Meqënëse unë kam lindur me fat për të tjerët, çuni zuri goxha peshk. Oh, sa u gëzua polaku i vogël! Peshku refuzonte të ngordhte, kështu që i dhashë qeskën e Saulit që kisha me vete. Pastaj, matanë bregut, u duk një burrë me një kartë në gjoks, sigurisht roja i parkut, e mes tij e çunit u bë një dialog që zgjati rreth njëzet minuta, nga të cilat kuptova që peshkimi kishte rregulla përderisa djali ngriti peshkun lart për të

treguar sa i madh ishte. Pastaj ai e pyeti çunin, ‘Po kolegu yt, po peshkon? “Ik ore pirdhu”, thashë me vete. Jo, i tha çuni, është i huaj, thjesht po shikon.”

“Dëgjova që po flisnit anglisht, ti ku di anglisht,” - pyeti roja.

“Jam në gjimnaz”, tha çuni.

Roja i dha një afat kohor dhe iku. Çuni e hodhi kallamin edhe nja dy herë në ujë dhe, pasi mblodhi anglishten e tij të dy vjetëve, tha: “I go to home, sorry!” Unë ia korrigjova fjalinë me mend. Pastaj erdhën të më marrin. Ndërkohë dhimbja e kokës po bëhej e padurueshme dhe ne kishim bërë plan supermarketin për ndonjë gjë që do të më duhej në Mragowo. U ula në një stol. Stol i huaj, në një park të huaj, të një kryeqyteti të huaj që nuk e kisha menduar kurrë se ndonjë ditë do të isha aty me një dhimbje koke dymbëdhjetë ballëshe. Truri im nuk mendonte shumë gjëra, vetëm ato bazë, jetësoret. Një çast thashë ta shihja veten nga ndonjë satelit atje lart. Le që nuk kisha marrë syzet me vete.

U kthyem ngadalë për në shtëpi. Pavarësisht se nuk mendoja shumë, truri im regjistronte gjithshka që shikonte. Autobuzi nisej në tre e gjysëm mbasdite. Ishte një furgon komod 20 vendesh. Bileta për të udhëtuar 250 kilometrat deri në vend ishte rreth 13,000 lekë të vjetra.

Me dhimbje koke, por njerëzve u hodha një sy. Të gjithë çilë, kokëbardhë. Sa maskarenj ata ushtarët gjermanë gjatë luftës së dytë botërore. Çil nga flokët dhe sybardhë. Më thanë se polakët janë të ftohtë, madje të ruhesha se rusin nuk e kishin qejf. Për gjermanin vdisnin. Hëm! Po ç’gjuhë do t’u flisja unë atyre? Shqip, jo. Anglisht, jo. Çobançe, jo. Rusishten e kanë inat. Gjermanisht unë dija plot, por të gjitha ato që dija do të më futnin në bela në një farë mënyre. Po t’u thosha “Volën zi ajn glas vain”, e ku kisha takat unë t’u jepja verë kur ata të shpërthenin “Ja, ja!” Ose sikur të thoshja Hajl Hitler apo Kaput Hitler, dija unë se me kë kisha të bëja? Po vallë do ta kuptonin ata dialektin tim akademik: Shlifen, puften, mutten”? Sidoqoftë, meqënëse duart dhe këmbët i kisha, vendosa të mos e vrisja mendjen shumë.

Kur hymë në zonën e liqeneve Mazuri, m’u mbajt fryma nga mrekullia që pashë. Udhëtonim mes pyjeve me dritat ndezur. Zoot, thashë, ozon me bollëk. Oksigjen nga cilësia më e lartë. O me dysh të madh.

Dhe kjo rrugë e mrekullueshme nuk mbaronte kurrë, as pasi mbrita në qytetin Mragowo, në brigjet e një liqeni. Aty mora një taksi e cila për pesë minuta më çoi në shtëpinë e miqve “Edita”, në periferi. Më prisnin. U mora vesh për mrekulli dhe hyra në dhomën time, ballkoni i së cilës shikonte nga një pishinë me një kaltërsi vezulluese, një liqen i vockël më poshtë kufizohej nga pemë të larta. Koka kishte filluar të më linte, sepse rrugës piva një Redbull. Në orën tetë PM bëra një telefonatë, bëra një dush dhe ja futa gjumit. Fundja tre kanalet e vetme televizive nuk ofronin gjë. Madje ishte qesharake. Filmi i huaj as nuk kishte titra e as nuk dublohej, por i njëjti zë burri lexonte përkthimin e të gjithë personazheve. Edhe të grave. Harrova të them, në Shtëpinë e Miqve isha unë dhe një togë sulmi gjermane sekspërzier. Plasi muzika dhe ahengu. Duke e ditur veten më të fisëm nuk denjova të përzihem. Dhe ja ku isha shtrirë duke medituar për ca dukuri të çuditshme. Disa ligje universale sikur të jenë qendisur me dorë kundër njeriut:

- Kur je duke bërë një punë të pistë dhe duart i ke tërë graso deri në bërryl, të ha hunda, të vjen miza ose të bëhet urina.
- Kur je duke montuar diçka dhe të bije një dado, vidë apo çfarëdo, ajo gjëja që bije do të rrokulliset në vendin më të pakapshëm të mundshëm.
- Probabiliteti që dikush do të të shikojë është në raport të drejtë me budallallëkun e asaj që po bën.
- E keni vënë re se sa herë që i bini një numër telefoni gabim, ai asnjëherë nuk del i zënë?
- Nëse e gënjeni mësuesin ose pronarin lidhur me vajtjen vonë, të nesërmen ajo gjë do të të ndodhë vërtet.
- Në një trafik të rënduar e të ngadalshëm, ndodh gjithmonë që në korsinë tuaj radha e makinave mezi lëviz.
- Pasi keni hyrë në vaskë apo në dush dhe jeni i lagur, bie zilja e telefonit.
- Probabiliteti që dikush i njohur t'ju dalë përpara rritet, kur jeni me dikë me të cilin apo me të cilën ju nuk doni që t'ju shohin.
- Kur ju doni t'i provoni dikujt se diçka nuk funksionon, ajo diçkaja për dreq funksionon.
- Shkalla e kruarjes në trupin tuaj rritet me rritjen e pamundësisë për ta kruar atë.
- Sapo uleni që të pini një kafe ose çaj, bosi ju kërkon të bëni diçka që zgjat aq sa kafja ose çaji të ftohet.
- Shanset që t'ju bjerë një gjë e pistë nga dora mbi një tapet rriten në raport me sa i ri apo sa i shtrenjtë ka qënë tapeti.
- Sapo shikoni ujin e dushit që rrjedh ose hyni në ujë në det, ju vjen për të bërë urinën; dhe e bëni, prandaj sa hyn turma e njerëzve me vrap në det, për nja 20 sekonda ngrijnë të tërë.

Dita e Dytë

Mëngjes fantastik. E mbusha mullën plot, aq më tepër që mëngjesi është në çmim. Pastaj dola për rikonjicion. Eksplorova çdo skutë e çdo cep dhe lexova Kodin deri në drekë se më zuri prapë koka. Pabesi! Mbasditja iku si në kllapi, ku u bëra një personazh i paparashikuar kundër priftërinjëve. Madje isha unë që e distraktova komisarin në një çast delikat. Por kur më doli Silasi përballë, u zgjova i tmerruar. Vajta prapë atje në copën tjetër të gjumit. Isha kurioz të

shikoja dokumentat e fshehura të Madalenës, por Don Brown e drodhi në fund, kështu që ku ishe, asgjëkundi. Ai Doni ka tallur ca gjëra sa është kënaqur me ne. Më interesonte shumë ajo temë. Vërtet besoj se ka të vërteta të fshehura. Një mik më tregoi një ditë një medalion floriri që e mbante në qafë me thënien muslimane ***Bismilahi Rrahmani Rrahim*** në arabisht, nga e djathta në të majtë, dhe portreti i Krishtit. Krishti dhe thënia myslimane. Pastaj m'u kujtua një debat në një kanal televiziv italian midis një grupi shkencëtarësh dhe fetarësh. I nxehtë dhe i papajtueshëm debati. Krishti dhe Muhameti kanë qënë i njëjti person. Ndryshe nga ç'mendojnë fetarët, unë e ndaj fenë nga fetarët, besimin nga institucionet, të vërtetën nga interpretimet, besoj se po të jetë kjo gjë e vërtetë, po të dalë kjo gjë në shesh, bota, pas një çoroditjeje të domosdoshme, do të kthjellohej dhe, o zot, do të ishte shumë më mirë. Oponenca le të jetë në sfera të tjera.

Në një firmë sharre turke, para disa vitesh, e cila importonte trungje pemësh nga Afrika, ndodhi çudia që shumë pak veta e dinë. Gjatë punës për çarjen e një trungu në mes për prodhim dërrasash, punëtori pa një çudi. Në mes të trungut, brenda, sikur të ishte pikturuar me pirografi, ishte portreti i Krishtit, që u dallua nga të gjithë dhe nuk linte shteg për interpretime, dhe thënia muslimane në arabisht, nga e djathta në të majtë: ***Bismilahi Rrahmani Rrahim***. Ky trung është ruajtur në Turqi dhe mund ta vizitojë gjithkush. Ka edhe foto të tij, por që zhduken kur bien në duar autoritetesh muslimane. Interpretimi? Nëse Krishti ishte biri i zotit, një njeri me aftësi të jashtëzakonshme, gjë që unë e besoj, mundej të bënte mrekullirat për të cilat flitet atëhere përse do ta kishte të vështirë të udhëtonte në kohë e të paraqitej si Muhameti? Të gjithë e dinë se Muhameti nuk ka një portret të ruajtur. Përse? Ka shpjegime, por jo arsye. Krishti dhe Muhameti kanë qënë një. Zoti deshi ta bëjë këtë gjë të ditur dhe e bëri duke e dërguar mesazhin në mes të trungut, por nuk duan institucionet. Të kundërtat vërtet i çojnë gjërat përpara se edhe bërthama e atomit funksionon në këtë mënyrë, por nga unitet i të kundërtave feja kalon në antagonizëm që prish barazpeshimin e energjisë. Hollë hollë, në inventarin e fesë nuk kanë mbetur shumë gjëra sepse ato kanë emigruar drejt shkencës. Pra, enë komunikuese. I bie që si feja ashtu edhe shkenca të flasin për të njëjtën gjë, por një është konservator dhe tjetri liberal. Kur do ulen që të pinë kafe sëbashku? Kush i futi kodet në Bibël? Nga e dinin se çfarë do të ndodhte? Përse nuk ka kode në Kuran? Apo ka? A mos sepse ishin në Bibël dhe Krishti dinte se çfarë bënte? Ah, more zoti Brown, na i jep ato dokumentat e Madalenës.

Nga darka vonë erdhi zonja e më tha se ishin interesuar për mua në telefon. Nuk e dinin që unë haja dynjanë shtrirë. E kështu nuk fola dot në telefon me njeri. Nga darka vonë u qetësova nga koka dhe mbarova Kodin nga ora 1 e mesnatës.

Dita e Tretë

Oiiii, shi. Le të kthehemi ku e nisa në fillim. Pra, brenda. Ç'të bëj? Atëhere m'u kujtua se kam bërë në mendjen time ca regjistrime në Varshavë. E kthej mbrapsht shiritin. Wow! Më

kujtohen vajzat polake. Të ‘shkretat’ vajzat polake! Të tëra si provinciale, pa kulturë, pa argëtim. Si ka mundësi? Asnjë për be me gjoks jashtë. E kanë bërë me fjalë, spekulloj. Asnjë për be me barkun e kërthizën jashtë dhe pantallonat e ulura. Jooooo, ulërij! Ka një gjë që nuk shkon. Nuk më kapi veshi asnjë hip – hop gjëkundi. Çfarë bëhet? Pyeta për disko. Më thanë shkohet me raste. Shkonin më shumë në pubs ku kërcenin muzikën e tyre. Atëhere gjithë ‘vrer’ them se këtyre vajzave ‘injorante’ polake u duhen sjellë nja 1000 fierake t’u mësojnë ç’është jeta, ç’është modernja, si jetohet e tashmja, si kapet momenti, se njeriu ka vetëm një jetë, ç’duhet të pëlqejnë vajzat e reja dhe se si tregtohet e shitet mishi i gjallë. Të ‘shkretat’ polake që po shkonin kot. Çfarë shijesh koti! Të visheshe normal, kulmi! Normale është se si zhvishen vajzat tona e jo si vishen vajzat polake. Kur flasin vajzat tona thonë, si do të zhvishesh ti për në mbrëmje? Po ti si do të zhvishesh për xhiron nëpër dyqanet për të prishur lekët e babait? Dhe interesant, prindërit kanë kuptuar se me zvogëlimin dhe pakësimin e rrobave është rritur, në të kundërt, kostua!

- Po ç’është ajo rrobë dy gisht gjë që më ke veshur, moj çupë? Thotë babai ‘konservator’, ‘prapanik’(se mamaja nuk thotë gjë, ajo është bashkëpunëtore në këto gjëra me çupat). Ku marrin vesh burrat nga jeta moderne, pavarësisht se pikërisht për ata bëhet kjo zhveshje!
- Ua, po unë do ta vesh një gjë, o baba!

Të shkretat polake, nuk u ka vajtur lajmi akoma që kanë vetëm një jetë dhe nuk e dinë nga bie Shqipëria ku mësohet se si ta bësh të fundit të parë. Dhe kanë parqe të mëdha e të bukura, ‘debilët’, polakët! Dhe merren me biçikleta, patina, sporte e grupe shoqërore, kulmi! Prandaj nuk kanë hip – hop ata, se kjo muzikë shkon vetëm me lakuriqësinë dhe seksin. Po polakët çfarë bëjnë? Nuk shtohen? Nuk e dinë ata se seksi është qëllimi i vetëm i jetës për shumicën e çupkave? Shiko si vishen, debilet! Po si do t’i joshin djemtë ato ashtu? Si do kenë ato sukses me djemtë po nuk u zhveshën? Si do lidhen çdo gjashtë muaj dhe ndërkohë gjuajnë për tjetrin? (Oiiii, ç’duhen paguar ato kafet dhe pijet për ditë në lokale!). Femra prandaj është femër. Tre përgjigjet tipike të vajzave tona kur i pyet:

1. Kështu më pëlqen
2. Jam më se normale
3. Nuk ka rroba të tjera në pazar

Ma shpjegoni dot: një gjimnaziste rreth 17 vjeç, kursante në një kurs anglishteje për t’u përgatitur për provimin e FCE të Kembrixhit, la kursin, pra hoqi dorë nga një çertifikatë FCE - je të gjuhës angleze që do t’i vlente tërë jetën sepse ... profesori i anglishtes nuk e lejonte ta mbante celularin hapur ato dy orë në kurs. Deri këtu ka mbritur çmenduria.

Çudia në Poloni vazhdonte më tej, as në televizor nuk kishte zhveshje, madje as folëset, prezantueset etj. Çudia vazhdon, organet gjenitale të një fëmije njëvjeçar mbuloheshin nga teknika me truke. Me siguri populli polak qenkërka një popull ‘i trashë’, ‘malok’, ‘i pacivilizuar’. More, po ku i gjejnë polaket rrobat e tyre? Se në Shqipëri nuk ka, janë nga një

pëllëmbë miu të gjitha, të paktën kështu thonë ato zonjëzat, të bukurat, të rrallat, modernet, ekstravagantet, specialet, origjinalet, interesantet, që shohim çdo ditë në sfilata rrugëve e kudo në atdheun e dashur e të etur për çmendurira. Kuptohet që edhe këtu ka një rregull 26, ndryshe do të më varte shoqëria.

Këto po mendoja unë duke kaluar çupkat tona paradë para syve të mi. Sa m'u dhimbën polaket 'e shkreta'. Po kur edhe më thanë që bëjnë shumë edhe për familjen dhe fëmijët e tyre në kurriz të argëtimit të tyre, o zot sa nuk luajta mendsh. Sa budallaçka! Njeriu duhet të ketë një çikëz ego e të shijojë jetën larg familjes. Po prandaj e ka degdisur perëndia Poloninë këtej nga veriu ku është ftohtë se më kanë këtë mendje.

Dhe m'u kujtuan të 27 rregullat që një 'burrë' i shkretë duhet të ndjekë për të qënë i lumtur.

1. Femra i vendos rregullat, gjithmonë.
2. Rregullat mund të ndryshohen në çdo kohë, pa paralajmërim.
3. Asnjë burrë nuk mund t'i dijë të gjitha rregullat.
4. Nëse femra dyshon se burri i di të gjitha rregullat, ajo duhet menjëherë të ndryshojë disa ose të gjitha rregullat.
5. Femra nuk gabon kurrë.



6. Nëse femra është gabim, kjo duhet të jetë patjetër për shkak të një keqkuptimi flagrant që vjen drejtpërsëdrejti nga diçka që një mashkull e ka bërë ose e ka thënë gabim.
7. Nëse ndodh pika 6, mashkulli duhet urgjent të kërkojë të falur për shkaktimin e keqkuptimit dhe të pranojë pasojat.
8. Mashkulli nuk duhet në asnjë mënyrë t'i bëjë direkt ose edhe indirekt vërejtje femrës.
9. Femra mund ta ndryshojë mendjen e saj në çdo kohë kur ja do një gjë.
10. Mashkulli nuk duhet kurrë ta ndryshojë mendjen e tij pa pëlqimin e mëparshëm me shkrim të femrës.
11. Kur mashkulli diskuton me një femër ai duhet të thotë vetëm fjalën e parë, për të tjerat kujdeset femra.
12. Mashkulli, në asnjë rrethanë, nuk duhet t'ja bëjë femrës të ditur, t'i thotë ose të nënkuptojë që ai (mashkulli) nuk po kupton asgjë nga muhabeti kodra-pas-bregu të femrës.
13. Femra ka të gjitha të drejtat e të zëmëruarit ose inatosjes në çdo kohë.
14. Mashkulli duhet të rrijë i qetë gjatë të gjithë kohës, me përjashtim të atyre rasteve kur femra do vetë që mashkulli të zëmërohet.
15. Femra, në asnjë rrethanë, nuk duhet të lejojë që mashkulli të kuptojë nëse ajo do apo nuk do që ai të zëmërohet.

16. Nëse mashkulli shikon, pa dashje, se femra flirton me një mashkull tjetër, ai KURRË nuk duhet të mendojë atë që mendon. Nëse kjo ndodh, femra nuk duhet të dëgjojë se çfarë mendon ai.
17. Nëse mashkulli gjen aksidentalisht femrën e tij në shtrat me një fqinjin e tij ose me shokun e tij më të mirë, ose me këdo tjetër, ai duhet të jetë i sigurtë gjithmonë se nuk është ajo që mendon ai.
18. Mashkulli nuk duhet të mendojë kurrë, nëse nuk është për faktin se çfarë t'i blejë femrës si dhuratë për ditëlindjen e saj.
19. Mashkulli duhet që me mirënjohje, bindje, pa fjalë, gjithë zell ta ndjekë femrën nga prapa që të mbyllë dyert që ajo le hapur, të mbyllë dritat që ajo i le ndezur, të stakojë sobat dhe ngrohësit që ajo i le ndezur, të mbyllë e mbulojë gjërat që ajo le hapur pavarësisht se ajo mund të thotë "do të kthehem prapë".
20. Kur mashkulli dhe femra shkojnë tek një zyrë shteti apo kompanie për zgjidhjen e një çështjeje, është femra ajo që duhet të flasë.
21. Mashkulli duhet që gjithmonë ta pëlqejë gatimin e femrës, ose të paktën të thotë kështu.



22. Mashkulli duhet ta dijë që të gjitha femrat janë të bukura dhe duhet ta recitojë këtë çdo ditë.
23. Mashkulli nuk duhet ta pyesë kurrë femrën nëse nuk është i lumtur me përgjigjet. Nëse duhet të jesh gjithmonë i lumtur me përgjigjet e femrës, atëhere përse duhet të pyesësh?
24. Mashkulli duhet ta dijë se kur femra u martua me të, kishte mundësira më të mira (dmth kandidatë shumë më të mirë se ai) dhe përsëri i ka.
25. Mashkulli duhet ta kuptojë që është femra që kontrollon e di gjithshka, de facto.
26. **Në një bisedë me një femër, për femrat, mashkulli duhet ta përjashtojë bashkëbiseduesen dhe çfarë i përmban asaj libri i shtëpisë, shprehimisht, nga çdo përgjithësim jo të këndshëm që ai u bën femrave. Ato nuk e ndjejnë veten mjaftueshëm të përjashtuar nga fjala 'përgjithësim'. Ky mashkull quhet grindavec dhe njeri që urren gratë pavarësisht se thotë të vërteta, të cilat nuk thuhen.**
27. ***Gabimet e femrave i vuajnë meshkujt.***

Kurse gruaja e ka më të lehtë për të qënë e lumtur. Që një grua të jetë e lumtur i duhet vetëm që i dashuri, i fejuari, burri të jetë për të:



- Shok, i dashur, vëlla, prind
- Mjeshtër, kuzhiner

- Elektriçist, marangoz, hidraulik, mekanik, bojaxhi, stilist
- Mama e mirë, gjinekolog, psikolog, psikiatër, doktor
- Zhdukës parazitësh
- Dëgjues i mirë, organizator, baba i mirë
- Shumë i pastër
- Simpatik, atletik
- I ngrohtë, i vëmendshëm, galant, inteligjent, me sens humori, krijues, i butë
- I fortë, mirëkuptues, tolerant, i matur, i duruar,
- Ambicioz, i aftë, i guximshëm, i vendosur
- I sinqertë, i besueshëm
- Pasionant, i devotshëm, i dashuruar.
- T'i bëjë komplimenta rregullisht
- Ta pëlqejë bërjen e pazarit
- Të jetë i ndershëm
- Të jetë i pasur
- Të mos i shkaktojë strese
- Të mos shikojë femra të tjera

- Të mos lavdërojë shoqet e saj në sytë e saj
- Të mos presë vëmendje nga gruaja e tij
- T'i lerë asaj shumë kohë për veten e saj
- Të mos shqetësohet kurrë se ku shkon gruaja
- Kurrë të mos harrojë ditëlindjet, përvjetorët dhe organizimet që i bën e shoqja
- Të jetë i kënaqur me shishen e birrës dhe kontrollin mbi telekomandën.

Vini re se si e kërkojmë lumturinë, jashtë vetes sonë. Në fund të fundit, edhe kur nuk e refuzon dot një gjë, nuk të pëlqen, nuk e ndryshon dot, nuk e pranon dot, atëhere shiko brenda vetes dhe ***ndrysho pikpamjen tënde lidhur me atë çështje.*** Lumturia nuk është larg që nga ai çast.

Disa fakte bazë mbi burrat dhe gratë

Burrat:

1. Të gjithë burrat janë jashtëzakonisht të zënë me punë
2. Megjithëse janë kaq të zënë, ata prapë kanë kohë për t'u marrë me gratë
3. Megjithëse ata kanë kohë për gratë, ata nuk kujdesen në të vërtetë për to
4. Megjithëse ata nuk kujdesen në të vërtetë për to, ata gjithmonë i shikon me një grua
5. Megjithëse ata i shikon gjithmonë me një grua, ata gjithmonë e provojnë fatin e tyre me ndonjë tjetër
6. Megjithëse ata gjithmonë e provojnë fatin me ndonjë tjetër, ata me të vërtetë që vuajnë kur gruaja i le
7. Megjithëse gruaja i le, ata përsëri nuk nxjerrin mësim nga gabimet e tyre dhe vazhdojnë të provojnë fatin me gra të tjera.

Gratë:

1. Gjëja më e rëndësishme për një grua është siguria financiare
2. Megjithëse kjo është e rëndësishme, ato përsëri dalin dhe blejnë rroba dhe gjëra të tjera të shtrenjta
3. Megjithëse ato blejnë gjithnjë rroba të shtrenjta, përsëri ato nuk kanë KURRË diçka për të veshur
4. Megjithëse ato nuk kanë kurrë diçka për të veshur, ato gjithmonë vishen bukur
5. Megjithëse ato vishen gjithnjë bukur, rrobat e tyre janë vetëm 'rrecka të vjetra'
6. Megjithëse rrobat e tyre janë gjithmonë 'rrecka të vjetra', ato përsëri presin nga ju që t'u bëni komplimenta për rrobat
7. Megjithëse ato presin komplimenta nga ju, kur ju e bëni këtë gjë, ato nuk ju besojnë.

Mbasdite kur u taraks një çikë shiu, u ngrita. Më sollën një CD player ta përdorja në dhomë, se muzikë në mjedise çuditërisht nuk kishte. Pastaj vura kapelen dhe u turra nga qyteti. Për tre minuta isha anës liqenit, nën pemë. Sa qejf! Ah, sikur të ishte me mua! I erdha rrotull atij qyteti të vogël dhe hyra në një supermarket, ku bëra ca pazar. Më vonë ndodhesha nën një strehë, mbi pishinë, me erën që frynte lehtë e më sillte tinguj të një muzike popullore. Dhe shkruaja.

Në darkë provova supën polake me patate, karrota, erëza dhe, më duket, curry. Më shijoi. Kjo u pasua nga një biftek gjokspule me patate dhe sallatë. Termusat me kafe dhe çaj i lashë paprekur. Ëmbëlsirën dhe akulloren i refuzova. Bëra një telefonatë dhe rashë të flija me pulat pasi dëgjova ca muzikë të bukur pop në radion e CD player-it, një stacion lokal radioje quajtur Wama.

Dita e katërt

Prapë shi. Po mirë, thashë, për të ndenjur brenda, rrija në shtëpinë time unë, ku kam librat, Dixhitalbin dhe telefonat. As dushi dhe as këngët indiane nuk më qetësuan. Vajta për mëngjes. Dy pleqtë gjermanë që ushqeheshin në tavolinën fqinje (madje, më duket, se edhe flinin në dhomën fqinje) sigurisht ishin atje dy orë para meje, në një mision tjetër çfarosës nazist. Fillimisht zhduknin një batalion buke lyer me gjalpë, reçel dhe mjaltë, të cilin e bekonin me filxhana çaji ose kafeje. Pastaj i vinte radha një regjimenti kolosal të përbërë nga:

1. Salcë kosi me përzjerje bimësh, zarzavatesh dhe arrash
2. Djathra kaçkavallë të llojeve të ndryshme

3. Sallamra të llojeve të ndryshme
4. Proshuta të llojeve të ndryshme
5. Gjalpë
6. Domate dhe kastraveca

Pastaj i turren kremviçit të gjorë ose omeletës së ngrohtë me mish të grirë, cila të ketë fatin e keq. Pasi i 'eksterminojnë' këto deri në brezin e shtatë duke mos u lënë as nam e as nishan, i afrohen tinëzisht Cereals (drithërave) me qumësht, që ndodhen në një tavolinë të veçantë, dhe ato na lenë uratën. Kur nuk ka mbetur në këmbë asgjë nëpër pjata, kupa, tabaka dhe ibriqe ose termuse fillojnë të pjerdhin aty ku janë. Dhe bëhen prapë për të ngrënë, por unë nuk e di se ç'ndodh më tej me ta, sepse unë i gjej aty, por edhe i le aty.

Jam ulur e po dëgjoj këngë indiane. Shiu polak e ka marrë me nge. Çudi se ata nuk e njohin kabanë me klarinetë. Shiu ynë e ka me rau – xhau. E di që peshqit po më presin që t'i peshkoj. Shikoj dhomën rrotull. Derisa t'i dojë shiut ndonjë gjë që të pushojë, hajde se po shikoj TV fundja. Diku na u bëkërka një kampionat botëror voleibolli për meshkuj. Mua më pëlqen voleibolli, sidomos në ditë shiu. Po luajnë polakët me japonezët. Çfarë janë këta japonezët! Po që i kanë zgjedhur të gjithë të lezetshëm! Lojë e fortë. Wow, polaku qenkërka në krye me sete – 2:1. Ja vajti 2:2. Kuptohet. Këta polakët edhe ngecin ndonjë top, si hileqarë që jemi ne këtej, por japonezët kanë ardhur për të lozur. Ç'kombinime! Ç'zhytje! Ç'bllok! Boooo, si e çau atë bllok tresh ai japonezi! Ua ngopi se gjuajtkërka me të dy duart. Jamakura, e quajnë. Polakët e fitojnë lojën. M'u bë vonë.

Po tani? Kuturisa. Vura kapelen, paratë në xhep dhe slowly, too slowly, anës liqenit, poshtë pemëve. Nuk e di sa orë, por e eca qytetin përrallor të Mragowos rrugë më rrugë e park më park duke bërë edhe pazare të vogla. Si nuk ditkërka kurkush anglisht këtej, më fiku. M'u duk vetja i pazot pavarësisht se arrija të merresha vesh. Qytet pa grataçiela, pa lluks, pa beton, inoks e xhama, i virgjër. Nuk dëgjoje muzikë me zë të lartë gjëkundi. Asnjë muzikë nëpër dyqane. Gjithmonë "Kujdes tjetrin!". Por bregu fantastik i liqenit kishte parqe e kënde lojërash dhe koha nuk i ndalonte të vinin me makina, biçikleta e në këmbë drejt këtij bregu. Me të dashurën time do të kisha jetuar 1000 vjet në këtë vend, por asaj i duhej të mos ishte shqiptare që nuk rri dot pa parë rrotull dhe 100,000 veta do të ishte numër i pamjaftueshëm për ta admiruar dhe për ta parë veshur me rroba të reja e të reja e të reja dhe për ta dashuruar të bukurën e dheut me maskë. Shqiptarkën e genit special, që nuk e di se ç'është dashuria. Rregulli 26 aplikohet edhe këtu.

- Prof, - më tha një vajzë, - unë nuk di të them se ajo që ndiej është dashuri apo çfarë është!
- Prof, - më tha një tjetër, - ti a nuk shikon rrotull për një mundësi më të mirë në karrierën tënde e ta kapësh fort? Një mundësi më të mirë në jetë? Po ashtu, edhe ne femrat shohim për një mashkull më të mirë, me parametra më të mira fizikë e financiarë, pavarësisht se jemi të lidhura, të fejuara apo edhe martuara. **Për ne është një mashkull i bukur dhe i pasur, e pak debil, kariera jonë**, një mashkull që të na dojë si i çmendur e të mos e verë re që nuk e duam ose ta hajë që gjoja ne e duam. Pra, ju i gënjeni e mashtroni tërë kohën meshkujt kur u thoni 'Shpirt, të dashuroj'. Përgjigja e saj ishte, 'Po ç'të bëjmë? Ata na e kërkojnë t'ua themi orë e minutë.' Kjo ishte një vajzë e sinqertë.

- Vajzat lakuriqësohen që të joshin, të provokojnë. Kur kësaj ia kanë arritur, fruti mund të jetë edhe në formën e një rrote, që i fut duart. Ajo i thotë "Gomar", dhe ikën, por brenda vetes e lumtur.
- Vajzat dhe gratë bëjnë çmos për ta bërë të dashurin xheloz si një provë dashurie dhe, pasi ia kanë arritur kësaj gjëje, dmth ta bëjnë të dashurin, apo burrin xheloz, duke mbjellë brenda burrit një farë të keqe demoni, bezdisen nga xhelozia e vazhduar e burrave të cilëve u është lëkundur besimi në mënyrën më mizore. "Ua, po ti qenkërke xheloz. Nuk paske besim kështu?!" Dhe ndahen nga ai si pa të keq.
- Burri e gjen gruan në shtratin e tij të dhomës së gjumit me komshiun. Burri largohet i shokuar. Gruaja ngrihet lakuriq dhe i thotë: "Dale të shpjegohemi. Nuk është ashtu siç kujton ti."
- Po mirë, i thashë një gruaje, përpara se të dashurosh një tjetër duke qënë e martuar, e fejuar, gjoja e dashuruar, a nuk do të ishte më e ndershme të shkëputeshe nga i pari apo ta divorcoje përpara se të filloje me dikë tjetër? 'Jo more, tha gruaja, po ku jam e sigurtë unë në do të më marrë ai tjetri me të cilin jam lidhur?' Dhe këta për të cilët ti nuk je e sigurtë mund të jenë pambarim, e pyeta unë? 'Ti i urren gratë!' ishte përgjigja e saj konkluduese. Unë e pashë me dhimbje, por nuk shikoja atë, por fëmijët e saj të pa dashuri, pa respekt, me busull të dëmtuar. Unë shikoja degjenerimin me fytyrë të bukur; femrën.
- Por ka edhe vajza të tilla si kjo studente e imja e cila më nisi këtë sms në celular: " Mirëmbrëma Prof. Si jeni, unë jam sh mirë. Shumë e ngarkuar, por shumë mirë me mësimet. Prof, tani po kuptoj shumë nga ato që thoshit gjatë mësimit. Kishit të drejtë për shumë gjëra. Natën e mirë." Mendova me dhimbje se diku kjo vajzë e kishte pësuar.
- Cilin stil ecjeje keni ju bjonde: stilin "hajde dhe më kap", një stil i ngadalshëm si në filmat me xhirim të ngadalshëm që sfidon edhe ata që nuk e kanë ndërmend të ndalojnë njeri apo stilin "më ler rehat se nuk ta kam ngenë", një stil normal me një destinacion? "Gomari, më ndaloi në mes të rrugës!"
- Burri hyn në shtëpi, gjen gruan me shokun e tij më të mirë në shtrat, nxjerr koburen dhe ja hedh trutë shokut në erë. – Ç'bën?! I tha gruaja. – Po u solle në këtë mënyrë ti do t'i humbasësh të gjithë shokët. -

Do më dilte ndonjë shqiptar i njohur apo i panjohur këtu në këtë skaj të botës? Mirë, unë kërkoja dema në Mragowo, 250 km larg Varshavës, mes pyjeve dhe liqeneve, po i njohuri çdo kërkonte këtu? Thashë të eci rrugës dhe të thosha ndonjë fjalë të pistë. Të pistë? Sa do qeshin dolot po t'i lexojnë këto. Të pistë. Për dolot, djem e vajza, nuk ka më fjalë të pista, sepse ata e kanë larë të gjithë inventarin e fjalëve të pista në lavatriçen e degjeneruar të kohës së sotme, tamam si kartmonedhat fallco.

Një kthim në supermarket, rrugës një pushim buzë liqenit, një Redbull me kornfleiks të Nestles dhe home. Muzikë, një dush i bekuar dhe një film me ... nuk më kujtohet emri. Ndërkohë shkruaj dhe retë vendosin ta nxjerrin diellin për shëtitje në oborrin e burgut. Sa mirë! Po më mbyllen sytë. M'u bë sikur isha Don Kishoti në një luftë të humbur donkishoteske. Kisha përballë, poshtë meje, një turmë shumë të madhe adoleshentësh dhe po mbaja një fjalim.

Të dashur, a do lesh? Oiii, ma kishin bërë lëmsh fjalimin Pançua dhe Rosinanti. Të dashur adoleshentë. Dëgjoni ju trapa, rrota, debila, zuzare, kjo është jeta juaj, por kjo nuk do të thotë se ju duhet ta qelbni sepse përndryshe bota do të kthehej në një kazan gjigand plehrash. Kjo

është jeta juaj … Këtu dhe tani. A e keni menduar ndonjëherë pyetjen e përjetshme, “Cili është vendi im në jetë?” Shopenhauri do të shkruajë: “Ne i harxhojmë tre të katërtat e jetës sonë duke u përpjekur që të jemi si njerëzit e tjerë.” Mendoni miqtë e mi askushër, 75% e ekzistencës sonë për të imituar të tjerët. Por ne jemi UNIKË, secili prej nesh. Çdo sekondë që ne jetojmë është një çast i ri dhe unik në univers, një çast që nuk ka qënë kurrë më parë dhe nuk do të jetë më kurrë përsëri. Po ju çfarë bëni? Kur do të mësoni dhe kur do t’ua mësojnë se kush jeni?

A e dini se kush jeni? Ju jeni një mrekulli. Ju jeni unikë. Në tërë universin nuk ka djelmosha dhe vajza tamam si ju. Shikojeni veten. Ju jeni vërtet një mrekulli. Ju mund të bëheni një Shekspir, Mikelanxhelo, Bet’hoven, Ajnshtain. Ju keni aftësinë për t’u bërë gjithçka. Po, jeni të mahnitshëm. A do të donit ju të lëndonit një mrekulli, tani apo në të ardhmen? Po cili është qëndrimi juaj? A është pozitiv? Dihet që ajo që do të aspironi do të bëhet pjesë e natyrshme e qënies suaj. Qëndrimi pozitiv prodhon rezultate pozitive dhe rezultatet pozitive janë ato që duam. Çfarë do të futësh, do të marrësh, tamam si me një kompjuter. Fut plehra, merr plehra. Kush do t’ua sjellë juve vetrespektin, rritjen, lumturinë dhe përmbushjen, përveçse vetja juaj? Ju jeni përgjegjës për atë që quhet vetvete. Kështu, duhet ta vlerësoni veten tuaj dhe të kuptoni se ju keni gjithmonë mundësinë e zgjedhjes. Kjo varet nga ju. Varet nga ju nëse doni të jeni një hedhurinë, apo të zotëroni një mbretëri, sepse është kënaqësia e mirë e Atit tonë që na e jep këtë blatim. Për ta bërë këtë ju duhet të jeni të ndërgjegjshëm për bukurinë e gjithçkaje.

Ndërsa jeni akoma të rinj, zgjohuni para bukurisë. Ku është bukuria, pra? Vetëm në seks? Bukuria është e bekuar rrotull nesh, bukuria shpirt-çliruese e lindjes së diellit, e lules së mrekullueshme, e pemës krenare, e rrugicës së larë nga dielli, lumit të duruar, reve pendëbardha që shpupurisen në qiellin e sapo freskuar, një fytyrë e ëmbël, hijet e buta që rënia e natës pikturon, yjet e panumërueshëm, uji i ftohtë kristal, dëbora dhe akulli i veriut. Lista e bukurisë është e pafund si vetë bukuria. Filloni tani ta vini re bukurinë, lereni të bëjë magjinë e vet. Përpiquni që çdo ditë të bëni një depozitim aktiv të bukurisë në bankën tuaj të kujtesës. Ju do të pasuroheni në shpirt me interesin që do të merrni nga ky depozitim. Dhe me bukurinë vjen madhështia.

“Një njeri është aq i madhërishëm sa edhe ëndërrat që ëndërron

Aq i madhërishëm sa edhe dashuria që ushqen

Aq i madhërishëm sa edhe vlerat që blaton

Sa edhe lumturia që ai shpërndan

Një njeri është aq i madhërishëm sa edhe mendimet që mendon

Sa edhe vlerat që fiton

Sa edhe shatërvani në të cilin shpirti i tij shuan etjen

Sa edhe vizioni që ka fituar

Një njeri është aq i madhërishëm sa edhe e vërteta që flet

Aq i madhërishëm sa edhe ndihma që jep

Aq i madh sa edhe fati që ai kërkon

Aq i madh sa edhe jeta që ai jeton.”

Gëte

Ndërsa dëgjoni këto, ju e shikoni veten në shtrat me ndonjë fiksim tuajin. Ju pikturoni në mendjet tuaja të sëmura vetëm seks. Seks, seks, seks, seks non-stop seks.

A e dini veten për Xhenifer Lopes?

Po për Xhulia Roberts?

A mos e dini veten një seks-bombë?

A mos e dini veten një Timbërlake?

Apo pa dashje kujtoni se jeni Dicaprio?

Mos jeni gjë Bradt Pitt?

Ju zuzaret e zgjuara dhe ju trapat shovinistë. Neuronet tuaja qelben, bien erë. Truri juaj është i akorduar vetëm për seks. Kështu? Në emër të çfarë gjëje? Zotit? Njerëzimit? Jetës? A vjen kjo për shkak të asaj se ju fjalën seks e përktheni: siguri, eksitim dhe kromosome X? Jo, ato tregojnë se ç’është seksi, por jo pse jeni kaq të obsesuar.

Është frika, miqtë e mi, brenda nesh. Ju keni frikë, të gjithë kemi frikë, sidomos femrat. Ka shumë konkurencë. Çfarë dhe sa arrijmë të kapim? Kurrë më parë në jetën tonë shoqëria nuk ka qënë kaq e çmendur, kaq e kotë, një humbje kaq për të ardhur keq. **Frika se mos je gjella e mbetur në pjatë.**

Fatkeqësia më e madhe është se ju e keni eliminuar miqësinë midis vajzave dhe djemve, dhe midis vajzave. Në asnjë rrethanë nuk duhet ta kishit bërë këtë gjë. Ju e keni hedhur këtë shoqëri në plehra. Ju flisni për shoqërinë, ju pretendoni se bëni dhe mbani shoqëri, por ju nuk e keni idenë se çfarë është shoqëria. Përse? Mbijetesa? Ndoshta. Botë e vogël. Ju qarkulloni njëri-tjetrin. Ju luani si xhonglerë. “Unë i propozova, tani propozoi ti. Bast që unë lidhem me të për dy ditë.” “Ti je rrotë, nuk di ta bësh për vete, kurse unë jam njësh, trap i zgjuar, gojëtar.” Oh, kurse AJO sa nuk klith nga kënaqësia që po ia varin, po e ndjekin, që, me keqardhje, po e trajtojnë si plaçkë, si kukull, si vegël muzikore për të luajtur, për të negociuar. Një copë rrobë për të fshirë nevojat tuaja, dhe …, kjo është pikërisht ajo për të cilën është

krijuar. A nuk e meritoni, pra, këtë poshtërim reciprok, të cilin e pranoni me kaq dëshirë në emër të KËNAQËSISË dhe NJOHJES?

Shok apo shoqe do të thotë besnikëri. A jeni besnikë? Po, për sa kohë nuk keni ndeshur një ofertë më të mirë. Po, për sa kohë që shoku apo shoqja nuk ju ka kërkuar një nder. Jo, për sa kohë që shoqja apo shoku juaj nuk ua ka ofruar veten e vet. Në qoftë se nga dikush që e quani shok apo shoqe prisni vetëm kortezi, bujari, ndihmë, fisnikëri, mirëkuptim nga mëngjesi deri në darkë dhe nuk ju bie ndërmend që edhe ju duhet të shkëmbeni, të falni miqësi në raport me gjendjen shoqërore, dhe veçanërisht të shkëmbeni dashuri, besim, besnikëri dhe gatishmëri që edhe të sakrifikoni për shoqërinë apo miqësinë, atëhere ju nuk keni kurrë një shok apo shoqe brenda jush, ju nuk jeni dhe nuk mund të jeni kurrë një shok apo shoqe. Ju e përdorni këtë fjalë, por ju nuk jeni shokë. Po krijohet një kategori e re shoqërore: FLIRTUESIT. Vajzat mendojnë se u bëjnë korte për seksin e tyre dhe kur një burrë u kërkon një favor, ato mendojnë se një burrë mund të kërkojë favor vetëm seksin e tyre. Ata mendojnë vetëm seks. Gjepura! Një shok apo shoqe e vërtetë nuk po kërkon seksin tënd, kjo është vetëm në mendjen tuaj të sëmurë. Një shok apo shoqe e vërtetë është gjëja më e mirë që po i ndodh një vajze apo një djali, kurse ju, në shumicën e rasteve paragjykoni. A e mbani mend një këngë që thotë: "Zgjatem për dorën tënde, ajo është gjithmonë aty"? Është nga Historia e Dashurisë, por ajo është dora e një shoku apo shoqeje të vërtetë. Që në çastin që ju e shikoni një shoqe apo shok fizikisht apo seksualisht, shoqëria ka marrë fund. Nuk ka më shok.

Shok apo shoqe do të thotë respekt. A e respektoni njeri-tjetrin dhe veçanërisht vajzat? Ju adhuroni seksin e tyre, kjo është e gjitha. Do të thotë edhe intimitet, por a e respektoni intimitetin ju? Jo, dhe këtë unë nuk e kuptoj. Miqësia ashtu si dashuria është intime. Problemi juaj është se për ju nuk ka ndonjë largësi të madhe midis "Të njoh" dhe "Të dashuroj". Një "të dashuroj" pa asnjë bindje ose ndjenjë, vetëm sy ose fytyrë e bukur ose thjesht lëndë. Një mëngjes, kur unë po shkoja te mulliri i Sanços, për të dhënë mësim, pashë një vajzë, nxënëse, të puthte shokun e saj, klase ose jo, nuk e di, duke ia ofruar buzët e saj në prani të plot nxënësve të tjerë. Pastaj pa rrotull dhe u shkeli syrin shoqeve të saj, krenare dhe e lumtur. Krenare dhe e lumtur se tashmë bota e di se e kanë në konsideratë, se ajo ka dikë. Kush është ky? E ç'rëndësi ka? Ka dikë. Ja përse të gjitha lidhjet, marrëdhëniet dhe fiksimet tuaja dihen nga të gjithë. E ç'të keqe ka të jesh i hapur, mund të pyesni. Asgjë të keqe, por demonstrimi i të ashtuquajturës marrëdhënie kaq hapur u thotë njerëzve se ju nuk keni ndjenja, se ju nuk dashuroni, se ju keni komplekse. Ju doni të shisni mend, "Unë kam një lidhje", "Unë nuk jam debile", "Unë jam moderne, ekstravagante", "Unë jam tërheqëse, interesante dhe e konsideruar" dhe "Unë kam sukses me djemtë." Ju doni të tregtoheni dhe disponueshmëria juaj të bjerë në sy, të merret vesh. Apo nuk tregtoni thashetheme sa lodheni! Nganjëherë i tregoj edhe unë Rosinantit për Sançon për të parë se ku është gallata.

Si mund ta quani të dashur një shoqe apo një shok kur ju flirtoni me të dashurin ose të dashurën e tij ose të saj? Ju bëni të dashur pa i patur shokë më parë. Humbisni gjë? Gjithshka. Këtu dua t'ju jap një këshillë, të dashur a doni lesh, të dashur adoleshentë. Mos u ngatërroni me njeriun e gabuar, mos i shkelni në kallo. Përpiquni të keni etikë në shoqëri. Studjojeni këtë fjalë, etikë, sepse ky është një tipar shumë larg jush. Një veti apo tipar që juve ju mungon. Ju jeni e shoqëruar nga një djalë, pavarësisht marrëdhënieve me të, ju flirtoni me sy me njerëz të tjerë. Kjo është një mungesë e pastër etike, sepse jeni kaq egoiste, të pakorrigjueshme, të korruptuara dhe, pa j'u dridhur qerpiku, i thoni shokut tuaj, kur ua bën vërejtjen se nuk e keni idenë se për çfarë po ju flet, pa menduar se sa nevojë kishit për atë shok në krah. Ne gënjejmë, gënjejmë, gënjejmë. Mashtrojmë derisa enjtemi. Mallkuar qoftë! **Etika duhet të jetë lëndë në shkollat e mesme.**

Po a e keni ndjerë pikën e lotit ndonjëherë në shpirtin tuaj? Një rrahje të humbur zemre a e keni vuajtur? A ka ardhur kjo prej një palë syve të ngrohtë apo një buzëqeshjeje misterioze ngarkuar me drithërimën e flladit pranveror? A është kjo prej një zëri të kashmirtë prej prekjes së puplës që ju shkakton juve një shkulm emocionesh që deh molekulat tona? A mos është prej prekjes së trëndafilit nga buzë që dridhen, nga zë që i merren këmbët?


Materiale te rrezikshme - Gruaja

ELEMENT:	Gruaja
Simboli:	[illegible]
Zbuluesi:	Adam
Masa atomike:	Pranuar 55 kg, por gjendet nga 45 deri 225 kg.

Vetite fizike:
1.Siperfaqa normalisht e mbuluar me nje shtrese pudre dhe boje.
2. Vlon per hicmosgje – ngrin pa asnje arsye te dukshme.
3. Gjendet ne lloje te ndryshme, nga material i virgjer ne zeheror i rendomte.

Vetite kimike:
1. Reagon mire ndaj floririt, platinit dhe te gjithe gureve te cmuar
2. Shperthen spontanisht pa arsye apo paralajmerim
3. Agjenti me i fuqishem para-reduktues qe njeh njeriu

Perdorimi:
1. Shume zbukurues, sidomos ne veturat sportive
2. Mund te ndihmoje se tepermi ne relaksim
3. Mund te jete nje agjent shume efikas pastrimi

Rrezikshmeria:
1. Kthehet ne jeshil kur e ve prane nje specie superiore
2. Eshte e mundur te kesh me shume se nje, por nuk duhet ta shohin njera tjetren

Nuk është prej seksit, është prej dashurisë që ti nuk e shikon për shkak se mendon gjithë kohën seks. Mendoni dashurinë, atë dashuri që ju nuk e shikoni. Kjo dashuri është reflektimi i bukurisë dhe virtytit më sublim me të cilat është brumosur gjithkush nga Zoti. Dashuria është pasion jo për mbijetesë për ju që të konkuroni, por për të pastruar vetveten. Është lumturia e përjetshme. Një lule është e bukur nga natyra, është dora që ua jep këtë lule që është si prej perëndie, prej shpirti dhe zemre. Prandaj nuk merrni përgjigje sa here që ju do të donit. Në atë kërkimin apo gjuajtjen e etur si në ethe të dashurisë çdo ditë, çdo orë, ju dështoni, sepse ju mendoni seksin. Ju mendoni seksin kur shikoni sy të bukur, fytyrë të bukur, trup të bukur, substancë e hijshme në kilogramë dhe metra, lëkurë që digjet prush, kompleks tërë dritë. Ju djersitni shumë dhe humbisni kontrollin gjatë përpjekjeve për të prekur një dorë, një shpatull, të thithni frymën e saj ose të tij, t'i merrni erë parfumit të flokut të saj ose tij, parfumit … duke harruar se është shoku apo shoqja juaj dhe, kuptohet, në shumicën e rasteve shpërbleheni me dhimbje në fund të ditës dhe ju …, ju e quani këtë dashuri, dhe ju, ditën tjetër, shkoni tek një tjetër djalë apo vajzë, kush ta ketë radhën në listën tuaj të pritjes së kandidatëve.

Dale, prisni ju mullinjtë e erës, ju eksperta që dini ta përkufizoni dashurinë. Ajo që do të përkufizoni ju do të jetë vetëm situatë kur ju keni një fiksim mbi dikë, dashuri e cekët, që vjen e shkon, një bisedë ose dy ku nuk dini se çfarë t'i thoni njeri tjetrit, sy jeshilë, buzë gjithë lëng, pagjumësi, fantazia më e çmendur, ndoshta edhe lot, kjo është e gjitha. Ju pyesni i habitur veten, pse ç'të keqe kam unë apo ajo? Pse më refuzojnë? Përse nuk jam më interesante? Ju lëndoheni, por ju duhet ta merrni një mësim të mirë se si të shihni më thellë brenda njerëzve dhe ta harroni veten për një çast, ta harroni egoizmin tuaj.

Trapa të zgjuar, ju keni tru, keni edhe bukuri, por ju i humbisni në gjueti të kota. Ju zuzare sensualiste, ju keni klas dhe bukuri, por e vetmja gjë me të cilin ju i angazhoni neuronet tuaja debile është se si të vareni tek një mashkull në kërcim, me muzikë romantike, si të eksitoheni, si të ndizeni seksualisht dhe të kaloni orgazma njëra pas tjetrës dhe të ikni pastaj … të ikni, drejt një tjetri. Të lutem qëndro, thotë kënga. Ju i angazhoni neuronet tuaja me tatura, lakuriqësi në trup e shpirt dhe piercing për një çikë vëmendje, konkurencë, për të krijuar një listë admiruesish, kryesisht të panjohur. Vëmendje publike me mënyrën e gabuar. Hedhurina të mira me ca vlerë përdorimi. Ngjeshje telefoni me qindra numëra të panjohurish. Tungjatjeta, merreni numërin tim. Si e keni emrin, meqë ra fjala? Sy të bukur, fytyrë e ëmbël,

buzë të kuqe, mashkullor. Një shprehje fytyre sensualiste me ca hip-hop që të shkojë me kuadrin. Kjo është bota juaj!

Ju, o turmë adoleshentësh, që nesër do të sundoni botën, mund të jeni duke menduar me atë mendjen tuaj të kufizuar fizike se fjalët e mia janë përralla me mbret ose më keq, bajga. Atëhere do të më duhet të pres. E vetmja gjë që ia vlen të presësh në këtë botë është dita, kur ju dilni nga adoleshenca, ashtu siç presim shkrirjen e dëborës që sjell pranverën. Kjo do të thoshte se nuk keni kuptuar gjë. Më vjen keq për këtë. Kjo ndodh, sepse ju jeni bashkë, turmë dhe sëbashku ju jeni si një kope me ujqër mendjesh të pista. Përse e pëlqeni Hip – Hopin? Aspak nga ajo që thoni ju se trajton fëlliqësirat e ditës, që prekin telin e demonit tuaj rebel brenda jush, sindroma juaj e kopesë. Jo, aspak, por është prej frikës. Ju keni frikë të mbeteni vetëm për pak caste, sepse do t'ju duhet të arsyetoni, të dëgjoni zemrën tuaj se si punon, çfarë ndjen, mesazhet që mbart gjaku juaj kozmik. Ju keni frikë të ndjeni, prekni, të kuptoni dhembjen tuaj, që, në fakt, është lumturia juaj e vërtetë. Ju keni frikë nga mendimi se do të mbeteni të bllokuar diku asgjëkundi. Sepse ju jeni adoleshentë. Fëmijët kur venë gjashtë vjeç i dinë të gjitha pyetjet, porse ju, dolot, i dini të gjitha përgjigjet dhe kjo ju revolton. Lindin cinikët dhe skeptikët me pyetje të reja, kësaj radhe pyetje ironike, përgjigjen e të cilave e merrni me mend. Atëhere rebeloheni. Rebeloheni nga absurditeti se si universi na qenkërka ngjizur pa qënë ju rrotull, kur ju ekzistonit vetëm si afsh; se si dashuria na paska ekzistuar përpara erës suaj; se si na paskërka ca ligje pa miratimin tuaj. Atëhere ju i hidhni dorashkën të gjitha sistemeve, nga më primitivet e deri të më ndërlikuarat, materies, filozofëve, dijetarëve, rendeve shoqërore dhe do ta interpretoni Maltusin sikur të paskësha thënë: "Poshtë të rriturit!" Po mos harroni. Heshta ime nuk është mposhtur akoma. Ju nuk dalloni dot kryqin e thyer nga Che Guevara. Përrua i rrëmbyer dhe i turbulluar që bie vërtik nga mali jeni, që qetohet e kthjellohet me të rënë në fushë. Lum që bëhet mendimtar, që ndërton, që prodhon, që zbukuron me padurimin për t'u bërë det i pushtetshëm, për të mësuar se ç'është dashuria e vërtetë, për të kuptuar se jeta dhe bota është një bekim, për ta marrë botën në dorëzim. Kjo është pjekuria. Po deri atëhere … më thoni:

A jeni ju Dicaprio? Po Julia Roberts? A mos jeni Brad Piti? Timberlake? Natyrisht ju ëndërroni të jeni apo t'i keni në kushtoren e dytë. Unë, Don Kishoti i Mançes, në emër edhe të Rosinantit tim besnik, ju them se jeni shumë më të mirë nga ata. A ju qetëson kjo gjë? Ju nuk e dini që jeni më të mirë se ata, sepse jeni të çmendur pas kënaqësisë dhe seksit. Nuk ka më moral. Moral i liberalizuar! Morali tani është kënaqësia. Në emër të kënaqësisë ju mund të zgjoni edhe ferrin, të tradhëtoni, të mos jeni besnikë, të jeni imoralë, të flirtoni për qejf, për sport apo për inat gjithë ditën e gjithë natën, të distraktoni shokët tuaj, t'u vidhni kohën njerëzve, paqen e tyre. Në emër të kënaqësisë ju shkatërroni jetë. E keni bërë kënaqësinë motivin e jetës. Tani, prisni që qytetërimi ynë të zhduket, ashtu si u zhduk Atlantis. Të drejtat tona, detyrat, përgjegjësitë, e ardhmja, të gjitha i përkulen një bote të vetme, kënaqësisë non-stop. Miq, vetëm në ëndërrat tuaja të çmendura nuk ka rregulla, ligje natyrore dhe moral. Pra, a mos jeni në ëndërr në jetën tuaj të përditshme?

Përgjigja juaj standarte është:

"Kështu më pëlqen të bëj."

"E ç'të keqe ka?"

"E ç'është jeta në fund të fundit?"

Dhe ju ndjeheni të lumtur me këto justifikime të cilat nuk i besoni as vetë. Në një farë mënyre kjo është si të thuash në mënyrë të paskrupullt "Jam zuskë apo zuzar i ëmbël" ose "Jam debile apo maskara". Po ku doni t'ja dini ju, bëni hundën mënjanë dhe thoni "As ma ndjen fare!" Ju tregtoni mish gjithnjë e më shumë, dhe gjithmonë e më pak karakter dhe dinjitet. A nuk ju duhet më dinjiteti, o çupa?!

Ju mendoni se jeni të lumtur duke ndjekur njëri tjetrin me bishtin e syrit. A mos është lumturi kur ke rrotull një tufë me admirues? A mos do të thotë kjo se ju vlerësojnë, respektojnë dhe konsiderojnë? A mos do të thotë kjo se jeni në rregull me jetën tuaj? Me të ardhmen tuaj? A ju bën kjo gjë një djalë apo vajzë me virtyte? Apo virtyti nuk na duhet më se lidhet me ndërgjegjen dhe ju nuk keni ndërgjegje? A mos ju kurorëzon kjo mbret ose mbretëreshë në mbretërinë tuaj? A mos ju bekon kjo gjë me krahët e engjëllit? Jo, o bastardë, lëpirësa dhe pushta potencialë të të dyja krahëve. Copa rrotash që e shkatërroni jetën pa e nisur mirë.

Mbrëmë, në krevat, Dylqina më tha:

- Nuk do të dua asnjë njeri tjetër në botë veç teje.

- A ke bërë seks me njeri tjetër gjatë kohës që ke qënë e dashura ime?

- Vetëm një herë, me Rosinantin. Thjesht për fiksim, nuk e doja.

- Domethënë lejohet tradhëtia për të hequr një fiksim, boll të mos jetë dashuri?

- Po një fiksim ishte, çfarë t'u bë ty? Nuk jam as e para dhe as e fundit.

- Dhe rrezikon kështu dashurinë apo martesën?

- E po, kështu jemi ne gratë, lozim me zjarrin.

- Po pse me Rosinantin tim besnik dhe jo me Sançon e djallëzuar?

- Hm, sepse Rosinanti ma çoi kuriozitetin e m'u bë fiksim. Pastaj harrove që ishte Sançua ai që na prezantoi ne të dyve?

Ja çfarë jeni ju! Instikt, instikt, instikt, kjo është jeta juaj, digjeni nga ethet e seksit, nga dëshira për ta pasur ju çdo bukuri që ju del përpara. Oh, ç'humbje energjie! Ju harroni, ju nuk shikoni, ju nuk jeni të ndërgjegjshëm mbi bukurinë e vërtetë e të prekshme. Bukuria e cila nuk duhet të jetë talenti juaj i vetëm në jetë, nuk duhet përdorur si kartë krediti për të blerë të dashur, favore, pije, lokale, rroba, arturina, ngritje në përgjegjësi, seks, nëse nuk doni të jeni një person pa karakter, ose një hedhurinë për t'u sikterisur në koshin e plehrave të mishit të pavlerë. Dhe mos e varni jetën tuaj në kremastarin e kënaqësisë, nëse doni të ndjeni kënaqësinë dhe lumturinë e vërtetë dhe të jeni një engjëll. Një bukuri që ju e quani çmenduri.

Unë kapa heshtën. Rosinanti turfulloi. Ngrita heshtën dhe vazhdova. Nëse më thoni se çfarë po u them janë broçkulla, atëhere përfundimisht më keni thënë se nuk ka Zot, por Djalli po ju flet ëmbël në veshin tuaj të një vagabondi. Ju keni zgjedhur në këtë mënyrë të jeni imoralë. Edhe nëse thoni që këto që po ju them janë me vend dhe veprimet tuaja thonë të kundërtën, ju nuk keni karakter dhe jeni të pabesë, tamam ashtu siç bëjnë shumica e Dylqinave për të fituar një burrë, shumë burra. Po, natyrisht, ju mund të fitoni kalamaj të vegjël të moshës suaj, por jo burra. Ju do ta kuptoni këtë gjë jo sot, por atë ditë kur do të thoni "Jam e pafat. Jeta është

qelbësirë. Ah, sikur të kisha fatin e k….," duke harruar se jeni duke patur pikërisht atë fat që ju takon.

Të dashur miq! Rosinant, i kemi miq ne këta aguridhe? Rosinanti bëri hihihi! Të dashur miq, nëse brenda jush bëhen bashkë diçka objektive, që vjen nga jashtë jush, pavarësisht sa e mirë ose e bukur, me diçka subjektive brenda jush, por diçka e pavlerë, do të lindë vetëm një realitet i pakëndshëm. Kjo do të thotë se është subjektivja, individualiteti, ai që mbizotëron. Pra, një herë e përgjithmonë, është bota juaj shpirtërore që ka rëndësi, që e bën jetën të mirë ose të keqe. Nëse ju keni një botë shpirtërore të vockël, të varfër, të thatë, asgjë nuk mund të bëhet për t'ju ndihmuar juve, nga jashtë, bota objektive, për të dalë apo për të shpëtuar nga kënaqësitë apo lumturia kafshërore e rëndomtë e lindur me ju. Ky njeri do të bllokohet tek kënaqësitë sensuale, shoqëria e keqe dhe argëtimet vulgare.

Jo, more miq, Mançiotë, kënaqësitë më të mëdha janë ato të shpirtit, pavarësisht se sa lodheni ju t'i mbushni mendjen vetes për të kundërtën. Jam shumë i sigurtë se e keni ndjerë mungesën e peshës së trupit tuaj dhe vërshimin e gjakut deri në atomin e fundit përpara mrekullisë së buzëqeshjes së vajzës apo djalit që ju doni. Kjo është lumturia. Kjo është kënaqësia e shpirtit. ***Lumturia jonë varet nga ajo se kush jemi ne, nga individualiteti ynë dhe aspak nga ajo se çfarë ne kemi apo zotërojmë***. Në shumicën e rasteve mallkojmë e fajësojmë fatin, që vjen prej asaj që kemi ose pretendojmë të kemi.

Kush është i pasur në shpirt, nuk do të mbajë shumë sytë nga fati, ndërsa varfanjaket e shpirtit, budallenjtë, të vdekurit do të ankohen për fatin e keq gjatë gjithë jetës. Ata nuk do të shpëtojnë kurrë nga mërzitja e madhe nga e cila vuajnë pavarësisht se i ndryshojnë dendur shokët, rrethet shoqërore, kënaqësitë, argëtimet, baret, të dashurit apo dashurat. **Sepse nuk është ajo çfarë kemi që na e sjell lumturinë, por çfarë jemi, personaliteti ynë.** Kushti parësor dhe esencial i lumturisë është ajo që jemi. Kjo është një vlerë absolute.

Të kërkosh kënaqësitë dhe lumturinë me mënyrën e gabuar është si të pish verë të ëmbël kur gojën e ke të hidhur. Një shpirt i mpirë dhe i mefshtë sjell një uri të panginjshme për kënaqësi, shoqëri, pasuri dhe luks që, në realitet, nuk ju ndihmojnë, por ju varfërojnë gjithmonë e më shumë. Budallallëqet që bëhen në emër të kënaqësisë sjell vet-përbuzje dhe vet-neveri. Shikoni qëndrimin që mbani ndaj kohës së lirë. ***Njerëzit e rëndomtë shqetësohen se si ta kalojnë kohën e lirë; njerëzit e talentuar shqetësohen se si ta përdorin atë.*** Për hir të kënaqësisë, ju dilni me mundësinë e parë që ju krijohet me njerëz që as i njihni. A e njihni francezin e nderuar Volter? Në gjuhën e tij ai ka thënë: "Nous n'avons / que deux jours / a vivre: / ce n'est pas la peine / de les passer a ramper / sous des coquins meprisables" që në gjuhën tuaj, o Mançiotë, do të thotë : "Jeta është shumë e shkurtër : nuk ja vlen ta humbasësh në këmbët e maskarenjve të përbuzshëm"

A mos ju duket shumë e përkryer? Ideale? Keni frikë? Perfeksioni është këtu, atje, mes nesh, mes jush, sepse Zoti është kudo dhe ne flasim me zë të butë për të mos e thyer këtë kristal, këtë mrekulli, por edhe pretendojmë se nuk e shohim, sepse nuk e duam, oiii çfarë bagëtie! Madje ca prej jush pretendojnë edhe që nuk ekziston dhe jetojnë me dy personalitete duke menduar se u sjell mbijetesën, por në realitet sjell konfuzion moral dhe cmirë e zili brenda llojit dhe indiferencë jashtë tij. E nga se keni frikë? Superioriteti natyrisht e sfidon mediokritetin kur mediokrit bashkohen për ta poshtëruar atë. Vlera dhe lumturia në një zemër të madhe dhe intelekt të madh mund të gjenden vetëm brenda një personi dhe asgjëkundi tjetër. ***Thesar i shtrenjtë nuk është vetë lavdia, por merita që e fitoi.***

I mençuri nuk kërkon kënaqësinë, por MUNGESËN e dhimbjes. Përse? Sepse çdo kënaqësi ka një natyrë negative ndërsa çdo dhimbje ka një vlerë pozitive. Prandaj Volteri thotë, "Lumturia është vetëm një ëndërr, dhimbja është e vërtetë." Ideja se kënaqësitë ju bëjnë të lumtur është vetëm një iluzion shkaktuar nga zilia me një fund të palumtur. Dhimbja përjetohet pozitivisht dhe të mos paturit dhimbje është proporcioni real i lumturisë njerëzore. Duke i shtuar imunitetit nga dhimbja çlirimin prej mërzitjes ne fitojmë përbërësin më të mirë: esencën e lumturisë tokësore, çdo gjë tjetër është një ëndërr idiote në mes të ditës. Ai ose ajo që është debile, bredh me llapën jashtë duke ndjekur kënaqësitë e jetës dhe mashtrohet, kurse ai ose ajo që është i/e mençur i shmang dhimbjet dhe gjërat e këqia. Fatkeqësisht, pasi na kanë mashtruar, është shumë vonë. Ju mendoni se bota është krijuar për kënaqësitë dhe jeta është shumë e shkurtër për to. A nuk ju bie kurrë ndërmend se mungesa e experiencës së jetës ju hedh në një gjueti të pakontrolluar e pa frena për kënaqësi? Kjo babëzi e pakontrolluar për lumturi nga këto kënaqësi dhe veçanërisht ëndërrat e ngritura mbi to, që nganjëherë kanë formën e syve të bukur, trupit perfekt, buzëqeshjes engjëllore dhe seksit, shkatërron të gjitha bekimet dhe blatimet e kësaj bote. Ai ose ajo që ia arrin t'i largohet lakmisë për të pasur gjithçka dhe këdo që u del përpara, do të kenë suksesin e merituar.

Sa më shumë vlera që keni brenda, aq më pak të rëndësishëm janë të tjerët rreth e qark jush. Ju do të zbuloni se kopeja është e gëzueshme, gallatë, por e mërzitshme dhe ju do ta shikoni veten jashtë kësaj aftësie kopeje. Shopenhaueri që nuk ka lindur akoma do të thotë se atë që të tjerët nuk e kanë në cilësi, përpiqen ta kompensojnë në sasi. Tamam sindromë kopeje (© Don Kishoti) që do të thotë se kur i takon veç e veç janë engjëj e kuptojnë gjithçka, por kur bëhen tufë, humbasin arsyen. Kush ka ngrohtësi shpirtërore me bollëk, nuk ka nevojë për t'u ngrohur nga kopeja. Shopenhaueri do të thotë edhe një gjë tjetër të bukur. ***Miqësia apo shoqëria është pak a shumë si zjarri, kush është i zgjuar ngrohet nga një largësi e sigurtë, kurse debili vrapon drejt tij, digjet, tërhiqet në ftohtësinë e vetmisë dhe ankohet se zjarri të djegërka.***

A do lesh …. Adoleshentë, duhet ta kufizoni lakminë tuaj dhe ta zbusni zemërimin tuaj. Përdoreni inatin tuaj aspak të arsyeshëm për të përmirësuar veten tuaj. Përpiquni ta merrni shtruar dhe do të shihni se ku e kam fjalën. Mendoni për shoqërinë dhe bukurinë. Shmangni me shumë kujdes shoqërinë me ata njerëz me të cilët i vetmi komunikim është rreth kënaqësive dhe seksit. Jini krenar! Por duhet të keni diçka për të qënë krenar, kështu që bëhuni dikushi. Ca thonë që krenaria është mëkat. ***Le të jem i krimbur në mëkate që kanë të bëjnë me krenaritë e mia.*** Mos e tregtoni trupin tuaj. Mbrojeni intimitetin tuaj me shoqëritë tuaja. Mos i shpenzoni kot emocionet. Mos u shisni lirë, juve duhet t'ju meritojnë. Jini të ndershëm dhe të sinqertë. Kurrë mos flirtoni nëse i keni thënë "të dua" dikujt, sepse e njëjta gjë do ju ndodhë juve. Besimi reciprok nuk jepet, nuk falet; ai fitohet me besnikëri, devotshmëri dhe dashuri të përditshme. Përkushtim dhe vëmendje. Ndaloni së menduari seks ju bij … Unë e di që këtë fjalim DonKishotesk e kam mbajtur para një tufe trapash shurdh dhe memecë, ju dolo legena!

Më zgjoi kënga "I'll be there for you" e Friends. Pashë rrotull i hutuar. Kisha qënë në gjumë. Sa më shkonte Don Kishoti! Marr dhe pi lëngje frutash. Madje edhe lëng kaktusi. Pastaj i them vetes, 'Hajde, çohu Amalo, se dielli ka dalë!' Do të shkoja të ushqeja peshqit dhe pastaj prapë xhiro në qytet. Po nuk vajta në qytet. Shkova deri te një pemë që ka një si fytyrë njeriu mbi trung. E nxorra fotografi me celular. U ktheva mbrapsht, anash liqenit, përkundrejt qytetit. Një bukuri më e madhe më priste. Bare, restorante, parqe, trampolina, motoskafë, varka etj. Njerëz të kombësive të ndryshme, polakë të moshave të ndryshme. Secili në botën dhe argëtimin e vet. Çiklista, nga të vegjël e deri të moshuar, nga të cilët duhet të kishe mendjen, sepse kishin korsinë e tyre dhe mund të ndodheshe pikërisht atje. Adoleshentë që luanin voleiboll.

Kur u vela me të gjitha dhe kisha ecur mjaftueshëm për atë ditë, u ktheva në dhomë.

Televizori jepte se si ‘magjistarët’ i realizonin truket e tyre ku njerëzve u pritet koka, varrosen të gjallë apo digjen të gjallë. Hile banale që ta shpifnin. Oiiii! Një tjetër darkë e këndshme dhe një tjetër shi besnik si edhe filmi Silent Predators. Let’s enjoy it, darling!

Dita e pestë

Shi dhe erë, keni inat? Muzikë dhe Breshkat në TV. Një kalim të shpejtë postës elektronike në internet. Prapë shtrirë. Bredhat, pishat dhe ca pemë që nuk i njoh, aty jashtë ballkonit tim, më tundnin krahët e kokat e tyre sikur të talleshin e të krekoseshin sfidues. ‘Hë mo, shqiptar i qelbur Redbullist, doje të vije këtu ti, në tokën e Janoshikut, Adam Mickieviçit, Kopernikut, Shopenit, Papa Gjon Palit! E çfarë t’u thosha? U nxorra gjuhën, jo për emrat e shquar e të respektueshëm nga të gjithë, por për mbiemrin që përdorën. Le të zbukuroj qelizat e mia me lëngje frutash, thashë. Breshkat fituan.

Words don’t come easy

This is the only way

For us to say

I love you

Words don’t come easy.

Me telefonatën në darkë nuk më eci megjithëse provova katër herë. Ta vrisja mendjen apo të mos e vrisja mendjen, kjo ishte çështja. Për t’u kthjelluar përdora dushin dhe “I will survive” në radio. Ndërkohë që iku dhe një ditë, shpresoj jo kot sepse, sidoqoftë, ishte një ditë mbi tokë. Pas Dragoit të Fundit, ma kishte qejfi edhe një film tjetër. Aha, Denzel Washington! Oqej! Jo, ore, i ngjakërka, por nuk qenkërka ai. Mbase është ai, i sapo kthyer nga plazhi. Përfundimisht jo.

Dita e gjashtë

Natën ra shi. Pashë në ëndërr veten time të para disa viteve, adoleshent aguridhe. Si fëmijë kam patur atë tip që mamaja më ndalonte të luaja. Nganjëherë më quanin kastravec. Megjithëse vetë fjala kastravec më pëlqente, shprehja e fytyrës së tyre nuk përputhej. Dhe nuk kuptoja përse, kur kastravecit i mungonin disa fara, na bëhej i keq. Kur linda unë të gjithë u bënë të lumtur. Madje edhe doktori tha, "Mendoj se është bebe." "Uaa, i tha tezja babait, sikur e ke nxjerrë nga hundët." Unë u fyeva deri në palcë. E kush do që t'i ngjajë një pisllëku hunde qoftë kjo edhe e babait?

Megjithëse dihet që foshnjet në maternitet mund edhe të ndërrohen pa paralajmërim, unë e dija që isha unë. Ama dija edhe që isha një foshnje e parakohshme, sepse babai nuk më priste. Oh, të qarë që kam bërë ditën e lindjes! Nuk do ta harroj kurrë. Qaja tamam si bebe. Por më ngushëlloi fakti se linda trupmadh, aq sa doktorit nuk ja mbajti të ma fuste me shpullë, që të

merrja frymë fillimisht. Doktorët janë të këqinj, sepse përfitojnë shumë nga rasti që u jepet për të goditur një të pafajshëm.

Prindërit u vunë në hall të më blinin djepe apo kafaz. Fitoi djepja se kafazi ishte i shtrenjtë. Thonë se vite më vonë isha i djallëzuar, por asnjë njeri nuk e di se kështu unë kisha qënë qysh foshnje. Vura re se kur qaja të gjithë viheshin në lëvizje. Kjo më pëlqeu dhe, meqënëse të qaje nuk ishte fare e vështirë, qaja ditë e natë. Një natë, kur vendosa që të bëja një pushim, dëgjova babain që i tha mamasë, "Çohu, e dashur, dhe shiko përse NUK po qan foshnja." Kur qaja unë çoheshin të dy prindërit dhe i gjithë pallati. Babai përpiqej me sa mundej të ndihmonte mamanë lidhur me mua. Kështu, shpesh, ai merrte një sy gjumë në vendin tim. Prindërit thirrën doktorin, i cili, pasi më pa mirë e mirë, dhe pasi piu një filxhan me lëng bojëkaf ku bënte shumë zhurmë dhe një lëng të bardhë në një gotë të vogël ku bënte "ohoho", më dhuroi një diagnozë kapitale. "Ka probleme psikologjike."

Kur unë mbusha gjashtë vjeç, i dija të gjitha pyetjet që mund të bëheshin. Të gjithë përgjigjet do t'i dija kur të mbushja 16 vjeç, por mua nuk më nxitonte gjë. Pas meje lindën edhe tre fëmijë të tjerë, të pritur dhe të papritur. Pra, ne ishim një familje e varfër, sepse dihet që fëmijët janë të shtrenjtë dhe familjet e pasura nuk i përballojnë dot, prandaj bëjnë vetëm një ose dy fëmijë. Kur pas meje lindën dy bebe, për mua ishte normale sepse, kur në një familje lind një gjeni si puna ime, duhet të lindin dy fëmijë të tjerë më pas që të ushqejnë gjeniun. Lajmi i lindjes së fëmijës së katërt m'i trazoi filozofitë. Përveç babait, u revoltova edhe unë. Duhet të isha pyetur. Për fëmijën e katërt thanë direkt se më ngjante mua, por pastaj e kuptuan që e kishin fëmijën kokëposhtë.

Babai, pak nga pak, e ndroi mendimin se unë i ngjaja. "Trutë i ka nga e ëma, thoshte ai, se unë i kam akoma të mitë." Ama, ai u thoshte njerëzve se unë do të bëhesha ekzekutiv, drejtor, shef, sepse i kisha të gjitha shenjat. Kur ulesha për drekë ngrihesha vetëm pas dy orësh. Në atë kohë, e kuptoja që isha në moshë kritike, shumë i madh për të qarë, por edhe shumë i ri për të sharë apo për t'i marrë makinën babait. Që po rritesha këtë e kuptoja se nuk po pyesja më si kam lindur, ku më gjetët, dhe refuzoja të tregoja se ku shkoja.

Fillova shumë shpejt të kisha gjëra inat. Sa inat që e kisha çdo gjë që qe e mirë për mua! Psh spinaqin. Nuk e shikoja dot me sy. "Shpirt, haje spinaqin se të ngjyros faqkat dhe të bën Bracio Di Ferro," thoshte mamaja. Po kush donte faqe jeshile? "T'i bën dhëmbët e fortë," thoshte babai. "Jepini gjyshit më parë!" bërtisja unë. Po unë, megjithatë, e haja spinaqin me zell, sepse doja të bëhesha shpejt i madh dhe i fortë, që të isha në gjendje ta refuzoja. Babai thoshte se ky djalë është prishur dhe më vinte inat se ishte faji im. Ata nuk më futën asnjëherë vetë në frigorifer.

Problemet e mia të vërteta filluan rreth moshës tetë vjeç, dhe e dini pse? Sepse unë isha më i madhi i fëmijëve dhe më ngecnin të gjitha djallëzitë e tyre. Kështu, kur një ditë po qante vëllai i vogël poshtë pallatit, mamaja doli me vrap dhe më pyeti se çfarë kishte. Po a mos ishte faji im që ai donte të zbriste shkallët pa ecur? Një herë tjetër po qante një vëlla tjetër.

"Përse e godite vëllanë me shqelm në bark?" ulëriti mamaja.

"Ai u kthye vetë," - thashë unë.

Nuk e kuptoja përse e kishin kapur të gjithë me mua. Kur uleshim për të ngrënë, vetëm mua më bërtisnin.

“Amal, mos e ha supën me thikë!”

Mirëpo çfarë të bëja unë që piruni rridhte?

Ata e thirrën përsëri doktorin kur unë futa një bretkosë në krevatin e motrës. Unë bëra ç’është e mundur që t’i fusja një mi, por nuk e kapa dot. Doktori më vuri dorën mbi kokë, gjë që unë nuk e duroja dot, dhe më shkeli syrin si mik i vjetër. Unë i dhashë të njohur duke i kafshuar gishtin.

“Çfarë halli ke more djalë?”

“Nganjëherë më vjen të vras veten, çfarë të bëj?”

“Asgjë, tha doktori, këtë gjë ma ler mua.”

Unë e urreja doktorin si rival, sepse kisha vendosur të bëhesha vetë psikiatër. Mamaja mendonte se ai ishte psikiatër i mirë. Sipas saj ai e kishte ndihmuar shumë. Më parë mamaja nuk i përgjigjej kurrë telefonit, kurse tani, pas trajtimit nga doktori, bie apo nuk bie zilja, mamaja e merr telefonin. Psikiatri i parë, thoshte mamaja, nuk ishte gjë. Ai në vend që të shëronte mamanë, kishte ikur vetë nga fiqiri.

Babai e mori doktorin mënjanë. “Sa kohë mund të jetojë një njeri pa tru, doktor?” “ku e di unë,” tha doktori duke ngritur supet. “Ju sa vjeç jeni?”

Diagnozën time nuk e mora vesh, se doktori e tha së prapthi, por mamaja më përktheu një pjesë, (ajo i di të gjitha gjuhët e botës) duke më thënë se duhet të rri më shumë në ajër të pastër. Qysh nga ajo ditë unë rrija shumë jashtë, aq sa një ditë më uruan që të mos kthehesha më.

Gimin e kisha shok të ngushtë. Më duket se ishim moshatarë sepse e kisha në klasë. Kur dilnim nga shkolla i fusnim një xhiro nga parku dhe uleshim në bordurën e trotuarit. Shushurima e gjetheve na i zbuste shpirtrat dhe ngrohte sytë. Në këto çaste ne i hapnim zemrat njeri tjetrit.

- Dje, i thashë unë, pashë një Toyota dhe një BMW kur u përplasën. Të shikoje si u bënë, si hieroglif kinez.
- Eh, tha Gimi, babai im e hëngri para një jave. Pati një aksident të tmerrshëm. Babai im kishte patur të drejtën e kalimit, por ai tjetri kishte kamionin.
- Uau! Kurse mamaja ime nuk kishte bërë kurrë aksidente deri vjet. Pastaj bleu veturë.
- Unë mendoj se mënyra më e mirë për të shmangur një aksident me veturë është të udhëtosh me autobus, thashë unë.
- E njeh Adin, tha Gimi, atë quksin e klasës B? I ra i ati nga çatia.
- Vërtet?!
- Po, ma tha Adi vetë. Kur kishte rënë i ati ai i kishte thënë të ëmës që babi sapo kishte rënë poshtë dhe e ëma i kishte thënë, “Po, e di shpirt. Sapo kaloi pranë dritares.”
- I shkreti Adi! Ore Gimi, e mban mend ti kur linde?
- Jo, isha shumë i vogël. Di vetëm që më ushqenin me hudhra, që të më gjenin kollaj në errësirë.

- Ne kemi një bebe të re në shtëpi, thashë unë duke vrarë mendjen nëse ky lajm ishte i mirë apo i keq.
- Kjo nuk është asgjë. Adi ka baba të ri. Po, mirë, me beben e vjetër çfarë bëtë? Pyeti Gimi.
- Oh, të vjetrit i vunë një emër dhe e kaluan në dhomën time.
- Unë nuk do të martohem kurrë, tha Gimi mendueshëm. Babi thotë se çdo burrë i varfër dikur ka qënë një beqar i pasur.
- Kujt i thonë beqar?
- Beqar është ai që bën çfarë i do prapanica. Jo të gjithë burrat janë budallenj. Ca janë beqarë, Amalo.

Gimi ishte tip filozofi se i jati kishte lexuar shumë libra. Unë nuk e merrja inat. – As unë nuk dua të martohem, shtova unë. Unë tani vishem vetë. Pastaj, gratë ta harrojnë emrin dhe unë këtë e kam inat.

- Edhe mami im ia harron emrin babit. E quan me lloj-lloj emrash. Sot i tha morr.
- Mami im preferon ta quajë babin me emra që nuk marrin frymë psh fyell, trap, lloz, kaish. Nganjëherë hidhet edhe nga zarzavatet: kastravec, kungull, ferrë.
- Jo, mami im nuk ka qënë mirë në biologji. Po të dëgjosh mamanë time nga jashtë kur i drejtohet babit mund të kujtosh se te ne është kopësht zoologjik: majmun, derr, qën, ujk, mi, papagall. Prandaj jam shumë mirë në zoologji unë, Amalo.
- Unë më mirë rri i pamartuar dhe ta kem këmishën pa komça, se sa i martuar dhe pa këmishë.
- Burrat janë budallenj që martohen me gratë, por me çfarë të martohen pa?!
- Babi im thotë se të gjitha martesat janë të lumtura, por të jetuarit sëbashku sjell probleme.
- Dëgjova se Bimi, vëllai i Adit, u martua.
- Mirë t'i bëhet. Ai është burrë i keq. Është pijanec. Ai ka dy muaj që nuk e di që uji është prerë në lagjje. Mamaja e tij ka frikë që të ndezë ndonjë shkrepse afër Bimit.
- Unë nuk do të pi kurrë po të mos jem vetëm ose me ndonjë shok, i thashë unë me bindje të plotë duke i vërvitur një gur një guguftuje pendërrjepur që lëshoi glasën para nesh.
- Më vjen keq për Adin që ka vëlla.
- Po ti ke vëlla, Gimi?
- Jo, unë nuk kam, por motra ime ka.
- Unë kam katër, por nuk ua di të gjithëve emrin.
- Po motra?
- Kam dy.
- Kur u martuan prindërit e tu?
- Ohu, shumë kohë më parë se të lindja unë, besoj.

Për një kohë nuk folëm dhe godisnim njeri tjetrin me shqelma. Ishte pranverë. Unë i pëlqeja të gjitha stinët. Në verë pëlqeja dimrin dhe në dimër pëlqeja verën.

- Po shkon ora e gjumit, tha Gimi duke hapur gojën sa një atlete e shqyer.
- Kaq shpejt? thashë unë.
- Unë fle me pulat, tha Gimi.
- Unë preferoj të fle vetëm në krevat, i thashë.
- Ti je gjumash, tha Gimi, gjumash neorealist.

Ju thashë që Gimi është filozof. Ai vazhdoi: - Çfarë të tha mësuesi sot te banka?

- Më tha që s'mund të flija në klasën e tij, por unë i thashë që po të fliste me zë më të ulët, mund të flija për bukuri.
- Hihihihi, qeshi Gimi.
- Unë nuk gërhas, po ti Gimi?
- Unë gërhas vetëm në gjumë. Është kollaj fare. Kur gërhet është mirë se rrinë zgjuar ata që flenë në një dhomë me ty dhe të ruajnë ty. Kam detyrat për të bërë, tha Gimi pas pak duke u çuar. Prapë babai t'i kishte bërë detyrat ty, Amal?
- Jo, sot i kisha bërë gabim vetë.
- Mua më pëlqen shkolla, tha Gimi.
- Edhe mua më pëlqen, por e mbyllur. Shkolla është një vend ku kalamajtë shkojnë të marrin gripin nga kalamajtë e tjerë, që të rrinë në shtëpi, por mua nuk më pëlqen të rri në shtëpi. Megjithëse nuk marr notat më të mira në shkollë, nuk mërzitem shumë, se edhe babai im nuk merr rrogën më të mirë në zyrë.

Gimi u ul prapë, i nemitur nga habia. Ishte hera e parë që unë flisja tre fjali radhë dhe që lidheshin me njera tjetrën.

- Ata e shkruajnë historinë më shpejt nga sa mund ta mësoj unë. Hiç nuk më pëlqen shkolla, shtova unë i frymëzuar.

Kur fillonin të lehnin qentë, kur ne nuk shikonim më njeri tjetrin, kur ftoheshim nga trotuari dhe fillonin gazrat, ne e kuptonim se kishte ardhur koha të merrnim pjesë në sherret që bëheshin në shtëpitë tona.

Sherret në familjen tonë Adams fillonin si gjithmonë pa paralajmërim dhe, për këtë, meritën e kishte mamaja. Ajo ishte mjeshtre që të nxirrte sherr nëntë ballësh edhe nga një fjalë ose shtrembërim buze. Atë natë, një shoqe i kishte treguar mamasë nga karrikja e permanentit se burri i saj kishte pyetur babanë tim në kishte patur gjatë jetës një aksident me makina dhe babai i ishte përgjigjur se vallah gruan e tij, dmth mamanë time, e kishte njohur në një pikë karburanti. Pasi mamaja i mbajti një leksion historie të lashtë lidhur me familjen e tij, të cilin ajo e kripte me fjalorin e saj personal therës, u hodh në inventarin e punëve që ajo bënte në shtëpi dhe, më pas, i aludoi një listë princërash që na i paskëshin kërkuar asaj dorën dhe që akoma na qenkëshin beqarë duke pritur, si korbi pas ko.. të dashit, që mamaja të bëhej dikur vejushë. Në fund mamaja i bënte babait një përshkrim shumë të gjallë fizik, të cilin do ta kishte zili edhe kafsha më simpatike mbi këtë dhé.

Ne kalamajtë rrinim ulur në divan, në radhë, sipas moshës, dhe dëgjonim e shikonim me interes. Atëhere nuk kishte televizion dhe as hip – hop dhe as celularë. Fshehurazi ne vinim baste me njeri tjetrin se sa pjata do të thyheshin, kush do tërhiqej i pari dhe kush nga kalamajtë do ta hante shpullën nga mamaja.

- Ti moshën time e mban mend po ditëlindjen ma harron, i bërtiste mamaja.
- E ku ta di unë moshën ty, kundërpërgjigjej babai. Ti ke pesë vjet që je dyzet vjeçe.
- Mos u gdhifsh nesër ishallah! Ti e mban mend ditëlindjen tënde të fundit, unë jo.
- Cilën? Atë që më bëre surprizë duke më bërë mëngjesin gati?
- Pse, cilën tjetër? pyeti mamaja me sytë në tavan.
- Po, ka edhe një surprizë tjetër, tha babai, atë kur më le që të kisha unë të drejtë.
- E po, e sheh, pra? Dhe më ke lënë lakuriq. Nuk kam një gjë përsëmbari për të veshur.
- Po ti e ke dollapin plot.
- Pse rroba janë ato?!

Babai pa nga ne i habitur, për mbështetje. Ne kthyem të gjithë kokën mënjanë sikur nuk e kishim mendjen. E lamë në baltë. Gjuha e mamasë ishte më e hidhur se pëllëmba e babait. Unë ia dija një sekret babait. Ai i fshihte gjithmonë paratë tek rrobat që kishin nevojë për ndonjë qepje. Aty mamaja nuk ia gjente kurrë. Babai im ishte burrë i zgjuar. Babai u nxeh më keq.

- Po unë që e mbaj pallton gjithmonë të mbërthyer deri në fyt që të mos më shohin që nuk kam këmishë veshur.
- Ti nuk kishe asnjë rreckë për të veshur përpara se të martoheshim bashkë, çfryu mamaja.
- Nuk kisha vërtet. Kam tani rrecka me bollëk.

Këtu mendova se do të ngecte mamaja, por duket se nuk e njihja mirë.

- Sipas kokës festën, tha ajo.

Këtu babait nuk i mbajti më kultura, - Mbylle, moj, atë hale! Si gjithmonë babai ndodhej në pozicion të zbuluar, shtrirë në divan, kurse mamaja pranë bufesë ku ndodheshin gotat dhe pjatat. Kështu, mamaja mori një gotë dhe e gjuajti, por babai e priti, e vuri mënjanë në largësi kapjeje kollaj. Ne kalamajtë duartrokitëm. Beteja premtonte. Babai e sulmoi pastaj mamanë atje ku asaj i dhembte më shumë.

- Sa here që ti provon të gatuash ndonjë gjë të re, mua më jep doktori një recetë të re. Unë vetëm kur u martova me ty, fillova të lutesha përpara se të haja.

Mamaja turfullonte, por babai lozte në fushën e tij. Atëhere ajo i hodhi një bombë.

- Mos e kishe fjalën për mamanë tënde?

Babai i vërviti jastëkun, kurse mamaja bëri hedhje disku duke gjuajtur një pjatë të pajës së saj. Ajo thoshte se të gjitha pjatat në shtëpi ishin të pajës së saj që do të thoshte se vetëm ajo kishte të drejtë t'i thyente.

- Mamasë sime i merr pleshtat ti, tha babai duke i nxjerrë bojën të shoqes për vjehrrën që kishte. – Shiko mamanë tënde ti që vetëm dy herë vjen në vit dhe rri nga gjashtë muaj.
- Mortja që nuk të ha, tha mamaja, mamaja ime ka një binjake.

Ne kalamajtë pamë njeri tjetrin. Edhe po t'i bashkonim trutë tona në një, nuk do ta gjenim dot këtë muhabet tym të mamasë, pa lidhje.

- Ç'të kam bërë që më jep lajme kaq të hidhura, tha babai duke zënë kokën me dy duar. – Unë e kam dashur vjehrrën tënde më shumë se vjehrrën time.
- Ti je teleshmën, i tha mamaja turqisht.
- Ti je psikopate, ja ktheu babai greqisht dhe, për ta betonuar këtë, shtoi, - Ti ke çmendur dy psikiatra deri tani.
- O zot, çfarë i thotë gruas së vet! Po gruaja ka dalë nga brinja e burrit.
- Po, po zoti u ngatërrua dhe, pa dashje, mori atë brinjë që Adamit i kruhej shumë.
- Ti je palo burrë, tha mamaja.
- Palo burrë me shtatë kalamaj?! vërejti babai.

Mamaja qeshi me djallëzi. Babai i vërviti gotën që e ruante për ditë të keqe. Mamaja e shpërbleu me dy pjata balte.

- Ti je llafazane, i tha babai, gjithmonë të nxihet gjuha në plazh.
- Ti je injorant.
- Ti je inteligjente, e di. Prandaj nuk bleva enciklopedi. Ti i di të tëra.

Këto beteja të vogla ndodhnin dendur kështu që netët e mërzitshme ishin të pakta. Zakonisht fitonte babai i cili, pasi mamaja nxirrte armën e saj sekrete, dmth lotët, thoshte fjalën e fundit, "Ke të drejtë e dashur!" Me këtë fitore të babait, të gjithë shkonim të flinim. Babai në divan, mamaja në dhomën e gjumit duke menduar se si të hakmerrej dhe i shkonte mendja tek komshiu.

Në mëngjes retë ishin çjerrë e në një çast dielli tha "Hello!" e u fsheh. Nuk nxitova të dal. Kjo radio Wama qenkërka si TopGoldi dhe Love Radio, këngë sipas qejfit tim e tek tuk ndonjë reklamë. Kur vajta për mëngjesin, pashë se gjermanëve u kishin ardhur përforcime. Shajzen! Dy veteranët gjermanë pranë tavolinës sime po rënkonin nga grykësia dhe kënaqësia e ngrënies. Njëri mori kavanozin e vockël me mjaltë dhe e ktheu të gjithin në gojë, kurse tjetri pjatën me copa domatesh dhe e shkarkoi çfarë kishte mbetur brenda shpellës së tij. Dy gjermanë të hollë e të gjatë. Po ku e fusnin të gjithë atë që hanin? Vetëm në mos qofshin brenda vetëm stomak, nga gryka e deri tek rektumi. Urrrraaaa! Po del dielli, brohorita unë.

Çirru, çirru o re

Lere qiellin të mbulojë dhenë

Lere diellin të thurrë gëzim

Çirru o re, çirru

Të zgjohen ata që flenë

Nga gjumi gri në të lumturin zgjim

Çirru, çirru o re!

Kuptohet, vura kapelen, mora aparatin fotografik dhe iu turra Mragowos. Bëra poza andej-këndej. Dola edhe te busti i Papa Gjon Palit ku një grua donte të më rekrutonte për një eskursion në Letoni. Tha që vinte nga Kanadaja, dhe duke iu përgjigjur vetullave të mia të ngritura, tha se anglishten nuk e manovronte mirë, as si thikë për të shtruar gjalpë kikirikash mbi bukë, sepse nuk kishte shumë kohë në Kanada. Ishte polake.

Një vizitë bregut të liqenit të madh, pastaj një park e një liqen tjetër i brendshëm. Aty vetëm liqene kishte. Ndodhte që kishte edhe tokë, atje ku ishte ndërtuar qyteti. Duhej të zgjidhja një problem. Më kishte zënë syri një supermarket ditën që kisha ardhur e doja ta gjeja. E gjeta. Kalova ca orë të mira atje dhe meqënëse jam mjeshtër në bërjen e parave rrush e kumbulla, pas ca orësh, dola nga supermarketi më i lehtë nga xhepat. Kurse gratë e bëjnë

ndryshe, blejnë dy ose tre gjëra të mira për vete, të shtrenjta, pastaj për kinkaleritë mbajnë sytë nga burrat. I keni parë tregjet e shumicës dhe pakicës? Gra, gra, gra dhe ... vajza. Burra? Vetëm shitësat. Skema: burrat çojnë paratë në shtëpi në darkë, gratë dhe vajzat i harxhojnë në mëngjes. Shoqëri perfekte konsumi.

I ngarkuar nga pazari, që kryesisht ishte lëngje të ndryshme frutash, mora rrugën e kthimit, por sikur nuk po ma kishte terezija me qeska në duar, dhe, në qendër, si një tip turisti bos që nuk i bën hesap paratë dhe shkon në tualet me makinë, mora një taksi. Ç'e do nuk më pa njeri. Sa futa këmbët në dhomë, plasi shiu. Unë i nxorra gjuhën. Shkova të nisja një email, por ma ngopi sinjali nga mesi, iku.U ktheva në dhomë, u mbështolla me muzikë dhe po studjoja hartën e zonës duke nënvizuar të gjitha vendet e shkelura. Jam dorë. Një zhgënjim, megjithatë. Tek libraria e qytetit, goxha e madhe, nuk kishte libra anglisht, vetëm tekste mësimore dhe polonisht. U mërzita shumë. Përse nuk keni libra anglisht, i bërtita vajzës së shkretë te dyqani që mezi kuptonte anglisht.

TV po jep lajme mbi luftën Izrael – Hezbullah. Qindra civilë të vrarë, kryesisht gra dhe fëmijë. Po OKB-ja ku është? Si e fiton bukën e gojës kjo organizatë që u krijua të PARANDALOJË, të mbrojë e të zgjidhë konflikte, të paqëtojë vendet. Çfarë pret OKB-ja? Të arrijë qëllimin Izraeli e mbrapa tij Amerikani dhe pastaj të shkojë OKB-ja të ruajë statukuonë? A nuk quhet pisllëk dhe hegjemonizëm ky? A nuk është bota më pak e sigurtë kështu? A mos është OKB-ja një konflikt gjigand interesi? Insektet shkelen me këmbë. Anan, u nxehe zotërote se të vranë ca veta nga të tutë. Po t'i kishe hequr, o çun! Çfarë vrojtoje ti atje? Po a kanë gratë dhe fëmijët e masakruar nevojë për vrojtimet e tua vallë? Dale, prit radhën e hyrjes në lojë kur të të thotë përgjegjësi. Kështu që futi një fjalim e shko të lozësh golf. Ç'faj të kanë fëmijët, o Anan? Në ç'politikë hyjnë këta fëmijë? Në viktima ligjore lufte? Po mirë, sikur një fëmijë, apo i rritur anglez, apo amerikan të vritej diku, me dashje apo pa dashje, çdo të ndodhte, Anan? Mallkuar bota moderne dhe ajo e moderuar!

Kurse Whitney Houston i bie tjetër avazi. Qaj Houston, qaj.

You can't hold any more, Nuk mund të durosh më

don't you dare to walk away from me! As mos guxo të largohesh nga unë

You'll get used to it, don't worry! Do të mësohesh, mos u shqetëso!

E di Houston se çfarë thonë çupat tona? Ca si shumë prej tyre thonë, quote, "Shkolla është sebep për të ikur nga shtëpia e për të bërë qejf." "Pastaj si të jetë fati." Po sa peshon ti, moj zogëzë? Sa kushton ti? Se pazari ka rënë shumë për shkak inflacioni, shiko rrugën sa është populluar. Po ti zogëz, a mos rastësisht fat quan që një i parametrave të tua, që ti sigurisht nuk e dashuron, të çmendet pas teje, ti t'i hedhësh trutë e gomarit dhe ai të të mbajë në pëllëmbë të dorës, të të pranojë, quote, "Ashtu siç je" me parimin të shesim mish e të rrojmë të sotmen? Ky është fati i mirë për ty, o trumcak? Po mirë, moj zemër, ti kësaj jete i ke hyrë, me tafti-bafti, të tashmen e ke jetuar sa ke plasur, atëhere ç'të shqetëson në të ardhmen? Sa fat që kanë ato injorantet, provincialet, të pakulturuarat, peshkopet, debilet! Hëm! Sa m'u lodh çupa në

shkollë mua të gjorës! Sa para të duhen për provimet, e bukura e mamasë? Para 1990 kishte tre kategori femrash:

- femrat e mira, besnike e të ndershme,
- femrat që bridhnin lule më lule, zer e ler të dashur të cilat, në atë kohë quheshin 'kurva' aq sa ka edhe një shprehje "Patsh fatin e kurvës!"
- femrat prostituta që prostituohen për para, nga halli për të jetuar.

Sot a mund të më thoni se ku janë këto tre grupe, apo si përkufizohet sot kategoria e dytë, sepse me aq sa kuptoj unë kemi kategorinë e parë, dmth vajzat e mira, kuptohet të reduktuara shumë si numër, sepse plasi peshku dhe u bë deti kos dhe kategoria e tretë, prostitutat. A mund të më thoni se çfarë u bë me kategorinë e dytë?

Vrisni mendjen. Ndërkohë dua t'ju flas pak për kategoritë e njerëzve në funksion të asaj se sa inteligjentë e sa punëtorë janë. Dihet që njeriun nga majmun në njeri e bëri puna dhe po puna do ta kthejë në majmun. Gjithashtu dihet se puna është themeli i jetës, i të mirave materiale dhe shëndetit. Pra, duke marrë për bazë punën dhe qëndrimin ndaj saj, njerëzit ndahen në pesë kategori, të cilat paraqiten gjeometrikisht me figura gjeometrike. Po t'i ndajmë këto figura gjeometrike në mes me një vijë horizontale kemi dy pjesë: pjesa e sipërme, ose koka, pra inteligjencën dhe pjesa e poshtme, ose prapanica, pra puna. Atëhere, pesë figurat gjeometrike që simbolizojnë pesë kategoritë njerëzore janë: trekëndëshi me bazë poshtë, trekëndëshi me bazë lart, rombi, katërkëndëshi këndëdrejtë dhe rrethi.



1. Trekëndëshi me bazë poshtë përfaqëson atë grup njerëzish, të cilët nuk shquhen për inteligjencë, por janë shumë punëtorë. Duke qënë se çdo gjë e arrijnë me punë, kjo punë nuk i le në baltë. Meqënëse trekëndëshi e ka bazën poshtë, do të qëndrojë gjithmonë në këmbë, po ashtu edhe njerëzit që hyjnë në këtë kategori.
2. Trekëndëshi me bazë lart përfaqëson atë grup njerëzish që janë inteligjentë, por që janë shumë dembelë, nuk punojnë dhe mendojnë se inteligjenca mjafton. Trekëndëshi me bazë lart tregon më së miri se inteligjenca nuk mjafton, ajo nuk të mban në këmbë, si ky trekëndësh që nuk mund të qëndrojë sepse mungon themeli që është puna.
3. Rombi përfaqëson atë grup njerëzish që nuk kanë as inteligjencë dhe as janë punëtorë. Janë të mbaruar. Këta janë ata që u shërbejnë të tjerëve.

4. Katërkëndëshi këndrejtë përfaqëson atë grup njerëzish që janë edhe inteligjentë edhe punëtorë. Këta janë ajka e shoqërisë dhe të parët që mbijetojnë.
5. Rrethi përfaqëson pak a shumë një grup njerëzish që rrokullisen, kanë pak nga të gjitha, dhe sido që të vijnë rrethanat ata janë aty: as shumë mirë dhe as shumë keq. Pak a shumë si shqiptarët.

Vjen çasti që më pëlqen shumë, ku e fusni veten ju?

Për barazpeshim, dua të përgjithësoj burrin tipik shqiptar të martuar. Ngrihet në mëngjes, vjen rrotull, sepse kërkon gjëra që nuk i di ku i ka. Pasi bën ca sherr me gruan se nuk do që të ndrrojë këmishën, ikën në punë. Kthehet nga puna. Hyn në shtëpi me këpucë se përton t'i heqë. Do të hajë drekë ku duhet të ketë mish, ha llokmën më të madhe të mishit, tenton të marri edhe pjesën e gruas, ha si i babëzitur duke pirë birrë, verë ose raki, pyet gruan se çfarë ka bërë gjithë ditën, filozofon, kruan dhëmbët, gogësin, ulet në kolltuk për të lexuar gazetën, e çon televizorin në ndonjë sport ose i bën zbor kanaleve pa e mbajtur diku, pi duhan duke i rezistuar pretendimeve të gruas dhe fëmijëve se duhani u shkakton dhembje koke, shkon t'i fusë një gjumë, pasi i ka dhënë gruas porosi për darkën, ngrihet nga gjumi, vishet dhe del, takon shokët, i fut një bilardo, bingo ose kafe e raki deri vonë, nëse nuk i del ndonjë kukurec gjëkundi, kthehet dhe kërkon bërxollë për darkë, gjellën e drekës nuk e ha duke pretenduar se punon e lodhet gjithë ditën, tymos shtëpinë, bën ca sherre, nuk interesohet për shkollimin e fëmijëve, nuk pyet se për çfarë kanë nevojë, nuk mbanë mend data, nuk rregullon telin e rrobave, shkon të flejë dhe i thërret gruas nga dhoma e gjumit. Gruaja shikon tavanin dhe vendos të bëjë njërën që "për hir të së ardhmes së fëmijëve" të provojnë emigrimin në Amerikë ose Kanada duke menduar se do të shpëtojë nga "mashkulli shqiptar", duke harruar se mashkullin shqiptar do ta marri me vete dhe duke harruar se **ai është mashkull shqiptar, sepse është ajo një femër shqiptare.**

I'm in love Jam i dashuruar

Forgive me Më fal

I've been blind Kam qënë i verbër

Love is all what I need Dashuria është ajo që më nevojitet

To know my name Për të mësuar emrin tim

Love will help me know my name.Dashuria do t'më ndihmojë të mësoj emrin tim

Mbasdite, që e kaloj brenda. Rroftë radio Wama! Tiger Woods – 97 milion dollarë, Shumaker – 80 milionë dhe Ronaldinjo – 29 milionë. Nuk e mora vesh, në vit apo gjithësej?

Uuu, çfarë skandali! Kam kaq ditë këtu dhe nuk e kam parë hënën polake. Wow! Ik ore Bradt Pitt megjithë atë pushkën tënde! Poshtë Bonny M.! Edhe ti Bandera po dole sonte, e hëngre. Kur njeriu nuk organizon gjithë ditën për dy minuta në darkë për veten e vet, atëhere, ose nuk dashuron, ose për se të vlen telefoni? Për të tjerë? Këto i thosha vetes, ndërsa nuk kuptoja polonishten në TV.

Ora 9 e darkës. Nga dhoma, nga e majta ime, ku rrinë dy gjermanët pleq, dëgjohet një zhurmë, pastaj ca ulërima rrëqethëse kokëqimengritëse. Qetësi. Ç'të jetë vallë? Edhe në dhomën djathtas ca zhurma anormale. Më duket se do shkruaj një libër tip Agatha Kristi. Po alarmi ishte i rremë dhe ëndërra ime flluskë sapuni Rrogozhine. (Është më ajo fabrika atje? Si, more, qelbanikët, i prishën të tëra fabrikat dhe uzinat!) Po që nuk më duket vetja si jashtë shtetit fare!

Dita e shtatë

Hë mo se gjeneralët SS ishin mirë dhe po punonin gjithë zell në kampin e çfarosjes në masë të tavolinës së tyre. Fillova edhe unë me stilin tim të përkorë. Po ku të linin ata me rënkimet, ulërimat dhe çfryrjet e kënaqësisë nga ngrënia? Sa sadista paskan qënë, për kokën e tyre! Ore, mos janë gjë ata, bashkë? Njëri ia hodhi që tej sytë pjatës sime. E pashë në kokërdhok të syrit që t'i kujtoja 29 Nëntorin.

U hodh koçka sy shqiponjë

E mbërtheu Lecin me thonj

Trokitje në derë. Telefon, Amal.

- Hë mo, çuno, si po ja kalon?

- Mirë, o Vala, shi.
- Edhe ke dalë, o Amalo, se kam marrë përditë.
- Po, edhe kam dalë. Mund të kem qënë në ballkon ose banjo.

Vali qeshi valçe. – Vjen Inisi sot.

Akoma gri. Animal world on TV.

I can't swim in the moonlight Nuk mund të notoj në dritën e hënës

Can't dress the glamorous mantle Nuk mund ta vesh mantelin e lëbyrtë

Of the sun Të diellit

Can't drink the lake shimmering Nuk mund ta pi liqenin vezullues

Can't stroll the path Nuk mund ta bares rrugicëzën

Can't Nuk mundem

But I can love you Por ty mund të të dashuroj

Distance makes no difference Largësia nuk ka asnjë rendësi

For hearts. Për zemrat.

(Amal)

Oii, ç'më zuri shiu! Pasi i kisha ardhur rrotull Mragowos duke ngrënë Black currants..., prit se harrova. Kur po shkoja te supermarketi M&Ch takova dy Gebelsat. Kishin blerë një shportë të vogël plastike. Halt! U bërtita. Ahtung! Ata qëndruan. Më identifikuan. Ngrita aparatin dhe u bëra një pozë. I kam dokument. Pastaj më treguan se ku t'i shkëmbeja Eurot. Kur dola nga supermarketi dhe po vija rrotull, sikur më kapi veshi shqip, por e thitha me vonesë, si Tomi. Ktheva kokën, ishte një burrë dhe nja tre femra. Patjetër shqiptarka duhej të kishin qënë. Lakuriq. Fjalët që dëgjova kur u shkëmbyem ishin, "Për maskim". Një pjesë nga ne vetëm për spiunllëqe, hajdutllëqe, femërllëqe e drogllëqe flasin tërë ditën. Kush ua ka ngenë, dhe meqë qielli nga gri po nxihej, thashë 'Jepu Amalo këmbëve!'

Kështu që më kapi i pabesi në mes rruge, poshtë pemëve, anës liqenit. Pas nja dhjetë minutash, kur u duk se u taraks pak, u dhashë këmbëve. U laga një çiçkëz, por jo në kokë se kisha kapelen time besnike bezhë. Vetëm këmisha e fanellatës që më dhuroi Vala në Varshavë u lag. Unë shpëtova.

Bozhe moj, Klubi i Kavalierëve, filmi polak që e kam parë 15-16 vjeç, vite e vite të shkuara, krahë për krahë me një vajzë të klasës:

Mesjë Romanovski

Nashi Kavaljerski!



Ç'mrekulli të shohësh diçka që të kthen vite pas për të cilat nuk të vjen zor nga vetja, e ndihesh mirë. Oh, doli dielli jashtë! Dola nga liqeni i vockël poshtë shtëpisë, erdha rrotull duke pirë diçka e duke bërë foto. Kur u ktheva, u hodha edhe një sy librave gjermanisht në raftin e vogël në korridor. Hurray! Gjeta një libër në anglisht. Ky është fat, i vonuar, por fat. Big hair. Libër për flokët, bjondet e konvertuara që japin mesazhin "Jam e disponueshme". O zot, ku më gjejnë mua këto gjëra! Po pse o Kanadez, o zoti Grant McCracken, i diplomuar në Çikago me titull PhD, kurator në Departamentin e Etnologjisë në Muzeun Mbretëror të Ontarios. Po pse, o çun, më del përpara me këtë informacion të ri për bjondet dhe femrat? Dhe Vidal Sassoon, i famshmi flokëtar, e konsideron këtë libër 'ndriçues'. Heu, m'u duk vetja si personazhi i Cvajgut që ndërsa ishte në burg vodhi një libër shahu, e mësoi dhe u praktikua me vite të tëra në burg dhe, kur doli, provoi të bëhej kampion bote.

Atëhere dhe unë do të përpiqem ta jap një pjesë të këtij informacioni dhe të bëj të mundur që, më në fund, edhe në Shqipëri, të ketë mode floku të lidhura me personalitetin dhe/ose karakterin.

- Për kulturë, për ata që janë të interesuar,
- Që bjondet tona të mos bëhen kot bjonde apo kokëkuqe, kur nuk e dinë se çfarë mesazhi japin, apo në u shkon me personalitetin dhe karakterin e tyre
- Që femrat të mos thonë që ti i ke inat gratë, sikur të nënkuptojnë se ato nuk janë ashtu në të vërtetë. Thjesht femrat nuk e gëlltisin dot të vërtetën dhe nuk janë mësuar t'ua thuash në sy e hapur. Punë e tyre. Jo se po bëj ndonjë paralelizëm, por edhe Shopenhaurin nuk e honepsnin sa qe gjallë për analizat e tij të hapura psikologjiko-shoqërore. Gjë që do të thotë se ai kishte të drejtë në ato analiza të individit dhe shoqërisë njerëzore, përderisa janë akoma aktuale.

Një në 20 gra të rritura janë bjonde natyrale dhe, vetëm në Amerikë, 4 nga 10 gra bëhen bjonde vetë. Bota po hardalloset pas të qënit bjonde duke e deklaruar bjonderinë si ngjyrën esencialisht femërore. Meqënëse kjo lidhet me rënien në sy, atëhere automatikisht bjondet e konvertuara janë të çmendura për romanca. Dhe kjo lloj kulture e ka kthyer bjonderinë në një lloj fari nga drejtohen të gjitha pajisjet busullore të çdo mashkulli. Sidoqoftë gjërat po ndryshojnë. Markata është e hapur dhe fare e lirë për bjonde. Objektivi i fundit më i pambrojtur i kësaj bote. Anekdotat e barcaletat për bjondet debile shkëmbehen lirshëm në të gjithë botën, sidomos me emaile. Tashmë bjondja po tallet si nga burrat edhe nga gratë. Luku

i bjondes ka bërë shumë armiq. ***Kuptohet që bjonderia do të vazhdojë të jetë edhe ca kohë deklarata më dramatike diskrediituese që femrat e lehta mund të bëjnë me flokun e tyre.***

Po do t'i le për momentin bjondet rehat për t'ju thënë ca gjëra për flokun në përgjithësi. Ne jetojmë në një shoqëri ku besohet se floku është një çështje pa shumë rëndësi, një pasqyrim i kotësisë femërore. Mirëpo Kanadezi mendon se floku është një nga domosdoshmëritë e jetës bashkëkohore, ndoshta mënyra më e rëndësishme që gruaja të transformojë vetveten. Pra, një metodë e shpikjes së vetvetes sonë. Nga pikpamja akademike floku është për njerëzit e thjeshtë 'terra incognita'. Shkencëtarët që merren me çështjet shoqërore e kanë injoruar pothuaj plotësisht. Pavarësisht se floku është për jetën e sotme një nga preokupimet më të mëdha, se amerikano-veriorët shpenzojnë 60 miliard dollarë në vit për të, se tek ne burri mund të lerë gruan, apo gruaja burrin për shkak floku, se gratë mund të bëjnë deri edhe 300 km për të vajtur te parukieri i tyre, askush në të vërtetë nuk është marrë seriozisht me çështjen e flokut.

Studimi i flokut nuk të çon në skajet sipërfaqësore të shoqërisë, atje ku jetojnë të gjitha budallallëqet, por në qendër të gjërave. Ne kujdesemi për flokun sepse ndoshta është një nga mënyrat më të rëndësishme, me anën e të cilës gratë u bëjnë ballë kompleksiteteve të jetës së përditshme. Kështu, krejt qetësisht e papritur floku është bërë vendi ku ne mendojmë seriozisht kush dhe çfarë jemi. Ne ndryshojmë shpesh dhe shumë. Transformimi po bëhet gjithnjë e më tepër konstantja e vetme e jetës sonë. Dhe këto ndryshime janë të mahnitshme. Sot, me lehtësi, ne mund të transformohemi nga një person i cili jepet me pasion pas jetës shoqërore, në një person tjetër që nuk kërkon më shumë se një shëtitje të vetmuar në periferi. Nga dikush që përkufizohet nga fëmijët, në dikë që përkufizohet nga puna që bën. Nga dikush që jeton për t'u martuar, në dikë që jeton për t'u bërë beqare prapë. Në shumë kultura një ndryshim i tillë kërkon një jetë të tërë, kurse në kulturën tonë ndodh në pak vite.

Ekzistonte një kohë, kur kjo shpikje e vetvetes ishte e pamundur. Ne përkufizoheshim apo përcaktoheshim nga të tjerët: feja, komuniteti, puna, krushqit, bashkshortët, fëmijët, grupi etnik apo edhe fqinjët, të cilët me shumë lumturi na thoshin se cilët ishim dhe se ç'duhet të bënim. Gjithmonë e më shumë ne po përkufizojmë vetveten për vetveten. Gjithmonë e më shumë ne po ushtrojmë të drejtën e vetshpikjes, por ka lindur një problem. Si e qeverisim ne këtë liri. Ka një gjë tepër emocionuese në kalimin nga vetja tek vetja tjetër, nga një identitet tek tjetri, të cilët po bëhen gjithnjë e më shumë tepër fluide. Ka plot psikologë që rrekin të të vijnë në ndihmë, por asnjëri nuk i drejtohet natyrës së vërtetë të problemit. Ajo për të cilën kemi nevojë nuk është një kontroll më i mirë i peshës trupore, besimi tek vetvetja, manaxhimi i kohës apo prindërimi i mirë, megjithëse këto janë të domosdoshme. Unë kam kundërshtimet e mia lidhur me këtë pikpamje përderisa mendoj se jeta e balancuar, e përmbushur dhe e shëndetshme i plotëson vetat e tua duke të zgjatur dhe jetën njëkohësisht qoftë edhe duke të eliminuar sigurisht streset, kurse kalimi nga njëra vetë e jotja tek tjetra, bëhet për shkarkim stresesh dhe për zotërim dhe jo përmirësim vetesh, duke mos garantuar përmbushje të vërtetë dhe jetë të gjatë. Ju kërkoni iluzion lumturie apo lumturi reale? Këtë nuk po e marr vesh nga Kanadezi i cili vazhdon.

Problemi më themelor dhe real, thotë ai, është se jetët tona tani janë një kalim konstant nga njëra vetë e jona tek tjetra. Mirëpo ne kalojmë nga njëra vetë tek tjetra, sikur të kishim gurë të mëdhenj përpara. Nganjëherë kalimi është i lehtë. Nganjëherë rrëshqasim dhe biem. Në mungesë të një zgjidhjeje formale, ne nuk na mbetet gjë tjetër, veçse të vazhdojmë lëvizjen me shpresën se më e mira do të bëhet. Pra, me këtë liri të re, të habitshme, ne kemi përpara

një sfidë të re, por duhet të mësojmë jo vetëm se si ta ushtrojmë këtë liri të shpikjes së vetes, por edhe artet e reja të transformimit personal. Ka ardhur koha që të mendojmë më sistematikisht dhe ndërgjegjësisht rreth manaxhimit të paketës së pasur dhe ndërlikuar të vetëve.

Gratë kanë gjetur një përgjigje jo zyrtare. Pa e vënë re askush, ato dolën dhe shpikën zgjidhjen e tyre. Ndërkohë që ekspertët kërkonin në një drejtim tjetër, gratë e gjetën instrumentin e tyre të vettransformimit. Tek floku i tyre.

Kjo mendoj se mjafton për sot.

Dita e tetë

Mama, ç'ditë e mrekullueshme! Ajo shije, mosngopje apo përmbushje e një malli. Qiell i kaltër ku re puplore, si balona tabake pambuku, shënojnë fillimin e pranverës. Gjithë gjëja e gjallë në festë me ngjyrat më të bukura e zërat më joshës. Në të gjitha nivelet. Edhe në nivelin tim shpirtëror. Liqeni ndriçonte i tëri. Me nge i futa një të bredhur qytetit, piva për tangërllëk një Redbull jashtë një bari dhe vazhdova misionin tim: bridh kot e regjistro dhe analizo në darkë. Qyteti ishte disi i qetë për atë orë 9.30 kur dola unë. Gjermanët e mi të dashur, "çifti i ish-oficerëve SS", (çudi si të bëhet i dashur, i ligu ndonjëherë në vend të huaj!), ishin po ashtu rrotull, sepse i takova nja dy herë. Madje bëra edhe një foto me ta, meqënëse largoheshin atë ditë.

Shkova në supermarket, sepse kërkoja fara lulesh dhe, për të mos dalë bosh, flirtova me çupkën bjonde që shërbente aty. Natyrisht, ajo pranoi që ta nxirrja fotografi. Dhe u ktheva, ngadalë, bukur e shtruar se më duhej të vazhdoja me shfletimin e librit mbi flokët. Nuk më besohej që kisha ditë që rrija në atë mrekulli.

Një pjesë e madhe kafshësh, kryesisht zvarranikë dhe insekte, për të mbijetuar u duhet t'i përshtaten mjedisit rrethues. Mbijetesa e tyre lidhet me ushqimin dhe mbrojtjen. Në qënien supozuar me inteligjencë më të lartë, pra njeriun, transformimin për mbijetesë e vazhdon kryesisht bota femërore. Përsëri mbijetesa, e kuptuar më me inteligjencë. Vëmendje për seks dhe, prapa saj, mbijetesë. Në thelb është në fakt sfida ndaj një inferioriteti imagjinar me të cilën femrat lindin. Sfida ndaj frikës së çvlerësimit, frika ndaj zbulimit të inferioritetit i cili ekziston vetëm në mendjen e tyre. Një kompleks torturues edhe në mendjet e femrave më të suksesshme në botë, në të gjitha kohërat.

Meqënëse njeriu e ka humbur aftësinë gjenetike të ndryshojë ngjyrën e flokut me gjendjen emocionale, gruaja shpiku ngjyrën. Sipas Charles Revson, asnjë grua nuk duhet lejuar t'i bjerë në dorë një shishe me zbardhues. Është si të ngopësh Indianët me uiski. Ajo nuk e di se kur duhet të ndalojë. Ajo fillon ta përdori me idenë që të çelë paksa flokët, vetëm një nuancë, por

brenda një jave ajo e përfytyron veten e vet si një fëmijë me flokë ari dhe përfundon si dikush që sapo ka dalë nga dhoma e tmerreve.

Në përgjithësi, burrat e shohin ngjyerjen e flokëve me të njëjtin dyshim dhe panik me të cilën shohin gjithshka që ka të bëjë me botën e flokut. Floku është një tjetër vegël magjike të cilën ata nuk e kuptojnë. Gratë, ama, ndihen ndryshe. Të ngjyrosurit të flokëve është një nga instrumentat e mëdhenj të vettransformimit në jetët e tyre. Siç ka thënë një profesionist, "Të gjitha gratë kalojnë nëpër një periudhë kur ato do të donin të kishin personalitete të tjera dhe ndryshimi i ngjyrës së flokut të tyre është mënyra më e shpejtë për ta bërë." Kjo është veçanërisht e vërtetë pas një krize emocionale, kujtoni kameleonin e frikësuar. Kandidatet më të shpeshta për përdorimin e ngjyrës janë të divorcuarat dhe vejushat e reja. Kjo gjë mund të ketë qënë e vërtetë për vitet 60, sepse, të paktën tek ne, ngjyrimi i flokut bëhet aq herë sa ndërrojmë një të dashur, adoleshentet rreth tre herë në vit dhe të rriturat më rrallë. Për shkak të mungesës së informacionit, femrat tona japin me ngjyrat e tyre mesazhe të cilat ndofta nuk do të donin kurrë t'i jepnin, prandaj edhe u ndodhin situata të papëlqyera, si psh të ndiqen vetëm nga kandidatë rruge vetëm e vetëm se pa dashje japin mesazhin e një femre të lehtë.

Sidoqoftë, deri në një farë kohe, jo shumë larg prej sot, opinioni i burrave mbi flokët ka qënë superior, kështu të ngjyrosurit ishte sekret mëkator që nuk duhej nxjerrë. Filloi krijimi i pretekseve nga gratë për të përdorur ngjyrat. "Sapo kam kaluar një shok emocional që më thinji flokët, prandaj më duhet t'i përpunoj flokët për t'i kthyer normal". Natyrisht, askush nuk i hante këto. Këto gra konsideroheshin me moral të ulët dhe një rrezik për bashkëshortët e pambrojtur të grave të tjera. Ngjyra dendur përcaktonte edhe një klasë të ulët shoqërore grash. Pra, ngjyrimi i flokut mund të të kushtonte si moralin ashtu edhe qëndrimin shoqëror. I bie të thuash se duhej modifikuar urgjent profili i moralitetit, të cilin sot e shohim se ka arritur në kufijtë e mosekzistencës. Burrat i duan gratë të duken në një mënyrë të caktuar, por i duan ato të duken në mënyrë natyrale. Kur burrat zbulojnë se gratë kanë punuar për t'i përshtatur vetet e tyre në përputhje me kërkesat e burrave, atëhere ato damkosen me mashtrim. Ato mashtrojnë. Ashtu si tigri në pritë që mashtron prenë e tij. Në rastin e ngjyrës së flokëve, kemi të bëjnë me një thikë me dy presa, të cilën femrat janë më se të gatshme e të lumtura ta rrezikojnë me atë ndjenjën e theksuar e të ekzagjeruar të liberalizmit që i kategorizon nën shabllonin "Kjo është jeta", "Bëhen edhe gabime", "Gabimi është njerëzor" (Përse, krimi nuk është njerëzor? Gabimi i përsëritur apo i bërë me dashje, pse është njerëzor, nuk është faj?), "Të rritemi nëpërmjet eksperiencës.". Një grua që ka filluar të thinjet, psh, ngjyen flokët nëse po kërkon vëmendje burrash, por nëse ky marifet u zbulohet, kjo vëmendje e mashkullit anullohet. Para disa kohësh edhe një pjesë e grave mund të ishin po aq të ashpra ndaj njëra tjetrës për ngjyrën e flokut. Kjo bëhej për rivalitet, sepse në lojën e joshjes së burrave, një që ndërronte ngjyrën e flokut, po fitonte një përparësi të rreme. Mashtronte, pra, në paraqitjen e vetes në tregun e martesave, ku çdo burrë kërkonte të takonte një grua të ndershme e transparente si nënën potenciale të fëmijëve të tij. Në këtë lojë, burri, në shumicën e rasteve, do të humbte, sepse joshja dhe mashtrimi do të sofistikoheshin në raport me rritjen e konkurencës së egër për burra dhe mbijetesë të lumtur, por pa dashuri. Me kalimin e viteve sekreti mëkator po zbehej, po bëhej më pak mëkator e më pak sekret.

Nga vitet 80, gjërat ndryshuan radikalisht. Tashmë njerëzit nuk shtronin pyetjen "I ka lyer ajo apo nuk i ka lyer", por pyetjen "E përse mos t'i lyejë?" Nga vitet 90, stigma lidhur me ngjyrën e flokëve u zhduk plotësisht. Modifikimi i moralit u përfundua. Gratë kanë një armë të re, ngjyrën e flokut, të cilën ca dinë si ta përdorin dhe ca nuk dinë duke u shpërthyer në fytyrë nganjëherë. Nga vitet 90 njiheshin 500 emra nuancash për bjondet dhe një parukier i zoti mund të përdorte rreth 20 prej tyre në të njëjtën kohë.

Në kohën tonë të sotme përse ngjyrosen flokët? Në këtë epokë ku faji nuk ekziston, njerëzit e përdorin ngjyrën që të transformohen. Gratë e përdorin që të duken më të reja ose më të vjetra, më të buta ose më të hijshme, më të hapura ose më të tmerrshme, që të deklarojnë fundin e një marrëdhënieje ose që t'u krijojnë mundësi të tjerëve, që t'u thonë lamtumirë vetëve të tyre të vjetra dhe të marrin në konkurs vetet e tyre të reja, që të duken se kanë pjekuri dhe të vazhdojnë me jetën. Ja ngjyrimi i flokut në themel të tij: një vajzë me një shishe kimikatesh në dorë dhe një plan. Një dallim rrënjësor me sallonet e sotme me teknologjinë më të fundit në fushën e parukerisë. Ama efektet nuk dallojnë shumë. Kjo vajzë ngriti flamurin e qëllimit seksual. Bota i kushtoi vëmendje. Transformimi filloi.

Ngjyra përdoret për të luftuar moshën që përparon. Ka një nocion sikur bjonderia në veçanti ndihmon që të zbusë paraqitjen e një gruaje që po moshohet, se zbut lojën e dritës rreth fytyrës së saj, se zvogëlon efektin e rrudhave. Madje disa gra e përdorin ngjyrën edhe si mjet që zëvendëson kirurgjinë plastike. Ato pretendojnë, me të drejtë apo gabimisht, se një parukier i mirë të heq shumë vite nga mosha jote reale.

Tani them që t'ju jap tabelën periodike të bjonderisë. Sipas kanadezit Grant, por edhe me aq sa dihej deri në 1995, viti kur u botua ky informacion, bjonderia ndahej në gjashtë kategori:

Bjondja Bombë (Marilyn Monroe, Loni Anderson, Brigitte Nielsen etj.)

Bjondja Diellore (Goldie Hawn etj.)

Bjondja Tunxh (Cybill Shepherd, Candice Bergen etj.)

Bjondja e Rrezikshme (Sharon Stone, Morgan Fairchild etj.)

Bjondja Platin (Ivana Trump etj.)

Bjondja e Qetë (Meryl Streep, Diane Sawyer, Marlene Dietrich etj.)

Bjondja Bombë

Bjondja Bombë synon përshtypjen e madhe duke shpërthyer në vështrimin e shikuesit. Kjo bjonde do të bëjë që kokat të kthehen dhe trafiku të ndalojë. Kjo bjonde do që ta dish që ajo është në dhomë. Bjonderia e saj funksionon si fanfarë, të përgatit që larg për vëmendjen që duhet të tregosh ndaj saj. Ato e dinë që bjonderia e tyre mbart një mesazh të qartë e të fortë seksual. Ato janë të hapura dhe mendojnë se gjithshka tjetër është mungesë ndershmërie. 'Të gjithë mendojnë për seksin pjesën më të madhe të kohës,' thonë ato. Dhe është kryesisht seksualiteti që i jep kësaj ngjyre efektin e vet

transformues, për të mirë apo për të keq.

Bjondet Bombë akoma mund të shpërthejnë. Me shprehjen e hapur seksuale, ato akoma mund të kthejnë kokat dhe të ndalojnë trafikun. Por, ama, është e vërtetë që dallga e cunamit të përçmimit po rritet nga dita në ditë. Anekdotat për bjondet, që qarkullojnë me shumicë, i drejtohen kryesisht Bjondes Bombë.

- Si mund ta bësh një bjonde të buzëqeshi të hënën?
- Tregoi një barcaletë të premten.

Llogjika këtu është puritaniste dhe seksiste. Ajo thotë se të gjitha ato që janë plotësisht të orientuara seksualisht duhet të jenë budallaqe. Është e vërtetë që ne e urrejmë bjonden budallaqe si një nga ikonat më fyese të një epoke seksore. Disavantazhi i Bjondes Bombë është se ajo tërheq llojin e gabuar të meshkujve. Ka burra atje jashtë që nga Bjondja Bombë marrin mesazhin "Unë jam një objekt, më trajto si të tillë." Dhe ka shumë njerëz që pretendojnë se vërtet bjondet e kërkojnë këtë lloj trajtimi. Ata thonë se kur Bjondja Bombë e mirëpret një reagim seksual, ajo duhet të pranojë të gjitha ofertat. Ky është një budallallëk që fajëson viktimën. Për këtë arsye shumë gra hezitojnë të kthehen bjonde, ato që arrijnë të filozofojnë, sigurisht.

"Ajo që më ndaloi mua të kthehesha në një bjonde, thotë një grua, ishte frika se në vend që të vija vetullat do të nxirrja sytë, pra në vend që të konsiderohesha si grua e zgjuar, me klas, mund të refuzohesha si një debile dhe me kosto të ulët." Nocioni është ky: gratë që përdorin bjonderinë për t'u bërë që të duken të kapshme, bëhen në fakt shumë lirisht të kapshme. Lind nga kjo një dyshim. Ndoshta kjo bjonde bombë është e lehtë, nga e cila kuptojmë se ajo është e kapshme nga të gjithë. Tani vihet në dyshim edhe morali i saj.



Ka patur përpjekje për t'i ripozicionuar bjondet bombë, psh me Loni Anderson, megjithatë imazhi i bjondes bombë ka ndryshuar kaq shumë sa që ajo nuk është më shkalla drejt yllësisë. Në Hollivud, bjondet bombë, falë seksualitetit të tyre të deklaruar nga bjonderia bombë u ngritën shpejt në karierë, por po aq shpejt u shuan. Kështu ndodhi me Bo Derek dhe Brigitte Nielsen.

Një hile këtu do të ishte që duke përdorur seksualitetin e bjondes bombë të ngriheshin deri në yllësi dhe pastaj ta transformonin veten e tyre në diçka më jetë gjatë. Provoi Britt Ekland, por pa dobi. Klaudia Shifer, modelja tip - Bordo nga Gjermania është akoma një mall i panjohur, por ama e dimë se lloji i bjonderisë së saj, vjetërohet shpejt. Ajo që është e vërtetë për një yll, është e vërtetë për të gjithë.Bjondet bombë e kanë këtë problem. Ato duhet që ta plotësojnë përshtypjen e parë të madhe që lenë me diçka më lendësore dhe më interesante ose përndryshe duhet të paguajnë pasojat. Sepse pas shpërthimit ajo që mbetet është vetëm stigma.

Bjondja Diellore

Bjondja Diellore është pothuaj e kundërta perfekte e Bjondes Bombë. Kjo lloj bjonderie nuk nxjerr as zjarr e as tym, nuk var buzët ose nuk merr poza. Nuk ka këtu një mesazh të hapur seksual. Bjondja Diellore është miqësore, e hapur, e thjeshtë. Është gjithashtu e pafajshme, e gëzueshme dhe e hapur, pra, shkurt, diellore.



Kjo lloj bjonderie është projektuar që të fitojë. Ashtu si edhe të gjitha bjondet, ajo dërgon mesazhin e disponueshmërisë, por me këtë bjonde disponueshmëria nuk është për seksin, por për emocionet. Tregon që bjondja hap mendimet dhe ndjenjat e saj ndaj botës. Bjondja Diellore nuk fsheh asgjë që është komplekse, manipulative, egoizëm ose ndonjë gjë të errët. Ato janë të thjeshta, të buta dhe të pafajshme, ashtu siç ishin krijueset e kësaj bjonderie: Doris Day dhe Debbie Reynolds.

Bjondja Diellore e ul çelësin e volumit të seksit deri në minimum. Zëri seksual është atje sigurisht, me zë fare të ulët, por Bjondja Diellore nuk fshihet pas asnjë tymnaje apo lëngëzimi. Jo, ato paraqiten si personalitete të lumtura e të hapura, me seksualitet të mjaftueshëm për të veshur me avull syzet e një katërmbëdhjetë vjeçari. Ndërsa ka ulur zërin e seksualietit, ngre lart zërin e personalitetit. Sa e shohim këtë bjonde na jepet përshtypja se ne e dimë me saktësi se çfarë mendojnë ato, sigurisht gjëra të gëzueshme, optimiste dhe miqësore. A nuk ishte Goldie Hawn e tillë në fillimet e saj? Interesante është se Bjondja Diellore të jep përshtypjen se nuk është aspak misterioze kur në të vërtetë mund të jetë tamam e kundërta. Bjonde të tilla kemi pare plot: Cheryl Tiegs, Christie Brinkley, Lindsay Wagner, Cheryl Ladd, Farrah Fawcett dhe Linda Evans. Të gjithë kanë lozur idenë se gratë janë të thjeshta dhe të pakomplikuara.

Bjondjet Diellore nuk akuzohen kurrë se kushtojnë "lirë", madje jetëgjatësia e tyre është më e madhe se e varietetit Bombë. Nga Diellorja hiqet dorë vite më pas dhe vetëm atëhere kur dëshiron të eksplorosh në aspektet më të thella e më komplekse të vetes tënde publike.

Gratë si Goldie i kanë reabilituar vetet e tyre. Personi i Goldie është tashmë kilometra të tëra larg asaj bjondes që dha një ndihmesë aq të madhe në suksesin e filmit "Laugh-in". Tashmë ajo është një aktore kariere dhe nuk kualifikohet më si Bjonde Diellore. Sidoqoftë, mos harroni një gjë. Bjondet Diellore e kanë vështirë të reabilitohen sepse ato nuk duan të paraqiten më të 'kapshme', më të disponueshme dhe më akomoduese për burrat, sepse diellorja të formon edhe si karakter. Bjondja Diellore mund të konsiderohet sot si një stil gjinor, të cilës i ka ikur koha. Në se nuk del ndonjë shpëtimtar, kjo pamje dhe kjo vetvete mbetet në minorancë duke u zhdukur ngadalë.

Bjondja Tunxh

Bjondet Tunxh kanë personalitet të madh. Këto janë bjondet, zërat e të cilave i dëgjon gjithmonë nga njëra anë në anën tjetër të restorantëve. Bjondet tunxh nuk i ndërmjetësojnë ndjenjat e tyre dhe as i modulojnë zërat e tyre. Ato takojnë çelësin dhe rrinë takuar gjithë kohën. Nëse ju nuk i shihni kur ato vijnë, ky është problemi juaj. Ato i ndriçojnë flokët që t'ju paralajmërojnë ju me kohë, dhe në se ju nuk e patë, ok, radhën tjetër duhet të jeni më i vëmendshëm.

Janë këngëtare të mira sallonesh. Ato nuk e kanë problem t'ua tregojnë tingujt e tyre edhe të panjohurve. Ato nuk e kanë problem t'i ulen në prehër një burri nervoz. Sipas stereotipit, kjo bjonde është me zemër të madhe, bujare dhe e mirë. Ato kanë hequr dorë nga një sërë kompleksitetesh, por me pazarin kanë dalë mirë. Ato kanë blerë një çiltërsi që shumë bjonde jo Tunxh do të donin shumë ta kishin.

Cybill Shepherd dhe Candice Bergen e filluan si bjonde diellore, por kohët e fundit i kemi parë të kalojnë në bjonde tunxh. Karakteret që ato kanë lozur kanë qënë me personalitet të madh. Në tërësi, Bjondet Tunxh ofrojnë një kompromis të këndshëm. Ato e ofrojnë mesazhin e të qënit të disponushme dhe të kapshme, ashtu sic bëjnë të gjitha llojet e bjondeve, ju e dini me ekzaktësi se ç'mendojnë ato dhe se ç'vend zenë në shoqëri, por oferta e intimitetit nuk është e nënkuptuar. Vetvetja e Bjondes Tunxh i ka kufijtë shumë të qartë.

Gjendja aktuale e Bjondes Tunxh është duke u shqyrtuar. Kjo ishte një nga mënyrat me anën e të cilës gratë mund ta bënin veten e tyre të dëgjoheshin në një kulturë mashkullore, seksiste. Kjo pamje të jepte një lloj fuqie. Por me zbehjen e seksizmit, ekziston mundësia e fuqisë dhe e pranisë pa braktisur dinakërinë dhe sofistikimin. Fuqinë e Bjondeve Tunxh mund ta shfrytëzojnë brunet ditët e sotme, pa e deklaruar veten e tyre paraprakisht. E përse të tradhëtohet loja?

Bjondja e Rrezikshme

Një nga zhvillimet moderne në bjonderi, është Bjondja e Rrezikshme. Këto janë ato gra

ngjyra e flokëve të të cilave ofron akses seksual ose emocional dhe pastaj ta merr menjëherë aksesin. Kjo specie bjondeje po përhapet me shpejtësi nëpër metropole. Nëse sheh rrugëve një bjonde me syze të errta dhe vetulla të vrenjtura ose që të shikon vëngër, kjo është Bjondja e Rrezikshme. Një numër yjesh po e preferojnë këtë pamje: Faye Dunaway, Morgan Fairchild dhe Sharon Stone. Bjondet e rrezikshme nëpër filma janë horret e mira. Bjondet e Rrezikshme luajnë me simbolizmin tradicional: bjonde për të deklaruar disponueshmërinë, por një disponueshmëri cilësore. Ato nuk duan të shikohen si të 'lira', të 'lehta' dhe sigurisht nuk duan në asnjë mënyrë të trajtohen si debile. Por edhe si transparente nuk duan t'i shikojnë. Zgjidhja është aksesi i kontrolluar dhe ja ku

hyjnë në lojë syzet e errta dhe shikimi i vëngërt. Të qënit bjonde ju thotë "kjo është një grua e disponueshme", kurse syzet e zeza ju thonë "ruaj distancën derisa të të them unë të afrohesh".

Tek Bjondet e Rrezikshme ka një kontradiktë, por që është e qëllimshme. Gratë duan që ta japin mesazhin e bjondes, por nuk duan të penalizohen për të. Kur Donna Mills mban syze të errta, ajo dërgon me shumë kujdes mesazhe kontradiktore. Jam e hapur, thotë, e besueshme, por na jep atë vështrimin e fshehur e të llogaritur mirë. Sharon Stone ndërtoi një karierë të tërë duke qënë bjonde e rrezikshme. Kujtoni filmat Total Recall dhe Basic Instinct, ku ajo tregohet si djallëzore, manipuluese dhe e paskrupullt. Një nga arsyet se përse Sharon Stone i luan kaq mirë këto role (kuptohet, duke llogaritur edhe talentin e saj të pjekur) është se ajo luan edhe flokët e saj bjonde. Ne i presim bjondet të jenë të kapshme dhe magjepsëse, por Stone na habit, na skandalizon dhe na dëfren duke qënë e kundërt me sa më sipër.

Kjo do të thotë se Bjondet e Rrezikshme kanë dalë kundër llojit të vet. Kjo të jep një efekt tronditës. Disa burra e konsiderojnë intriguese, sfidë dhe ftesë në të njëjtë kohë. Dhe publiku vdes për kontradikta. Pafajësia dhe rreziku në një paketë të vetme.

Bjondet Platin

Kur bjonderia shkon në ngjyrën platin, ai merr një kuptim statusor. Disa thonë se gratë kthehen në bjonde për të luftuar moshën që bën përpara, sepse bjonderia të zbut tiparet. Ka, sidoqoftë, edhe një shpjegim tjetër. Bjondja Platin është një mënyrë me anën e të cilës gruaja do të tregojë transformimet lidhur me pasurinë dhe statusin shoqëror. Ato na thonë se janë 'diplomuar' duke ngjitur shkallët e botës. Ato nuk janë më gjëra të reja, të bukura. Duke qënë se kanë hyrë në vitet e vona të moshës së mesme, ato kanë kultivuar cilësi të tjera. Ato janë rritur në mençuri dhe karakter. Por, veçanërisht, janë rritur në paraqitje, hijeshi dhe dinjitet.

Po cila është ngjyra e dinjitetit? Sigurisht nuk është Bjonderia Bombë, që ka një vëllim zëri seksual shumë të lartë. Nuk mund të jetë as Bjonderia Diellore, kjo ngjyrë është tepër e zellshme. Në asnjë mënyrë nuk mund të jetë ngjyra e kuqe, sepse ajo është pa respekt dhe e tepruar. Po ashtu, e zeza, nuk mund të jetë, sepse bën një kontrast shumë mizor me lëkurën që

po moshohet. Thuhet që flokut gështenjë i mungon prezenca, pra edhe ajo ngjyrë nuk mund të jetë. Ka vetëm një zgjedhje: platini. Kjo ngjyrë shfrytëzon me mjeshtëri pjesët më të mira të bjonderisë dhe hedh pjesën e mbetur që nuk vlen. Angazhon dritë. Kërkon vëmendje. Por e bën këtë me dinakëri dhe me një lloj aureole mospërfilljeje lidhur me faktin në se vëmendja po vjen ose jo. Bjondja Platin i ka ulur tonet e mesazhit të seksualitetit dhe emocioneve, por ka gjetur një mesazh të ri e më të rëndësishëm. Bjondja Platin bën një hap më përpara. Ajo pretendon një lloj të ri dhe shkallë të re vlere – cilësi më të holla, më të thella e më delikate. Është si të lyesh një mobilje të bukur me llak ndriçues. Bjondja shikomë – mua, gjithë ndriçim dhe e dukshme, është zhdukur. Një nuancë më e errët dhe më e pasur lind dhe flet për një pjekuri, prezencë dhe dinjitet të ri. Bjonderisë i është vënë mina, mbeturinat hiqen dhe del në pah nuanca më e mirë e saj.

Mirëpo Bjondja Platin jo gjithmonë është ajo gjëja reale, shpesh është falsitet. Çdo të thotë falsitet? Kur ato gra, që nuk kanë plotësuar një kalim apo transformim në hijeshi dhe karakter, bëhen bjonde platin quhet falsitet. Këto gra duke mos dashur apo duke mos qënë në gjendje ta bëjnë këtë kalim në një prezencë apo hijeshi të re, kërkojnë që të na mashtrojnë. Shoqëria e Nju Jorkut nuk e fali kurrë Ivana Trumpin për stilin e saj ekstravagant të të veshurit dhe talleshin me të brendshmet e saj ekstravagante. Në mënyrë të veçantë ata nuk e pëlqyen faktin që ajo refuzoi, për arsyet e saj, të bënte kalimin nga bjondja bombë në bjonden platin, pra në hijeshi apo fisnikëri.

Bjondja e Qetë

Një grup bjondesh ka mundur ta kthejë bjonderinë nga ana tjetër. Kini parasysh Diana Sawyer, për të cilën bjonderia është një deklaratë distance dhe shkëputjeje. Këto janë bjondet që e ulin në minimum volumin e aksesit emocional dhe seksual. Ato e përdorin bjonderinë e tyre si një deklaratë të cilësive të kundërta me ato që kemi thënë më lart. Bjonderia e Sawyer thotë: “Unë jam e rezervuar.” Meryl Streep, po ashtu. Ato janë një lloj rebysi ose gjë a gjëze. Ato ngjajnë paksa me bjondet e rrezikshme në atë se ato duken sikur i kthejnë kurrizin atij mesazhi të aksesit apo disponueshmërisë për të cilën bjondet janë kaq të famshme. Dhe ne e gjejmë veten në dilemë. Reagimi ynë i parë është ndaj mesazhit të disponueshmërisë së bjondes, mirëpo më pas zbulojmë se ky mesazh është ulur në minimum. Kjo do të thotë refuzim, e asgjë tjetër. Bjondja e qetë sikur të thotë: ‘Asnjë supozim idiot mos bëj për mua, për disponueshmërinë time, o çunak’.

Kjo nuk do të thotë se Bjondet e Qeta nuk janë seksuale. Në të kundërt, ato manaxhojnë një mesazh të pagabueshëm seksual, por ju duhet që ta zbuloni. Kjo gjë është një magjepsje më vete. Ashtu siç kërkon aftësi në dhënien e një mesazhi kaq të hollë, po ashtu duhet po aq aftësi për ta kapur atë. Pra, një mënyrë e shkëlqyer për të spontuar burra të caktuar nga jeta e një gruaje. E shikoni se si një Bjonde e Qetë ia dërgon mesazhin e saj vetëm dikujt me inteligjencë të mjaftueshme për ta lexuar atë?

Bjondja e Qetë u konstruktua, të paktën pjesërisht, nga Marlene Dietrich. Ajo dha një bjonde me vetulla të harkuara mirë. Ajo donte që ju ta dëgjonit seksualitetin e saj, por ama edhe të mësonit se ajo nuk ishte robinë e tij. Ajo donte që ju ta dinit se ajo mund t'i takonte dhe stakonte turbinat e seksualitetit sipas qejfit. Ndërkohë që Merilin Monro e kishte seksualitetin si një dhuratë të lumtur dhe krejtësisht të pafajshme, Dietrich ishte më e matur dhe më kalkuluese. Nuk kishte me të as një bujari reale dhe as një braktisje reale. Thjesht ruante distancën.

Më trokitën në derë. Ishte çifti pronar që donte të bënte një foto me mua. Më erdhi zogu në dorë, thashë. U thashë që librin, të cilin e kisha marrë me vete, e kisha gjetur në raftin e tyre, dhe që fliste për flokun dhe që unë mendoja se ishte një informacion interesant. Pastaj, u gëlltita dhe i pyeta se ku mund ta gjeja një libër të tillë dhe se sa mund të kushtonte. Burrë e grua panë njëri tjetrin në sy dhe pronari foli: "Po merre, o çun, dhuratë!" O zot sa i lumtur duhet të kem dalë në fotografi. Pa mbaruar ata, u zgjata librin dhe stilolapsin që të më shkruanin diçka në libër.

Oii, po tani me se do të merresha? Internet? Good idea! O, not good idea! Dola rrotull shtëpisë. Mrekulli. Një dorë Esperanto me njerëzit, shkulje barërash të këqia bashkë me ta, një bisedë për Karl Marksin dhe Hitlerin, unë në anglisht kurse ata në gjermanisht. Nuk e di se sa u morëm vesh, por di që kishte shumë Yes, Yes dhe Ja, Ja kot. Ca mollë e dardha nga bahçja dhe i futa xixat çupës 22 vjeçare, që punonte aty, që të shkonte në universitet.

Fjeta një gjysëm ore mbasdite, unë e quaj këtë gjë "e trëmba". Fiks në katër mbasdite u nisa për në qytet për të stampuar pozat e filmit të parë. Flirtova pakëz me atë çupkën matanë banakut e cila fliste pak anglisht sa të mos më kuptonte dhe lamë takim për të nesërmen në dyqan, për të marrë fotot e stampuara. Pasi dola që aty, i rashë nga qendra për të dalë nga liqeni. Në qendër katër burra kishin vënë poshtë një çun rreth të njëzeteshtatave, por i fortë si dem. Pashë rrotull se mos xhirohej ndonjë film ose bëhej ndonjë stërvitje, di unë? Aparatin fotografik e kisha me vete, por i thirra bonsensit tim myzeqar me pyetjen "Ç'ke që kruhesh me qorromidhe re?" Sidoqoftë, zura një qoshk të sigurtë e me pamje të mirë. Burrat e kishin shtrirë gangon dhe mezi e mbanin. Ai ulërinte dhe shante polonisht. Pas pesë minutash erdhi policia dhe i vuri prangat. Filmi mbaroi, të mirët fituan. Unë mora rrugën e kthimit. I rashë liqenit nga ana tjetër, që i binte përballë qytetit që nuk dukej për shkak të pemëve. Shumë njerëz shijonin diellin e mbasdites në mënyra të ndryshme. Po sikur t'i bija liqenit rrotullame? Meqënëse nuk e kisha idenë se sa kohë mund të merrte e refuzova idenë. "Ik, o çun, ta kishe menduar më parë!". U ktheva, hyra pak në internet dhe u bëra një xhiro mjediseve të mrekullueshme jashtë. Poshtë, gjermanë të sapoardhur po bënin barbeque (po piqnin në zgarë) dhe po u binin mandolinave karakteristike gjermane. Nuk doja të mpleksesha, por u bëra nja dy poza .

Duke medituar në darkë shtrirë, them se zbulova diçka nga misteri i të veshurit dhe zhveshurit. Këtë e vura re atë ditë në qytet, por sidomos anës liqenit, në shëtitje. Po, kishte

vajza që edhe zbuloheshin më shumë, por nga mosha ishin më të vogla se, të themi ato të shkollës së mesme apo edhe më lart. Edhe nga biseda që pata me bjonden që punonte aty arrita të kuptoja se vajzat, pa hyrë në shkollën e mesme, edhe mund të dilnin me barkun zbuluar ose me kanatjere, por me të hyrë në shkollën e mesme, kalonin në veshjen normale në shkollë, në punë, në rrugë e kudo me përjashtim të diskos apo një rasti të veçantë. Tani ne do të keqkuptohemi me fjalën normale, sepse normale vajzat tona kuptojnë lakuriqësinë. "Përse?" Pyeta bjonden. 'Nuk është veshje e përshtatshme e dinjitoze për punë, shkollë e rrugë," tha, dhe vazhdoi, "Vajzat e vogla vishen ashtu, sepse akoma nuk janë të ndërgjegjshme mbi faktin se kush jemi, dinjitetin e femrës ....". "Dhe mesazhet që duan t'u japin meshkujve," shtova unë.

Gjermanët kënduan deri vonë. Mirëpo mua po më tërhiqte një film interesant: "Lying eyes". Sy që gënjejnë. Heroinë na ishte një çupë gjimnazi, sigurisht bjonde. Shih ku na doli dhe antiheroi, i nguli sytë, i sajoi një si incident me makinë, e çoi për akullore dhe e puthi. Mirë, jo keq. Këtu tek ne, i del djali përpara dhe i thotë: "Të kam parë dendur dhe më pëlqen (hiç nuk e ka ndjekur, sapo e pa), a mund të pimë një kafe bashkë?" Po ndezi mirë, shkojnë për kafe, ndërrojnë numërat e telefonit, kush je ti e kush jam unë, sigurisht pjesa më e madhe gënjeshtra pa zarar dhe fjalor i zgjedhur mediokri dhe quhen të lidhur. Emrat shkëmbehen më vonë. Po nuk ndezi, nuk ndezi, por ama djalit nuk i ngelet gozhdë.

Në takimin e katërt, antiheroi i dhuroi çupkës që nuk ja dimë akoma "fatin", veshje të brendshme 'body' dhe drejt e në krevat. Ato vajza që do të kenë fatin e keq që ta lexojnë këtë libër do të vrasin mendjen, "Po në ç'ngjyrë kanë qënë vallë?". Eh, moj çupë, që akoma nuk i di emrin dhe nëse e do apo jo! Parametrat i kishte të mira miku. Kortet, po ashtu, të sofistikuara. Gënjeshtra në shtëpi. Ta pret mendja. Shoqet që e morën vesh nuk e miratuan. Ç'fat i keq! Bjonde. Krevat. Byzylyk. Oiii! Na ishte i martuar antiheroi, burri i dashuruar, dhe na kishte edhe dy fëmijë. Aha, e shoqja e paska marrë vesh dhe i paska dërguar të ëmës së bjondes një pusulle ku i thoshte "Çupa jote është whore" – nuk ma mban goja ta them shqip fjalën kurvë. Filmi po bëhej më interesant. Si ta merrja zgjedhjen e kësaj bjondeje? Si "E marr jetën si të më vijë" apo si "Kap çastin sa nuk ka ikur"? Apo ta merrja si "Njeriu bën edhe gabime"? Po pse pikërisht këto janë të lidhura me fatin e keq? Përgjigjen e saktë e dinë bjondet. Fakt është se ato quajnë fat të keq gabimet e tyre.

Prit! Tani po i flisnin njëri tjetrit për veten e tyre në krevat. Ai bënte sikur flinte. Burrat nuk dinë të gënjejnë thjesht e për gjëra të vogla. Dikush po na i përgjonte nga dritarja. Sa po i gëzohej byzylukut, e shkreta! Po më dukej se byzylyku na ishte i vjedhur. Bjonda filloi të dyshojë dhe filloi ta gjurmojë pranë shtëpisë së tij. Pa kalamajtë dhe gruan e tij. U çmend. Në krevatin tjetër ajo i thotë:

- You are a lier! – (Ti je gënjeshtar)
- I can explain. – (Mund të ta shpjegoj)
- What? That you are married?! – (Çfarë të shpjegosh, që je i martuar?)
- It's a white lie. I'm in love with you. Let me explain…. Please, don't throw this away! (Thjesht një gënjeshtër e bardhë. Unë jam i dashuruar me ty. Më lejo të të shpjegohem… Të lutem, mos e shkelmo këtë gjë!)
- But I can't go out with a married man. – (Por unë nuk mund të dal me një burrë të martuar.)

Ca premtime divorci të asaj tjetrës dhe u pajtuan, u puthën. O zot, ç'fat i keq! Mirëpo mamaja ishte e pakënaqur me të bijën se kishte filluar t'ua varte mësimeve dhe të mungonte në shkollë. Çupa, nga inati për këtë mosmirëkuptim dhe konflikt brezash, ja shau punën që mamaja bënte dhe që i jepte rrobat, ushqimet, shkollën dhe tangërllëkun asaj vajze. Po antiheroi ishte paksa hero, sepse e prezanton me gruan e tij. Situata po rritet në gradacion, si pija. Ishin ulur të tre për kafe e bisedonin miqësisht. Gruaja, që e di, i jep vajzës mesazhe të qarta femërore – rivalore.

Shkurt muhabeti, gruaja nuk dinte gjë. Disa tentativa të çuditshme, nga një njeri që nuk duket qartë, për të vrarë bjonden. Të gjitha i bënte një shoqe e bjondes, sepse dashuronte antiheroin. Shoqja e bjondes, të vriste shoqen, për një horr. Vajzat nuk e kanë problem të bien në dashuri me të dashurin e shoqes dhe madje ta joshin dhe t'ja thonë edhe troç dhe "ai le të vendosë pastaj se cila është më e mirë për të". Shoqes të mos i mbetet fare hatri se fajin e ka ai që ka bërë që në fillim zgjedhje të gabuar. Mos ishte ironi kjo? Nejse, si përfundim miku kthehet tek e dashura e parë, kjo shoqja 'kriminele', dhe bjondja shkoi në punë të vet. Dhe diplomohen mirë e bukur me një barrë eksperiencë nga shkolla e mesme.

* * *

(Fragment chat-i me një vajzë të re)

- Të të bëj një pyetje delikate.

- Po.

- Vajzat, nuk e kanë problem që një djalë që ka një e dy, e mbase tre vajza, njëra pas tjetrës, ta pëlqejnë e të përpiqen ta bëjnë për vete? Duke rrezikuar.

- S'të kuptova. Formuloje ndryshe.

- Oiii. Një vajzë, njeh një djalë. I lind ideja për të, dmth e pëlqen. Di që ai jo vetëm ka patur një ose dy, por që edhe ka aktualisht një. Vajza ndërton diçka brenda vetes. E ka problem kjo vajzë ta joshë e ta bëjë ta dojë atë, duke rrezikuar kësisoj, boll që realizon fiksimin e saj, duke menduar se është më e zonja se ato, gabimisht, dhe ai nuk do shkëputet nga ajo. E ka një vajzë problem këtë gjë? Sepse një djalë e ka problem e nuk do t'i hynte një vajze që ka dikë aktualisht ose i ndërron një çikë dendur. Qofshin romanca të shkurtra ose të gjata. Është kjo dobësia kryesore e vajzave që u sjell fatkeqësi atyre vetë, por edhe djemve me të cilët lidhen? Dmth vajzat në përgjithësi, jo te gjitha - (rregulli 26), nuk kanë etikë, ato nuk e kanë problem të joshin të dashurin e shoqes e ta bëjnë për vete, a nuk është kështu, pa e vrarë fare ndërgjegja?

- Mendoj se një vajzë, thjesht për një fiksim, nuk e bën këtë gjë (mbase një pjesë e vogël po). Nëqoftëse ka diçka më shumë se sa një fiksim për këtë djalë, e bën, lufton për këtë djalë.

- **Ti rron mes tyre, ma thuaj. Edhe kur e di që ai ka aktualisht një, e një tjetër pak më parë?**

- Nëqoftëse ekziston ndjenja për këtë djalë, po.

- **Edhe kur e di që ai do shoqen e vet, qoftë edhe kot?**

- Ose, të paktën, e bën një përpjekje në qoftë se mendon se do ta bëj me të lumtur se sa e bën tjetra, nëqoftëse mendon se janë bërë për njeri-tjetrin.

- **A nuk mendon se fiksimi i vajzës dhe ndjenja e vërtetë janë shumë larg, dhe vajza fiksimin e merr për ndjenjë?**

- Ia bën të ditur djalit dhe ai le të zgjedhë pastaj. Po, janë larg, por një pjesë e mirë e vajzave e dallojnë këtë gjë.

- **Dmth ia bën të ditur djalit, kur ajo nuk e di në se ai e do, sepse ai ka një tjetër. Ajo ja bën të ditur atij këtë gjë? Kur ai as nuk e ka në mendje, dhe ka dikë tjetër, që është edhe shoqja jote?**

- Varet nga vajza, dhe nga guximi i saj.

- **Po unë mendoj se ky është budallallëk me okë dhe nuk po të marr vesh fare. Kjo gjë e vajzave, vetvrasje, riskim i panevojshëm, mendjelehtësi, mbase keqkuptohemi. Kjo nuk ka lidhje me luftën për të fituar një djalë, apo si të jesh e suksesshme me ta. Më çmende.**

- Po pse, ta mbaj të fshehur këtë ndjenjë, kështu është më mirë thua ti? Mbase.

- **Moj çupë, edhe njëherë, se po më duket çudi e madhe, por po më ndihmon shumë për t'ju kuptuar juve. Dmth një djalë, ti e pëlqen, ti e dashuron, të paktën kështu mendon, fiksim nga të tëra anët.**

- Po.

- **Ëndërra jote. Plotëson të gjitha parametrat. Mrekullia vetë, mirëpo ky djalë na ka një të dashur. Njiheni me djalin. Djali ka një të dashur, më parë apo më pas se të njiheshit nuk ka rëndësi, atëhere ti ia bën të ditur dashurinë tënde, KËSHTU? Për të mos e mbajtur brenda apo fshehur? Kështu? Ke guxim dhe ja thua, kështu?**

- Po, kështu më duket më e drejta. Ia bëj të ditur.

- **Megjithëse aktualisht e ka një të dashur e del me dikë që ti nuk e di se sa e do apo të tjera? Më fal Kaltra, mendjelehtësi.**

- Pse ia bëj të ditur, nuk do të thotë që unë do të lidhem me të. Por e vendos veten në vendin e djalit.

- Nuk ka pikë kuptimi. Po mirë, ia the, dhe djali e le atë vajzën tjetër e do të lidhet me ty, çfarë do të bësh ti?

- Ia them se çfarë ndodh, nuk e di pastaj, do të diskutohet, nëqoftëse ai djalë e pëlqen shumë të parën dhe për mua nuk ndjen gjë, asgjë nuk ndodh.

- Po mirë, shoqja ime, ashtu siç mund të kthehet ai te ty, mund të kthehet nesër te një tjetër që do t'i shprehë dashurinë si ti, tërë guxim. Po dinjiteti, moj shoqja ime? Si asgjë? Po ai mund të të lerë edhe ty, po pastaj?

- Por kjo do ndodhë nëse ai do ta dojë atë më shumë se mua.

- Kaltraaaaaaaaaaaaaaaa!

- Por unë që i shpreh dashurinë tërë guxim, e mendoj këtë gjë. Mendoj se ky është ai i duhuri, derisa bëj këtë sakrificë.

- Po, si mund të jesh ti e sigurtë se ai djalë nuk po kalon kohën kështu me vajzat, që tërë guxim i thonë se e duan

- Por që unë ta dua këtë djalë, më parë duhet që ai ta ketë fituar këtë besim te unë.

- Oiiiiiii, ja fatkeqësia e vajzave dhe thonë pastaj sa pa fat që jam. E lemë këtë muhabet, të lutem.

- Zgjedhje të gabuara bëjnë të gjithë, derisa gjejnë të duhurin.

- Nuk po më pëlqen fare. Zgjedhja e gabuar është tjetër dhe kjo gjë është tjetër. Krejt tjetër.

- Shiko…

- Zgjedhja është kur zgjedh, por jo kur i shkon dikujt, hej ti, unë të dua, qëndro një çikë se unë dua të rrezikoj, them që ia vlen të rrezikoj.

- Në qoftë se ky djalë më pëlqen më shumë mua, dmth me atë tjetrën ka bërë një zgjedhje të gabuar dhe e ka kuptuar tani, që unë i shpreha dashurinë.

- Këto janë sofizma. Nga do ta dish ti këtë gjë? Ai që ka marrë përsipër të lozë s'e ka problem.

- Por ta thashë më sipër, që unë ta dua këtë djalë, duhet që ai të më ketë dhënë provën e besimit.

- Të të thotë, e sheh ti që atë nuk e paskam dashur, dhe tjetrën e tjetrën. Lere fare, të lutem. Jemi shumë larg këtu. Shumë, shumë larg, nëse jemi kuptuar qartë.

- Ok, e lemë.

- Për ç'provë besimi thua?

- Më duket se nuk jemi kuptuar.

- Ti po ja heq të dashurin tjetrës. Them që të kam kuptuar shumë mirë. Ç'provë besimi? Nga do ta gjesh provën e besimit kur ai shkon me një tjetër? Dhe ti shkon tym e i thua, ej ti, unë të dua. Kthei sytë nga unë, ti tani vendos kush ja vlen. Pse, plaçkë je ti? Ti je njeri me dinjitet. Ti duhet të fitohesh, moj goce. Po ju nuk e dini këtë. I quani burrat perëndi, për të cilët duhet luftuar qoftë edhe kur nuk e dimë na duan apo jo. Ky është shkatërrimi i vajzave. Shiten filozofikisht fare lirë, sikur janë pa vlerë. E di pse? Sepse e quajnë privilegj që një fiksim i tyre të shkojë me të, ta bëjnë për vete, qoftë edhe përkohësisht. Po ç'privilegj?! Prandaj ndodhin të gjitha. Nuk ju ka faj njeri.

- Do zoti nuk ikin më dritat. Erdha una eeeeeee. Mos më thuaj që je duke u shkëputur ti tani.

- Nuk e kisha parë që kishe ikur dhe gri e gri e gri fjalë dhe "mençuri" me renden e gojës. Më ke shokuar me ato që më the.

- Shiko, të sqarohem.

- Jo, jo. E lemë. E lemë ta bisedojmë të qetë, ballë për ballë.

- Por më duket se ti nuk më ke kuptuar, prandaj.

- Është shtangëse.

- Ok, më mirë kështu, pastaj.

- Por jo e papritur. E dija këtë gjë te vajzat megjithëse ato nuk e pranojnë. Thjesht m'u konfirmua dhe më shtang. Është një nga ato raste, kur njeriu do të donte ta kishte tërë ditën gabim. E di pse, një vajzë e zgjuar nuk duhet të veprojë kështu, me instikt, ku rafsha mos u vrafsha, të dalë ç'të dalë.

- Po dale njëherë se më duket se jemi keqkuptuar. Mos nxirr konkluzione me vrap. Flasim ballë për ballë, njëherë.

- Oqej. Të të bëj edhe një pyetje delikate, po deshe?

- Ok.

- Pra, a të ka ndodhur të jesh në një situatë të tillë? Dhe je zhgënjyer?

- Jo, nuk më ka ndodhur, por po e imagjinoja veten në një situatë të tillë.

- Sinqeritet. Jemi shokë?

- Po.

- Më ke thënë njëherë që familja e di, është e ndërgjegjshme që një vajzë në moshën tënde mund të ketë të dashur.

- Po.

- I dashuri dhe çfarë biseduam janë e njëjta gjë, apo jo? Për të dashurin bëhet fjalë apo jo? Apo i dashuri është një romancë e aq? Një fiksim e aq?

- Jo, për mua i dashuri është shumë më shumë. Nuk është fiksim. As do ta merrja mundimin që të mendoja që të lidhesha me një fiksim.

- Prandaj bëra një ndarje. Pse? Dmth mund të kesh dashur, por jo dashuruar, sepse nuk je ndjerë tamam ashtu, meqënëse po e përjashton faktin që nuk merresh me fiksime, ndonëse kjo bie ndesh me sa the lart që do kishe guxim e do ja plasje shokut. Në një rast të tillë nuk mund të jetë tjetër veçse fiksim, sepse ti nuk ke mundësi ta zhvillosh këtë ndjenjë, as te vetja e as te tjetri, sepse ai do një tjetër, më kupton?

- Do ja plasja nëqoftëse do të mendoja se është personi i jetës sime.

- E merr vesh pse e ndava?

- Jo nëqoftëse do të ishte një fiksim. Ta përcaktova këtë.

- Po ku do ta dije ti? Nga e njeh ti?

- Por do ta shikoja

- Ai do dikë tjetër.

- Si, nga e njoh?

- Nga? Si? Njohja është më e afërt.

- Por do ta shikoja.

- Ah, moj 18 vjeçare! E kupton pse i ndaj për momentin? Të kesh pasur një të dashur dhe të kesh dashuruar tamam kur ai do dikë tjetër, del me të, e gjithçka.

- Po flisja nëse ne do të ishim shokë. Dmth unë dhe ai djali. Dhe duke ndenjur bashkë, duke parë mendimet e tij, mënyrën se si ai sillet me të gjithë, me mua.

- Po ti mund të jesh shoqe me të dashurën e tij, se ju ka prezantuar ose e ke shoqe që më parë.

- Kjo s'ka të bëjë.

- Siii!!!!!!!!!!!? Nuk është poshtërsi?

- Nëqoftëse do të ishim shoqe unë dhe ajo, varet pastaj.

- **Po si varet?**

- Po ta kisha më shumë shoqe atë, do të ishte ajo që do ta merrte vesh e para.

- **Nuk është mungesë etike, poshtërsi?**

- Dhe do ta diskutoja me të problemin, jo me djalin.

- Si "ore"? Do t'i thuash shoqes tënde që, hej ti, shoqja ime që më ke besuar, unë e dua të dashurin tend. Ai nuk di gjë, por kam plan t'ja them, si thua ti, shoqja ime? I dashuri yt le të vendosë. Kështu, Kaltra? Madje as kur nuk e di në të do ai njeri apo jo. Po sikur të ta bënte shoqja e ngushtë ty?

- Por unë mora shembullin kur unë dhe goca nuk njihemi.

- **Pra nuk të ka ndodhur të jesh në një situatë të tillë të ngjashme apo jo?**

- Jo, tamam të tillë, më saktë, jo.

- **A nuk mendon se një vajzë kur nuk e di tamam se çfarë është dashuria e vërtetë, mund të ngatërrojë çdo lloj ndjenje me një të tillë dhe të lidhet me një djalë?**

- Prandaj në fillim të thashë se varet nga vajza.

- **Ti do të thuash se ka patur gjë tjetër, por jo tamam të tillë, apo jo? E kam fjalën te ty.**

- Them se di ta dalloj fiksimin nga dashuria.

- **Atëhere, fiksimit nuk i vihesh, dashurinë nuk e njeh, e nuk e ke ndjerë tamam, e si mund të gjykosh ti, shoqja ime?**

- Them se kur ta ndjej dashurinë, do ta kuptoj vetë.

- **E si mund të thuash që njeriu gabon, gabon derisa e gjen të saktin?**

- Do të ketë një ndryshim nga të tjerat.

- **Ky gabim, çfarë është, fiksim, shoqëri e gabuar apo dashuri? Kjo të tjerat, çfarë është?**

- Fiksim, ndjenja të çastit, të cilat ftohen shpejt.

- **Flet për vete apo jo? Thua që kur do ta ndjej dashurinë do ta kuptoj vetë, do të jetë ndryshe nga të tjerat, flet në teori apo çfarë?**

- Po, sepse këto që kam patur deri tani i quaj fiksime.

- **Dmth ti ke patur fiksime? Po ti thua që nuk i vihem një fiksimi.**

- Po, normale që kam patur, por duke i ditur si të tilla nuk u kam kushtuar rëndësi.

- **Dhe e thua në shumës.**

- E di që kalojnë shpejt.

- **Kur the që fiksimet nuk i ushqej, a nuk e di si e the, këto fiksime sa zhvillohen? Janë nga ato që i quan gabime? Dmth kë quan shpejt edhe pse kalojne?**

- Prit pak, të lutem, është motra rrotull. Shiko, fillon të më pëlqejë një djalë për cilësitë që ai ka, fillon fiksimi.

- **Po. Si pamje njëherë, kryesisht.**

- Por pastaj shikoj cilësi të tjera, të cilat më bëjnë të tërhiqem, sepse e shikoj që nuk mund të jetë ky personi i duhur. Kështu e le fiksimin e parë të më kalojë, dhe kalon, dhe nuk lidhem me këtë person. Pra, nuk jam dashuruar ndonjëherë.

- **Shqip, a ke gabuar ndonjëherë në gjykimet e tua dhe të jesh lidhur e më pas të kesh kuptuar që nuk është ky njeriu i duhur? Pra gabimi i njeriut për të gjetur të duhurin, që është normale.**

- Jo, sepse nuk u kushtoj rëndësi fiksimeve, sepse nuk kam parë një njeri të tillë deri tani, për të cilin ia vlen që t'i kushtoj kohën time.

- **E çuditshme, më mbrojtës, filozofikisht, jam unë ndaj vajzave, se sa vetë ato. Shiko, ti ke dashuruar, them, mbase gaboj, por nuk u zhvillua dhe aq në krahun tjetër, spekullim, e di.**

- Ka qënë diçka e momentit, por duke e menduar të nesërmen e pashë se ishte diçka e gabuar.

- **Moment?!**

- Pra nuk ka qënë dashuri, se ndryshe do të zgjaste.

- **Sa kilometra ishte ky moment? Ka qënë e njëanshme, më thuaj. Ky moment, Kaltra, sa kilometra ishte? Se varet.**

- As një ditë.

- **Çfarë???????!!!!!!!! Bën shaka? Si, nisi në mëngjes dhe përfundoi në drekë? Ti më shtang mua.**

- Vetëm për një ditë mendova se mund ta pëlqeja një shok me të vërtetë.

- **Je fantastike.**

- Dmth mund ta doja, …

- Ditë e veçantë?

- … por pastaj pashë se isha gabuar.

- Ishit bashkë besoj.

- Po, ditë e veçantë, por do të të tregoj një herë tjetër për këtë ditë.

* * *

Merilin Monro

Nëna e të gjitha bjondeve. Arkitektja më e rëndësishme e bjonderisë të paktën në Amerikë. Merilin Monro shpiku diçka më shumë se bjonden. Ajo shpiku një vetvete që të shkonte me bjonderinë. Siç doli, vetvetja e saj dhe bjonderia nuk mund të bënin pa njëra veçantë, jo kryesisht vetja, por një tërësi papritur morën jetë dhe ecën nga laboratori i amerikane. Bjondja Merilin u vodhi bruneve Preferojnë Bjondet", në një kohë kur dihej synonte t'ju jepte njerëzve një paradoks. tjetrën. Ajo ishte një krijesë e simbolesh dhe kuptimesh që Hollivudit në kulturën dhe jetën meshkujt. Filmi "Zotërinjtë që zotërinjtë preferonin brunet, Filmi bëri të kundërtën, në qiellin e kulturës dielli "brune" u eklipsua nga hëna "bjonde". Një komb i tërë tha, 'Jo, zotërinjtë pëlqejnë bjondet', pavarësisht se njerëzit e quajtën rolin e Merilinit në këtë film roli i 'bjondes debile'. Ajo për të cilën ata ankohen janë mënyrat e sjelljes së bjondes së Merilinit. Frymëmbajtja, sytë e hapur, gabimet gramatikore në të folur, e

mahnitur në mënyrë të vazhdueshme nga bota dhe pa as më të voglin sofistikim në gjithshka që bën. Këto janë sigurisht shenja të një marrëzije tek disa njerëz. Janë po ashtu një nënshtrim ndaj një shoqërie seksiste, dhe, ditët e sotme, ne shtrëmbërojmë fytyrën hidhur nëse i shohim këto gjëra në karakterin e kujtdo gruaje, në ekran ose jashtë tij.

Por Merilini tjetërkund e pati qëllimin. Ajo donte të themelonte një formë feminiliteti plotësisht të pambrojtur, të hapur e të pandërmjetësuar. Pikërisht femrën e famshme, të kapshme nga të gjithë, një krijesë pa kufi. Të gjithë kanë akses ndaj emocioneve të saj. Ajo nuk përpunon apo manaxhon asgjë të brendshme. Ajo nuk mban avokatë brenda vetes. Është aksesi ndaj të tjerëve, aksesi i kultivuar me kujdes, që e bën bjonden të quhet debile nga kritika. Merilin ishte magjepsëse, sepse ajo nuk kishte asgjë të llogaritur, asgjë të manipuluar. Ajo ishte tërësisht transparente. Një njeri që mund ta zotëroje menjëherë. 'Merilini', dmth ajo lloj bjondeje, ishte një ftesë për shfrytëzim. Sot kjo konsiderohet e rrezikshme. Ky lloj seksualiteti i pafajshëm. Një Stradivar i seksit: e mrekullueshme, falëse, sens humori, e pajtueshme dhe e butë.

Të gjitha ato veti u strehuan në flokët e Merilinit. Pas Merilinit, bjonderia nënkuptonte akses seksual, emocional dhe intelektual. Hapje për gjithshka. Në mënyrë të pashmangshme, bjonderia gjithashtu fliste për një grua që nuk krijonte dot autonomi apo të mbronte vetveten. U bë një ftesë për llojin më të keq të vëmendjes mashkullore. Kështu, disa gra filluan të kërkojnë mënyra që të ishin bjonde që pranojnë të mirën, por shmangin të keqen. Gra të tilla si Susan Sarandon, Kathleen Turner, Ellen Barkin, Jessica Lange dhe Mishel Pfaifer dëshmojnë atë se mund të përdoret bjondja 'Merilin' në mënyrë selektive duke ofruar akses seksual dhe emocional me raste.

Rebelimi ndaj bjondes

Bjondet natyrale janë rebeluar dhe trashëgiminë e Merilinit e refuzojnë me të parën me një lloj alergjie. Ato vetë e lidhin bjonderinë me inteligjencën e ulët dhe deklarojnë se bjonderia i sëmur. Tashmë disa gra janë të bindura se bjonderia është një lloj getoje mbushur me stereotipe saqë ato nuk duan të jetojnë më atje. Por ca të tjera shikojnë anën e përparësive nga të qënit bjonde: njerëzit bëjnë gjëra për ty, të japin gjëra (hëm!), të hapin rrugën në trafik. "Njerëzit më marrin pak si të lehtë, dhe unë e luaj këtë gjë nga një çikë. Sikur më pëlqente vëmendja e njerëzve nga të vepruarit paksa si budallaçkë."

Sidoqoftë, duket se epoka e bjondes po vjen në mbyllje. Bjondet vet po zbulojnë, për tmerrin e tyre, se bjonderia është bërë si një sinjal Pavlovian që çdo grua mund ta përdori për të tërhequr cilindo burrë. Burrat duket se i tërheq bjonderia dhe jo personi. "Ngjyra e flokut tim, thotë një bjonde, nuk kishte të bënte fare me mua, kështu që e zhduka se më dukej fyese." Ja dhe një fotografi e mbretëreshës së bjondeve. Shikoni me kujdes se sa me profesionalizëm e përdor aparatin fotografik.

Dita e nëntë

Një tjetër ditë e mrekullueshme. Moj Bozhe! Më duhej të fiksoja kthimin për Varshavë. Shkova në qytet për të marrë fotot. Si ishte bërë motra! Pastaj shkova deri tek stacioni i autobuzave dhe taksive, u ula diku dhe po vëzhgoja njerëzit e rrallë. Ishte ora dhjetë. Nuk ndejta shumë, se nuk më mbante vendi. Duhej të lidhesha me Varshavën për autobuzin. Pas shumë peripecive dhe streseve e kapa furgonin komod privat dhe e lamë ta prisja diku në mëngjes herët. E konfirmoi edhe Vala nga Varshava. Pastaj, pastaj ajo që më duhej. Dhimbje therëse koke. Erdha rrotull blerimnajave dhe ujërave, mendova pozitivisht, por … Nuk shijova dot as atë darkë mbretërore me peshq. Rrija shtrirë dhe nuk dija ç'të bëja. Ilaçe njëra pas tjetrës, por vetëm vonë më la dhimbja. Atëhere u ngrita dhe paketova sendet e mia. Gjumin e bëra copa-copa.

Dita e dhjetë

Në mëngjes, pronari i guesthouse më mori me makinën e tij dhe më çoi në Mragowo tek vendi i rënë dakord për të pritur furgonin privat i cili nuk vonoi. Një kthim më i bukur se i pari, sepse nuk më dhimbte koka si atë ditë. Katër orë. Pastaj një taksi në Varshavë dhe te shtëpia e Valit, ku më priste Inisi dhe Daniela. Bujarisht, Inisi më çoi në një qendër supermarketesh ku gjuetia ime shkoi huq. Mbasdite erdhi Vala dhe, pas një dreke të këndshme me peshk solomon, organizuar e gatuar nga Inisi, Vala dhe unë ja mbathëm nga supermarketi Makros, sepse më duhej të prishja ca zloti që më kishin mbetur. Qëndruam gjatë aty, kështu që dështoi plani për të vizituar qytetin e vjetër të Varshavës. Punë e madhe, jam i vjetër vetë.

Deri nga ora 11 pm kaluam me kujtime të kohës sonë të shkollës, të udhëtimeve e të eksperiencave tona (jo ato intimet, ej!). Daniela na ndiqte në bisedë me sy të mençur e të menduar. Hyra nja dy herë në internet, kapa D.J. Ronin në chat dhe pastaj një gjumë të thellë.

Brunet dhe kokëkuqet

Perëndimi i bjondes dhe lindja e jo-bjondes.

Të gjitha bukuritë e mëdha të botës janë bruneta. Janë brunetat ato që fitojnë zemrat, ndalojnë gjuhët dhe të marrin frymën. Janë brunetat ato që sundojnë zemrat e burrave. Janë brunetat ato që i bëjnë burrat të qajnë. Çudi, ne nuk jemi mësuar të dëgjojmë vlerësime për brunet. Ajo është zakonisht ngjyra e mbetur, ajo që të ka mbetur nëse nuk i kthehesh ngjyrave bjonde, të kuqe dhe të zezë. Stereotipi thotë se flokët gështenjë janë për njerëzit pa sens drame, pa besim ose pa forcë personaliteti. Ka ardhur koha për të folur më me bujari për flokun gështenjë. Ka ardhur çasti, kur duhen njohur fuqitë transformuese të tij.



Floku gështenjë është plotësimi më i përkryer i bukurisë. Ai është bashkëudhëtari i vërtetë i vetbesimit. Floku gështenjë u lejon grave të pretendojnë qendrën e skenës. Bjonderia, nga ana tjetër, është një ngjyrë tepër egoiste. Okej, kërkon vëmendje, por ajo punon shpesh për veten e vet. Kur një bjonde krijon një sensacion në trafik, mbajtësja e kësaj ngjyre merr vetëm një pjesë të meritës. Pjesa më e madhe i mbetet ngjyrës së flokut. Pyesni një burrë se çfarë pa. “Oh, një bjonde,” do thotë ai duke pulitur sytë, sepse ai nuk pa personin, por një ngjyrë floku. Ai pa një ikonë. Dhe lindi dilema e bjondes, “Jam unë apo floku?”

Po kokëkuqet? Floku i kuq është një ngjyrë me kuptime të fuqishme që provokon reagime të fuqishme. Përsëri është floku që flet dhe jo mbajtësi i këtij floku. Bjondja dhe kokëkuqja e deklarojnë veten që larg, shumë më përpara se ju të shikoni personin që i mban ato flokë. Ndërsa afrohen, të gjitha stereotipet e ngjyrës vrapojnë e ndërgjegjësohen. Më në fund, mbërrin edhe mbajtësja e atij floku, por tashmë është shumë vonë. Nuk ka mbetur më vend në trurin tënd. Mendja është e mbushur me të gjitha nocionet konvencionale. Mbajtësja e flokut nuk është gjë tjetër veçse një transportuese e një mesazhi, një mbajtëse e një ngjyre, thjesht një kokëkuqe tjetër.

Po jo brunet. Brunet nuk mbartin ndonjë mesazh të caktuar. Ato nuk janë skllave të asnjë stereotipi të veçantë. Floku gështenjë nuk konkuron me mbajtësen e flokut për një çikë vëmendje. Nuk është egoist. Floku gështenjë të lejon ta shikosh mbajtësin e tij. Brunet nuk e deklarojnë veten e tyre që larg, kjo gjë sjell surprizën. Nëse një burrë është duke ecur rrugës i humbur në mendime dhe, papritur, diçka ndodhi pranë tij, një brunetë kaloi. Oh, ta shihte edhe një herë, por ajo ka ikur. Ai e kishte bukurinë dhe e humbi.

Ngjyra gështenjë e përmirëson së tepërmi bukurinë e një gruaje pa pretenduar të jetë bukuria e saj. I lihet shikuesit të vendosë se ç'është kjo bukuri. Floku gështenjë, suksesin e ka tek kompleksiteti i ngjyrës së vet, kurrë nuk është e njëjta nuancë. Është si një paletë mundësish, të cilat mund të përdoren për të përfaqësuar aspektet e larmishme të vetë brunetës. Kështu bruneta mund të jetë një bukuri e nxehtë, e qetë, me sensualitet të përkryer, eterike ose tokësore, e rezervuar ose e afruar, ekzotike ose familjare. Mund të jetë edhe kombinimi që të heq trurin, kombinimi i të gjithave sa më sipër. Floku gështenjë krijon mundësira, jo detyrime. Për ato gra që dëshirojnë të marrin vetë vendimet se cilat duan të jenë, floku gështenjë i bën fituese.



Kjo ngjyrë është veçanërisht e fuqishme, sepse kombinon shumë mirë me lëkurën. Floku bjond dendur i shpëlan gratë. Ai është i zënë me grumbullimin e sa më shumë dritë dhe ato fytyra që nuk kanë tipare të forta e të gjalla, humbasin. Ashtu edhe floku i zi, tek gratë e bardha mund të krijojë një kontrast të tmerrshëm dhe një përplasje midis flokut dhe lëkurës. Duhet të jesh një bukuri si Anxhelika Hjuston që ta përballosh këtë kontrast. Kurse flokët gështenjë e bëjnë një lëkurë të bukur të ndrijë. Ajo krijon një tension midis flokëve dhe lëkurës që nuk është kurrë konkurues apo kontrast mizor. I mbani mend filmat "Katër dasma dhe një funeral" apo "Eduard Duargërshëra"? Një pjesë e bukurisë së Andie MacDowell dhe Winona Ryder, që luajnë në to, i dedikohet lojës midis flokëve dhe lëkurës. Sa më shumë që i shikon aq më shumë bukuria e tyre e manifeston vetveten.

Brunetat e lozin seksualitetin me arsye e gjykim të madh. Atë që bjondet e Hiçkokut e arrinin me artifica, brunet e arrijnë pa përpjekje. Brunet mund ta ngrenë zërin e seksualitetit shkallë shkallë, ndryshe nga bjondet që fillojnë me zë të lartë dhe qëndrojnë me zë të lartë. Jo, brunet e shfaqin seksualitetin e tyre, edhe një herë, shkallë-shkallë. Ato nuk trumpetojnë ndonjë mesazh seksualiteti siç e bëjnë disa bjonde dhe kokëkuqe. Mesazhi i bruneve ju vjen tinëzisht dhe ju kap papërgatitur.

Tradicionalisht, opinioni ynë për brunet nuk ka qënë shumë bujar. Kur rregjimi i bjondeve mori pushtetin nga vitet 40 e 50, Hollivudi u bë gjithmonë e më pak miqësor me brunet. Në ato kohë floku gështenjë konsiderohej një aksident i pamirëpritur, madje tragjik, i lindjes. Sigurisht, fajin kryesor e ka Merilini e cila legalizoi bjonden. Pas saj, bjonderia ishte si seksi, ashtu edhe e pafajshme. Floku gështenjë ishte plotësisht prapa hënës, i eklipsuar. Ishte bërë simbol i shtëpiakes, bashkëshortes dhe mungesës së personalitetit deri në një farë mase.

Fatmirësisht, bota po ndryshon. Duket se floku gështenjë është në transformim. Duke filluar nga vitet 90, gjuha për brunet po ndryshon nga dita në ditë: "Bojëndryshku i ndritshëm", "Kafe e errët mëndafshore", "Gështenjë e pasur", "Floku brun është tashmë më emocionues dhe më i besueshëm", "Bjondet mund të kenë gjithmonë gallatë, por brunet, të ndritçme dhe çokollatë, po mbushin lajmet që lidhen me bukuritë e mëdha". Në këtë valle kanë hyrë edhe parukierët, të cilët nuk i këshillojnë më gratë që të ndryshojnë flokët e tyre gështenjë. "Nëse je brunetë, bëhu një brunetë e madhe. E kush jam unë t'u them njerëzve bëhuni bjonde?" Pjesërisht kjo i kushtohet edhe rritjes nga vitet 90 të ndjenjës për të qënë natyralë. Revista Vogue shkruante, "Gratë harxhonin shumë energji duke provuar të dukeshin plotësisht ndryshe. Ashtu siç po





largohemi nga ideja e ndryshimit të tonit natyral të lëkurës, po ashtu po largohemi nga artificialja në ngjyrën e flokut.” Dhe njerëzit po bëhen gjithnjë e më nervozë ndaj substancave artificiale, që kanë hyrë me shumicë në jetën e tyre. Ngjyra kafe e flokut po fiton terren si ngjyrë natyrale. Hollivudi po rishikon qëndrimet e tij. Askush nuk u habit kur Geena Davis dhe Julia Roberts u kthyen përsëri brune, pasi ishin konvertuar në bjonde. A do të kishte ngjyrë më të bukur për ato femra që janë si Demi Moore? Ç’ngjyrë do t’i përshtatej më mirë

një gruaje me bukurinë, inteligjencën dhe aftësitë e saj? E provoi bjonden Demi Moore dhe hoqi dorë. A mund të kthehej në kokëkuqe? E paimagjinueshme. Po sikur t’i kishte bërë po aq të zeza flokët sa edhe Cher? E pamundur. Zgjedhja e pashmangshme ishte ngjyra gështenjë.

Meqënëse gratë po refuzojnë stereotipet seksiste dhe duke patur parasysh se çfarë presin prindërit, bashkshortët dhe fëmijët, ngjyra gështenjë po duket gjithnjë dhe më e përshtatshme, sepse është ngjyra që ato mund ta kenë për veten e tyre.

Si u shpik kokëkuqja, për të cilën duhet kërkuar falje.

Në shoqërinë tonë nuk jemi kurrë tamam të sigurtë se çfarë përfaqëson floku i kuq, por ama jemi shumë të sigurtë se kokëkuqe përkthehet ‘sherr’. Ne e shoqërojmë të kuqen me shejtanllëqet, kokëfortësinë, temperamentin, paparashikueshmërinë dhe, paradoksisht, forcën dhe dobësinë e karakterit. Ju e dini shumë mirë se këto cilësi nuk janë shumë të lakmueshme, nuk janë ato që medoemos ju sjellin lumturinë në shtëpi apo suksesin në botë Kokëkuqet na alarmojnë paksa. Gjithë ai flok, gjithë ajo ngjyrë, tamam si flamur që na paralajmëron “Po vjen sherri!”.

Floku i kuq flet për cilësi temperamenti. Një Rita Hayworth. Për të qënë të ndershëm, floku i kuq nuk përfaqëson armiqësinë apo agresionin, por e ka një cilësi të hollë shoqërore rreziku apo kanosjeje. Jo se ekziston ndonjë frikë në drejtimin e tyre, por kur u hedhim një sy flokëve të kuq, vrasim mendjen dhe një zë brenda nesh thotë “Sigurisht, një kokëkuqe si kjo duhet të jetë një lloj anarshisteje.”

Floku i kuq përfaqëson atë pjesë tonën, kur nganjëherë ne ndjehemi pa dëshirë për të bërë atë gjë që duhet dhe që është e drejtë. Kur ndjehemi të parespektueshëm dhe duam të gërricemi, kur duam ta kruajmë me qorromidhe. Kur jemi të lumtur për mundësinë që na krijohet për djallëzi, të zellshëm për të futur hundët e për t’u ngatërruar me autoritetet dhe për të thyer rregullat e vogla të sjelljes shoqërore. Shkurt, kur ndjehemi adoleshentë delikuentë. Nëse ne e ndryshojmë ngjyrën e flokut me gjendjen tonë emocionale, atëhere duhet e kuqja, kur ndjehemi rebelë. Kokëkuqet na bëjnë nervozë, sepse i imagjinojmë si të gatshëm për t’u hapur udhë atyre gjërave, që ne përpiqemi t’u vemë fre. Kokëkuqet janë çfarë ne do të ishim sikur të bënim atë që donim. A nuk janë kokëkuqë kllounët e cirkut?

A nuk themi që fëmijët kokëkuqë janë të prirur për shejtanllëqe dhe del që një numër vërtet i madh i tyre janë hiperaktivë. A mos ka ndonjë gjë biologjike të natyrshme këtu? Apo është për shkak të faktit se stereotipet tona na thonë se fëmijët kokëkuqë duhet të kenë energji maniakësh? Ne i trajtojmë si të tillë dhe ata bien dakord.



Jokonformiteti është një tjetër cilësi që thuhet se u përket kokëkuqeve. Ne besojmë se ato janë kokëforte e kryeneçe. Sikur njerëzit të donin vetë të dilnin nga mitra kokëkuqë. E konsiderojmë këtë ngjyrë të çuditshme, si një akt të qëllimshëm fyes e përbuzës. Çuditërisht, kemi dy pamje kontradiktore të kokëkuqeve. Besojmë se kanë fuqi speciale karakteri ose asnjë fuqi të vërtetë karakteri. Nga njëra anë ato kanë një ndjenjë spontaneiteti dhe ngatërresash që na mungojnë ne të tjerëve. Ato shprehen me energji dhe vendosmëri të veçantë. Nga ana tjetër ne besojmë se ato nuk janë në gjendje të kenë vetkontroll të impulsivitetit të tyre. A mos ka këtu ndonjë rregull? Ka një llogjikë kulturore në të gjithë këtë që e bën pikpamjen tonë për to të ketë kuptim. Kokëkuqet në Amerikë përbëjnë vetëm 2% të popullsisë. Ka një numër të mjaftueshëm sa për të mos u quajtur nga ne trille të tmerrshme të natyrës, por ama mjaftueshmërisht pak si numër që ne të mësohemi me to. Ato janë gjithmonë të jashtëzakonshme duke sfiduar të gjitha kategoritë e tjera. Me gjuhën e antropologjisë ato janë në kufi, as tamam peshk dhe as shpend.

Sa mirë sikur të ishin më pak prej tyre, sepse ne do t'i trajtonim si albino, si akte padashje të natyrës dhe nuk do t'i kushtonim vëmendje. Por ah sikur të kishte më shumë prej tyre, sepse ne do të krijonim një vend për to pranë bjondeve, flokë gështenjave dhe flokëzezave, pra një prani rutinë në jetët tona. Na del, pra, se kokëkuqet janë në numër mjaftueshëm të madh për t'u injoruar dhe mjaftueshëm të vogël për t'u pranuar.

Kokëkuqet janë objektiva të lehtë. Për arsye se janë të papritura dhe të papranueshme, ne zhytemi në prirje të këqia. Ne bëjmë atë që bëjnë njerëzit gjithmonë, kur e ndjejnë veten në praninë e dikujt ndryshe, ne fillojmë të ushqejmë mendime të pakëndshme dhe stigmatizojmë dyshime. Kjo vjen ngaqë ne mendojmë se ***ngjyra e flokut është temperatura e shpirtit.*** Kjo ngjyrë na tregon ne se ky person gëlon nga emocionet e egra e të pakontrolluara, të cilat do të shpërthejnë nga to, siç shpërthejnë flokët, të pakontrolluara, të panegociushme, disi vullkanike. Pasi i kemi bërë të jashtëzakonshëm dhe ndryshe, pasi kemi shpikur një shpjegim për të qënit ndryshe: janë të nxehtë dhe të rrezikshëm, ne i syrgjynosim. Ne i bëjmë, në fakt, alibi për frikat tona të shejtanllëqeve, kokëfortësisë, temperamentit dhe paparishikueshmërisë, i çojmë deri në kufi të fshatit dhe i përzemë. Prandaj kokëkuqët nuk pëlqehen, sidomos burrat, të cilët duken si antishoqërorë, aspak tërheqës dhe të pasuksesshëm. Me gratë kokëkuqe nuk jemi dhe kaq mizorë, por armiqësia që mendojmë ne është aty tek ato. Ato konsiderohen të pabesa dhe të dhunshme. Kurse fëmijët kokëkuqë janë larg këtyre. Fëmijët kokëkuqë janë personazhet më të dashur në krijimtarinë tonë letrare dhe kinematografike.

Ja, pra, duke i ngarkuar kokëkuqet me të gjitha cilësitë që ne kemi frikë brenda vetes, i deklarojmë të rrezikshme. Pasi i kemi deklaruar të rrezikshme, i dëbojmë. Por ka mbetur edhe diçka. Tani që i kemi dëbuar, mendojmë që ka ardhur koha t'i reabilitojmë. Ato janë si rrufepritëse për armiqësinë tonë, kështu që janë shumë të dobishme për t'i hequr qafe fare. Ne mund të përqeshim tek ajo ato gjëra, që i kemi frikë brenda vetes. Ndërkohë kokëkuqet kanë dy cilësi të kundërta: tërheqjen dhe rrezikun. Pjesë e kësaj tërheqjeje është seksualiteti. Burrat njëkohësisht i ze paniku, por edhe intrigohen nga kokëkuqet. A mos kanë fuqi të veçanta

sensualiteti? Floku i tyre thotë se ato kanë emocione të gjalla, janë të pakufizuara dhe të pranishme. A janë këto tregues të karakterit seksual brenda tyre?



Gratë kokëkuqe u dërgojnë burrave dy sinjale. Nga njëra anë duket se nuk janë të prirura të luajnë atë rolin e vogël tradicional të partnerit, por, nga ana tjetër, premtojnë lumturi sensuale të një shkalle të jashtëzakonshme. Kohët e fundit, njerëzit kanë filluar ta shohin flokun e kuq paksa ndryshe. Reabilitimi i flokut të kuq na çon një hap më përpara. Gratë po kërkojnë të gjitha cilësitë e vjetra. Tani gratë thonë se floku i kuq nuk do të thotë shejtanllëqe, por gjallëri, jo jokonfirmitet, por origjinalitet, jo kokëfortësi, por vendosmëri, jo temperament, por pasion, dhe një forcë karakteri të vendosur dhe jo të rrezikshme. Floku i kuq po karikohet me cilësi pozitive. Sipas një parukieri nga Toronto, floku i kuq është një ngjyrë "Mos u ngatërro me mua". Dhe, çudi, kokëkuqja me këtë të kaluar, sot nga "E mrekullueshme, por e rrezikshme, është bërë e mrekullueshme, sepse është e rrezikshme". Sot është një nga ngjyrat që flet për burime të pashtershme, ambicieje dhe fuqije. Sipas psikologëve, kokëkuqja sugjeron një grua që është e sigurtë në vetvete dhe që ka marrë në dorë jetën e saj. Po të doni mos u habitni, në 1987, vetëm në ShBA kishte rreth 5 milionë gra që ishin ose kishin zgjedhur të ishin kokëkuqe, pa harruar yjet e kinemasë. Nikol Kidman nuk është një shembull dosido. Shtypi i modës filloi ta shikojë flokëkuqen me përzemërsi dhe kjo është fitorja më e rëndësishme morale për çdo ngjyrë që dëshiron të ngjitet në botë. Industria, kufiri i fundit dhe final, nga ana e vet u përgjigj duke prodhuar dy nuanca të reja të së kuqes. Në 1970, L'Oreal kishte dy nuanca. Në 1989, ata kishin 16 nuanca, Redken 29 dhe Clairol kishte 43 nuanca.

Tani kokëkuqja sugjeron një person, veç sa më lart, edhe krenare për seksin dhe seksualitetin e saj. Në fund të fundit, e kuqe a nuk do të thotë rrezik dhe zjarr? Ajo gjë që dikur ishte e rrezikshme dhe si rrjedhojë e keqe, tashmë është e rrezikshme dhe si rrjedhojë e mirë.

Nëse Joan Bennett është kampjonia e bruneve, Merilin Monroe kampionia e bjondeve, pa diskutim që Rita Hayworth është kapionia e kokëkuqeve. Hayworth e filloi si një bukuri spanjolle me flokë të errët. Në Hollivud, Helen Hunt, e ktheu atë në kokëkuqe. Floku i kuq u bë marka e Hayworthit dhe një simbol i arritjeve të saj si kërcimtare, aktore dhe yll. Pra, ajo ngjyrë që filloi si ngjyrë për fëmijë, komikë dhe kllounë është tani flamuri i vendosmërisë.

Floku gri ose i thinjur

Tradicionalisht floku gri ka qënë shenjë e moshës së rritur. Thuhej sikur floku i thinjur përfaqësonte hirin e rinisë. Gjithashtu thuhej se floku i thinjur është fillimi i fundit të individualitetit tonë. Njerëzit që dikur dalloheshin nga ngjyra të ndryshme tashmë duken njëlloj. Sidoqoftë askush nuk e blen idenë se thinjat shënojnë fillimin e fundit të vetes sonë të gjallë. Dhe ka gra që revoltohen nga ky trajtim i thinjave. "Unë i lyej vetë gri, thotë një grua, për t'i dhënë vetes një pamje zgjuarësie dhe eksperience. Për burrat kjo gjë funksionon, e pse

të mos funksionojë edhe për mua?” Dhe vërtet funksionon duke i dhënë bukurisë së asaj gruaje prani dhe qetësi.

Në 1993, grija ishte në modë për vajzat angleze rreth të njëzetave. Megjithatë ky ka qënë një opinion në pakicë. Kultura jonë e ka përdorur tradicionalisht grinë si një term pexhorativ. Me gri kemi emërtuar botën pa tipare dhe shtypëse: burgun, varfërinë, spitalin, kundërshtarët politikë. Ne i quajmë gri edhe ditët e Nëntorit që kërcënojnë humorin tonë të mirë. Cila është frika? Zvogëlimi i tërheqjes seksuale. Se gjërat po vijnë drejt fundit. Ngjyrimi i tyre nuk ishte përgjigja. A nuk është irrituese, kur mendon se thinjat e bëjnë një burrë të spikati? Ndërsa floku i burrave fillon të thinjet tek tëmblat e tyre, stereotipi thotë se burrat janë gati për ngritje në përgjegjësi, bota tani duhet të kthejë sytë nga ata për këshilla të matura. A nuk është shumë seksiste kjo gjë? Gratë na u dashka që të paguajnë për moshën që përparon, me kredibilitetin dhe tërheqjen e tyre, ndërkohë që duket se burrat janë përmirësuar prej saj.

Ka gra që e përdorin grinë mirë, në mënyrë që t’u përshtatet lëkurës dhe syve të tyre. Këto gra po shtohen. Tani ato e përdorin grinë si një distinktiv të ndershmërisë së tyre. Ato duan të thonë se mosha nuk është turp dhe nuk nxit dënimin. Këto gra janë pionere të një lëvizjeje heroike. Ato po sfidojnë ‘ligjin’ derisa ai të abrogohet. Ka edhe alternativa të nderuara ndaj thinjave. Nuk është gabim të mbulohen thinjat me një ngjyrë tjetër. Disa gra i lenë të thinjura duke thënë “Dua të jem unë e vërteta”. Por të mos harrojmë se në një kulturë transformuese, ka shumë “unë të vërteta”. Thinjat janë thjesht një aksident i kushteve tona aktuale biologjike dhe jo medoemos një shenjë e auticintetit tonë.

Për disa gra, kompromisi i lumtur është ta shtyjnë ca grinë pa e eliminuar atë. Parukierët e mirë shtojnë aq ngjyrë sa të parandalojnë përshtypjen e grisë dhe asosiacionet e saj.

Modeli i flokut

Floku njeh shumë modele të cilat përfaqësojnë një hartë të shumë veteve tona të mundshme në kulturën tonë. Në skenarin më optimist, çdo luk i ri është një mundësi e re për transformimin dhe vetzbulimin e klientit të parukierit. Në rastin më të keq, çdo luk i ri është një rrugë qorre estetike dhe emocionale.

Stile të ndryshme floku kanë kuptime të ndryshme:

- Floku sensual lidhet më shumë me seksualitetin.
- Floku imperial lidhet kryesisht me statusin shoqëror.
- Floku i karierës lidhet kryesisht me profesionalizmin.
- Floku i rruar apo qethur me gërshërë dhënsh lidhet me protestat.
- Floku i zanave lidhet me magjepsjen.

- Floku i matururar lidhet me një tragjedi të caktuar ose një tërheqje me dinjitet nga moda.

Ne jetojmë në buzë të një pellgu arkeologjik mundësish. Një pamje e re nuk anullon pamjet e vjetra, ato janë rrotull, ato bashkëjetojnë. Tashmë ka rreth 50 pamje të ndryshme të identifikueshme në botën e flokut. Këtu do të përmendim vetëm dhjetë prej tyre. Ca, sepse kanë qënë të modës, ca se ishin popullore, ca sepse ishin absurde, ca sepse ishin interesante dhe ca sepse ishin llahtarisht voluminoze. Asnjë nuk është një zgjedhje e përkryer.

Floku voluminoz

Sa më i lartë floku, aq më afër është me Zotin. Floku voluminoz është një nga mrekullitë arkitekturale të kohës sonë. Ai qëndron lart, anash, del përpara dhe kërkon ta shohin. Floku voluminoz kërkon efektin, dramën dhe ekstravagancën. Dashuroje ose ik. Nuk është shumë i interesuar në delikatesën dhe dhelpërinë. Dhe as që do t'ja dijë për të natyrshmen. Floku voluminoz është shumë i zënë duke sfiduar tërheqjen gravitacionale dhe duke pretenduar vëmendjen tonë. Ka shumë snobizëm rreth flokut voluminoz. Gratë e pëlqejnë këtë flok për shumë arsye si ato estetike meqënëse ai i bën tiparet e mëdha të fytyrës të duken delikate dhe të vogla, veshët e mëdhenj zhduken, zbehen mjekrat e varura dhe, mbi të gjitha, floku voluminoz është shumë më i lirë se kirurgjia plastike.



Floku voluminoz është i shoqërueshëm. Ky është flok Dolly Parton dhe ndihmon në ndërtimin e një personaliteti Dolly Parton. Nuk ka asgjë gjoja aty. Atë që sheh, ajo është. Ky flok është edhe seksi. Nuk ka flok më seksi se floku voluminoz, thonë gratë e Nju Jorkut. Këtu lind pyetja, nëse objektivi është për t'u dukur seksi, përse të mos mbahen flokë sensual. Flokëvoluminozet thonë se floku sensual është pa shumë gusto dhe se voluminozi sikur thotë "Ti e di se me kë ke të bësh." "Nuk më bëhet vonë për librat, meshkujt më interesojnë." Është mënyra më e thjeshtë për t'i thënë botës se ajo nuk është aty për të vrojtuar, por për të marrë pjesë. Ashtu si Kamarrot, edhe flokëvoluminozet janë një trofe statusi. Ato kanë një autoritet të caktuar. Variacione të flokut voluminoz kanë patur Barbara Bush, Nensi Reagan dhe **Elizabet Tailor, gjëja më e afërt me mbretëroren që ka patur ndonjëherë Amerika.** Virtyti i flokut voluminoz është se i jep mbajtëses së tij një dimension dhe madhështi të caktuar. E bën impozante dhe, sikur të thotë, "Më merr seriozisht!"

Armiqtë e flokut voluminoz thonë plot

gjëra të papëlqyeshme për të: grua pa vlerë, vulgare, do të duket më e re, do të duket më e moshuar, duan të zëvendësojnë besimin, për të kompensuar ndjenjën e paaftësisë ashtu si ata burra që ngasin vetura të fuqishme, duan të fshihen, pamja më me pak sensualitet, burrat e kanë të vështirë t'i kalojnë duart mes tij, është antiekologjik, meqënëse kërkon llak gjithmonë e më shumë.

Floku voluminoz ka lulëzuar dhe falimentuar me periudha. Vjen dhe ikën. Periodikisht. Kurrë nuk u krijua si modë kryesore. Adoleshentët e kanë sjellë herë-herë. Herë-herë shtypi deklaron vdekjen, por kjo është më tepër një dëshirë. Atje ku jeton floku voluminoz, ai lulëzon dhe, atje ku ai mbizotëron, është i pamposhtur.



Floku sensual

I egër dhe i lirë. E fut një vajzë në telash. Ky është floku "sapo bëra seks". Gjëja e parë që thotë është "rini". Shumë femra e mbajnë këtë flok që kur janë adoleshente, deri në moshën njëzet – tridhjetë vjeçe. Disa e vazhdojnë edhe më tej. Psh Cindy Crawford. Për disa gra, floku i gjatë është një nga liritë e rinisë. Pas mesazhit të mësipërm, vjen mesazhi i dytë, një mesazh seksual. Floku i gjatë thotë se mbajtësja është një krijesë seksuale. Seksualitetin këtij floku ia shton edhe tekstura e tij sensuale. Floku i gjatë e mban parfumin më mirë dhe kjo kontribuon në atë që quhet braktisja e çastit. Kështu shprehen disa burra duke nënkuptuar se kjo i bën të qëndrojnë më gjatë duke i dhënë më shumë shanse vetes dhe pronares së këtij floku. Transformimi i jashtëm duket se sugjeron një transformim të brendshëm pavarësisht se konsumohen shumë justifikime me këtë rast. Është ndryshimi i një gruaje burokratike dhe nervoze në një të egër në liri dhe seksualitet me tepricë. Ishte Hollivudi ai që ndihmoi për të identifikuar rëndësinë seksuale të flokut sensual. Sipas industrisë komerciale, bollëku dhe lakimet e flokut janë simbolikisht në pajtim me plotmërinë dhe lakimet e trupit më poshtë. Dy ikonat që ata përdorën për ta transmetuar këtë ishin Cindy Crawford dhe Claudia Schiffer.



Lidhja që bëhet midis flokut të gjatë dhe seksualitetit mund të duket një shpikje e Hollivudit dhe botës së modës, por mos harroni se kjo është kthyer një bindje kulturash, kryesisht asaj amerikane. Mbrëmjet e maturës kalojnë nëpër dy faza: ajo e para, zyrtarja, kur ndodh riti i parakalimit ku floku mbahet i ngritur lart. Adoleshentët po shkelin në moshën e rritur dhe sa më formal të duken, aq më shumë janë gati për ndryshim. Pastaj ndodh pjesa e dytë, ajo jozyrtarja ku adoleshentet i lëshojnë flokët poshtë dhe ia dorëzojnë veten braktisjes. Flokët e gjatë e të egër përfaqësojnë çertifikatën e tyre të re seksuale dhe liri të tjera të rriturish. Pra, floku i gjatë përfaqëson kalimin në seksualitet.

Floku i gjatë nuk flet vetëm për seksualitet, por edhe për romancë. Ai është simbol i një gjendjeje ekzaltimi emocional, ku ndjeshmëria dhe arsyeja janë lartësuar nga angazhime romantike. A është e mundur të parafytyrohet një heroinë

romantike me flokë të shkurtër? Në mënyrë paradoksale, floku i gjatë herë-herë shihet edhe si e kundërt e seksualitetit, një "Liza në Botën e Çudirave", një deklaratë e pafajësisë fëminore pa motiv apo edhe ndërgjegje seksuale.



Pra, gratë që duan vëmendjen entuziaste dhe seksuale të burrave, e dinë tani me saktësi se çfarë duhet të bëjnë, kurse ato gra që duan t'i shmangin këto vëmendje, e dinë se si t'i shmangin. Tashmë e dinë se si të 'redaktojnë' një pjesë të mirë të vëmendjes së padëshiruar të burrave.

Floku imperial

Ky flok të bën të dëgjosh atë që ajo do të të thotë.

Mos e fërko në krahun e gabuar se mund të të kafshojë

Kjo është shoqëri e lartë, dikush me fuqira.

Floku imperial është flok voluminoz me një qëllim. Ky është flok me shuplakë politike. Ai thotë: "Unë jam një grua për t'u çmuar." Kjo është një prerje për ish-kryeministre si Thatcher. Nuk është medoemos seksual ose ftues. Ky flok nuk ka nevojë për të fituar, ai është fitimtar. Nuk shpreh asnjë emocion dhe deklaron: "Unë e di me saktësi se çfarë kërkoj. Nuk kam ndërmend të ndryshoj. Për ju, jo që jo, në asnjë mënyrë." Floku imperial është i vendosur. Ai nuk bën asnjë premtim kompromisi apo negociimesh. Jo shumë vanitoz, por maksimalisht me besim në vetvete. Besim në vetvete pa asnjë hije dyshimi. "E di me siguri se kush jam, mund të jem ose jo e interesuar se kush jeni ju."

Jo çdo prerje floku është e përshtatshme për një grua profesioniste në vitet e vona të karierës së saj. Do të ishte gabim për një grua në vitet e hershme të karierës, sepse është një stil shumë i shtangët, i mbyllur, i vetsigurtë, i vetrëndësishëm për t'u dukur mirë te një grua që sapo ka filluar të krijojë identitetin e vet. Por për profesionisten e stazhionuar, kjo prerje është si një demonstrim i tmerrshëm force. Ja pse i shërbeu Margaret Thatcherit aq mirë. I tregonte popullit vendosmërinë e saj. Sundueset

gra kanë përballuar prej shumë kohësh atë sfidën e veçantë të seksizmit, ku një pjesë e kombit ka ankoruar mosbesime të rënda, në formë parandjenjash, lidhur me aftësitë e një gruaje për të drejtuar çështje të shtetit.

Krifa gështenjë e Mërfit



Ky flok pëlqehet nga shumë gra. Ai ia arrin të kombinojë seksin, ëmbëlsinë dhe autoritetin që të punojnë sëbashku. Ky është sekreti i tij, sepse nuk mendohet kurrë se këto të tria mund të shkojnë sëbashku. ***Zakonisht për seksin ju duhet të paguani autoritetin.*** Ëmbëlsia zakonisht ju kushton seksin. Autoriteti ju kushton ëmbëlsinë. Krifa e Mërfit ia arrin t'i kombinojë të tria që të punojnë sëbashku. Ky stil floku mund të themi se u përpunua kryesisht nga dy njerëz: Farrah Fawcetti dhe Candice Bergen si Murphy Brown. Dikush atëhere tha: Unë është aktorja më e keqe në botë, por mua saj." Miliona gra dhe burra u ndjenë në mendoj se Fawcetti më pëlqen floku i të njëjtën mënyrë. Fawcetti e rriti influencën duke i shtuar flokut edhe qëndrimin e trupit. Floku e bëri Fawcettin një yll. Atë e kritikuan duke e quajtur "Kukulla Barbi". Ata nuk kuptonin thelbin e çështjes. Floku i saj ishte i fuqishëm, sepse kishte arritur të kapte kultin Kalifornian të trupit. Ai simbolizonte shëndetin, energjinë, jetësoren dhe sensualitetin e një trupi perfekt.



Fawcetti kishte gjetur një rrugë ndryshe nga Monroe për ta bërë seksin të disponueshëm, dhe njëkohësisht jo kërcënues për të tjerët. Sidoqoftë ky stil ka edhe dobësitë e veta. Në duart e gabuara ky flok kthehet shumë shpejt në një parodi të vetvetes. E dyta, disa gra të reja e shohin si të dalë mode: shumë llak, shumë energji, jo shumë natyralizëm. "Ky është si flok i mbushur." Mesazhi i agresivitetit të një floku varet nga ajo se sa lëviz floku.Kur atë e ngrijnë me llak, njerëzit nuk ndjehen të lumtur. Pamja bie në kundërshtim me vetveten. Disa e konsiderojnë si një përpjekje e gruas së pjekur për t'u dukur më e re. Feministët shpesh e urrejnë këtë stil dhe e identifikojnë këtë me kapitullimin ndaj gjithshkaje që kërkojnë burrat.

Burrat nga ana e tyre e pëlqejnë në përgjithësi. Ky flok u sinjalizon vetbesim dhe një miqësi të caktuar. Një stil që u shërben veçanërisht atyre grave që kanë disa vartësa burra. Është femëror, edhe seksual, por edhe u jep burrave mesazhin e autoritetit shumë qartë. Nganjëherë ky flok flet me një zë shumë më të lartë se ç'mund t'u pëlqejë burrave.

Floku Piksi

Femërore, pa shumë llafe. Stil floku pa armiq. Fitues, i larmishëm, i modës dhe interesant. Gjëra që nuk mund të thuhen për stilet e tjera. Stil që deklaron seksualitetin e gruas pa provokuar. Stil i barazpeshuar: tërheqës, por jo kërcënues. Floku Piksi ka katër variante, të gjitha dinjitoze. Mirëpo floku Piksi humbet diçka në autoritet, prandaj edhe nuk e kemi parë tek gratë zyrtare, nuk u jep peshën e duhur për një zyrë publike. Stella Rimington do që të dëshmojë të kundërtën. Ajo i ka flokët Piksi dhe nuk është pak zyrtare. Ajo është koka e një prej agjensive të sigurimit britanik me dy mijë nëpunës dhe një buxhet miliona paundësh, me detyrën e mbrojtjes së Britanisë nga terrorizmi ndërkombëtar.



Interesante është se Piksi lulëzon çdo fillim dhjetëvjeçari për një numër vitesh. Kjo ndodh si të thuash me shpresën e transformimit tonë me ide dhe imazhe të reja. Lulëzoi edhe në vitet 90. Floku i shkurtër është si një fustan fantastik, hyr në të dhe ik. Të dyja e thjeshtojnë dukshëm jetën. Në 1994, gratë filluan të mbanin flokë të shkurtër, të konvertuar në bjonde ose me maja me ngjyra. Mendohet se ishte pjesë e reaksionit ndaj viteve 80 të natyralizmit. Gratë po përpiqen të jenë sa më fallco ose kallp. Sidoqë të jetë e ardhmja për flokun, apo stilet e tij, dy stile kryesore do të lozin mbi dy kuaj cirku krejt të ndryshëm: natyralizmi kundër-modës dhe antinatyralizmi në modë.

Piksi lulëzon, sepse është në modë dhe i sofistikuar. Elegant dhe i këndshëm. Është në modë, por nuk kërcënon dhe nuk tallet me asnjë. Burrat e pëlqejnë, megjithëse tipat aventurierë ankohen se ky stil nuk ka asgjë seksuale, nuk ka sirenë që të tërheqë që larg. Por është pikërisht kjo gjë ajo që e bën kaq të përkryer këtë prerje floku për ato gra që duan të shmangin aventurierët.

Kukulla Kineze/Kukulla Baby ose Kleopatra

Këto janë disa nga emrat me të cilat quhet kjo prerje floku. Secili emër ka interpretimin e vet. Kukulla Kineze vjen me nocionet stereotipike të femrës aziatike, sepse e bën mbajtësen e flokut të duket pasive, delikate dhe e varur nga burrat. Parametra të ngjashëm shoqërojnë edhe Kukullën Baby: e ëmbël, pasive, nevojtare. Por prerja me Kleopatrën në emër ndryshon nga dy të parat. Ajo zgjon një grua me pushtet dhe mister. Dramatike.

Kjo prerje ka një cilësi joshjeje. Ka diçka intriguese, një sens misteri. Azia dhe Egjypti. Ekzotik. Mundet që këto spekullime të jenë të gabuara, por ky flok digjet përbrenda. Elizabet Teilor e veshi këtë flok në filmin e saj Kleopatra, dhe suksesi e ngriti në modë duke e përhapur. U qarkullua në vitet 1990 dhe Maikël Xhekson i ngriti një memorie në videon e tij "Remember the time".

Burrave u duket tërheqëse dhe paksa frikësuese. Shohin një lloj misteri: Kush është kjo grua? Çfarë mendon? A mund t'i besohet? A ka instikte të çuditshme dhe të huaja? Ekzotike. Kjo prerje i bën burrat të ndalojnë për pak kohë për të bërë këto pyetje. Vëmendja e tyre ishte tërhequr.

Bobi i pjekur (flokë të prerë shkurt për të rritur)

Kjo është në të vërtetë fillimi i fundit. Është bërë tashmë ligj, ndërsa një grua moshohet, ajo shkurton gjithnjë e më shumë flokët. Flokë të gjatë në shkollën e mesme, pastaj i presim. Bëni një vrojtim të vogël. Shkoni në një mbledhje ose takim femrash të të gjitha moshave. Do të shikoni se gati çdo grua nën moshën 25 vjeç i ka flokët të gjatë, çdo grua mbi 40 vjeç do t'i ketë flokët e shkurtër dhe gratë në mes të këtyre moshave do të jenë në tranzicion. Të gjithë e dini të çuditshmen; asnjë grua nuk e pranon se i pret flokët se i pëlqen t'i presi apo shkurtojë, por se ja do puna, nuk ka se ç'bën. Nuk ka asnjë shpjegim për këtë. Prerja e flokut është një lamtumirë e trishtuar e rinisë.

Ja, sidoqoftë, një shpjegim interesant. Burrat i pëlqejnë flokët e gjatë tek gratë. Meqënëse gruaja rritet, moshohet, martohet, bën fëmijë, ajo del nga qarkullimi. Ja pse i pret flokët. Pra, gratë nuk janë më në treg. Po ta shihnim më me vëmendje, do të thoshim se gruaja i shkurton flokët për të dhënë një sinjal se ajo i ka lënë kotësitë femërore dhe preokupimet e rinisë prapa krahëve. Sot, floku i shkurtër deklaron, "po më ecën mirë jeta". Përfundimisht floku i prerë shkurt konsiderohet jashtë rrëmujës së modës, nganjëherë i parashikueshëm dhe nganjëherë i mërzitshëm. Nuk ka shumë zgjedhje këtu. Një gjë është e sigurtë: floku i shkurtër është edhe shenjë se gratë duan të kontrollojnë jetët e tyre, të dalin nga roli i ornamentit, i kukullës.

Burrat nuk janë bujarë me këtë prerje, megjithëse kur martohen do të donin që gratë e tyre t'i prisnin flokët shkurt, me qëllim që burrat e tjerë të mos u binin në qafë tërë kohën. Për këta burra, floku i shkurtër është shenja e statusit të martesës. A nuk është çudi që burrat nuk i ndryshojnë flokët pas martesës?

Prerja zyrtare

Një prerje mjaft tërheqëse që lulëzoi sidomos në vitet 80-të. Lindi si prerja më e mirë për gratë që donin të hynin në botën profesionale, sepse nënkupton një grua kompetente dhe serioze. Funksionoi. Gratë e çuan këtë prerje në dhomat e gjykatave, bizneseve, administratave etj. Prerja zyrtare u thotë burrave: "Jam këtu si kolegia jote, si e barabarta jote, mund të bëj çdo gjë që mund të bësh ti, dhe ndoshta më mirë se ti." Gratë kishin patur nevojë për një mënyrë deklarimi të synimeve të tyre dhe zbuluan kostumin me shpatulla të gjera, të standartizuar, me kontrast të lartë, pak i shtangët dhe i disiplinuar. Ai kostum sikur të thoshte, "Hiq dorë nga stereotipet lidhur me gratë e lehta, emocionale dhe të pazonja. Gratë janë gati për kërkesat e botës profesionale."

Dhe erdhi prerja e flokut profesionist (zyrtare), simbolikisht gjithshka që deklaronte edhe kostumi zyrtar. Vija e gjerë dhe e prerë e shpatullave të xhaketës përputhej plotësisht me vijën e gjerë dhe të prerë të flokut zyrtar. Ja një flok që mundej dhe do ta kryente punën.

Tradicionalisht, flokët e grave kanë qënë të gjatë dhe rrjedhës. Vizualisht, ai bën një lidhje simbolike midis kokës dhe trupit të saj. Sensualiteti i trupit arrin deri te koka; pasionet e mendjes arrijnë deri te trupi. Prerja zyrtare i dha fund kësaj. Tamam në kohën kur gratë e ndjenin të domosdoshme të thonin, "Vini re, unë jam një krijesë me arsye dhe objektive" përpara kolegëve të tyre seksista, prerja zyrtare bëri dallimin midis kokës dhe trupit. Prerja zyrtare i ndau.

Një dallim i ri klasash ndodhi: gratë ekzekutive mbanin prerjen zyrtare, kurse sekretaret vazhduan të visheshin me rroba seksi dhe të mbanin flokë të lartë. Vini re Melani Grifith me prerjen e saj të re si ekzekutive kurse shoqet e saj sekretare kanë flokë llahtarisht të larta. Kjo nuk do të thotë se gruaja ekzekutive nuk është seksuale, por do kuptuar mesazhi i tyre: "Le të merremi me çështjet e botës dhe pastaj me ato të zemrës." Mirëpo në shtëpi kjo prerje stonon disi, sepse mamaja nuk supozohet të ketë atë pamje për fëmijët e saj.

Kjo prerje ka disa variacione, por të gjitha kërkojnë vëmendje pa u lutur hapur për të. Ato kanë pamjen e përkryer profesionale, duke trafikuar një lloj sensualiteti dhe butësie.

Floku i karierës

Vërtet i lustruar, vërtet profesional ky flok. Ajo çfarë ishte prerja zyrtare për vitet 80-të është floku i karierës për vitet 90-të. Është stili i flokut që për shumë gra përcakton në mënyrë të përkryer se kush je dhe ku qëndron. Floku i karierës është në kulmin e popullaritetit të vet. Më e lartë, më e butë, më e plotë.

Kjo prerje spikat për disa arsye. Fillimisht, nga vitet 80-të, u vendos në përgjithësi se gratë kishin zënë një vend në botën profesionale. Lufta u fitua. Shpatullat që rriheshin, kostumet monokromatike dhe prerja zyrtare nuk ishin më të nevojshme. Ishte koha për të lëvizur. Gratë donin një pamje që të ruante dispilinën e viteve 80-të, por që të kishte parafytyrimin dhe lirinë e viteve 90-të. Ato nuk ishin gati për flokun e egër e të mrekullueshëm. Donin diçka që të merrte frymë, me hierarki dhe lëvizje. Donin diçka që të lirohej pa u zbërthyer, dhe lindi prerja e karierës.

Këtu kishte edhe një strategji të dytë. Gratë donin që floku i ri të fliste edhe për fuqitë e tyre speciale në botën e punës. Njerëzit kërkojnë nga gratë vizion dhe imagjinatë. Pra, le të jetë floku paksa seksi dhe i fuqishëm. Paksa stolisje. Kjo pamje thuhet se ka llustër, një nga përbërësit thelbësorë të suksesit në korsinë e shpejtë. Llustra është një deklaratë vetbesimi, klase dhe stili. Ky stil thotë se kjo grua është marshues, i fuqishëm, i hijshëm në botën e punës. Llustra është një lloj karizme e qetë, një cilësi që funksionon mirë në botën e profesionit.

Vitet 90-të u deklaruan si një dekadë që kujdeset për thjeshtësinë, që refuzon përpunimin dhe stërhollimin, që i kthen kurrizin lluksit. Shqiptari pas 90-ës u lëshua i babëzitur pas parasë, fitimit dhe lluksit, duke harruar edukimin dhe duke mos e kontrolluar veten me botën dhe kulturën globale. Prandaj edhe rezultojmë me një brez që motivin e jetës së vet ka bërë qejfin, deri në atë shkallë sa ngjyrat e flokut dhe stilet përdoren të çoroditura, duke treguar edhe një çoroditje të brendshme karakteri e personaliteti. Kjo është mungesa e kulturës. Refuzimi për kulturë. Kultura për një pjesë jo të vogël të femrave tona është një paketë klishesh që i kanë qëmtuar nga filmat ose koshin e plehrave të botës.

Vitet 90-të marshuan drejt një melodie më të thjeshtë, por moda në flokun profesional po dëgjon në fakt tamburet e veta. I ka lënë larg parametrat nervozë e të ngushtë të viteve 80-të dhe po shtrihet me shprehje të reja, autoritet të ri, hijeshi të re dhe stil tjetër. Rekruti më i famshëm i këtij stili floku ishte Princeshë Diana. Më parë ishte Whitney Houston. Aristokratët mundet që të mos vendosin më modat e reja, por kur ata e ndjekin, kështu bëjnë edhe të tjerët. Shpikja e këtij stili me pakëz hakmarrje brenda u adoptua pothuaj nga të gjitha yjet e Hollivudit: Madonna, Geena Davis, Daryl Hannah dhe Linda Evangelista. Atëhere u deklarua se po të jetë floku më i gjatë tregon më pak fuqi, sepse theksi vihet mbi flokun dhe jo aftësitë, apo inteligjencën.

Burrave në përgjithësi u bën përshtypje kjo prerje. Atyre u duket tërheqëse dhe interesante me një nuancë seksualiteti. Sidoqoftë, edhe paksa kërcënuese. E dinë se është prerje me fuqi. Me mënyra sjelljeje të drejtpërdrejta dhe plot vetbesim. Hëm, rebys. E shohin seksualen, një tip ekoje Monro, por mungon sjellja e varësisë. Nuk dinë se ç'të bëjnë. Ata e shohin si një prerje në modë dhe kjo gjithashtu i ngatërron. Moda është, në përgjithësi, një burim misteri për meshkujt. Në fund të fundit një stil është. Dinë gjithashtu se stili mund t'i

bëjë edhe qesharakë, nëse do t'i qëndronin shumë larg. As burrat e tjerë nuk do t'i merrnin seriozisht. Për burrat moda është diçka që nuk e kuptojnë plotësisht, por që e kuptojnë se duhet ta respektojnë.

Koka e rruar

E shëmtuar? Mashkullore? Vuajtja e gruas mbi kokë? Apo të bën të ndjehesh e lirë? Ja një prerje floku që ose duhet ta duash ose ta urresh. Tingëllon si deklaratë politike: "Unë nuk e pëlqej botën tënde, unë e refuzoj." Apo një mënyrë e nderuar për të mbajtur një qëndrim? Është shumë irrituese, thotë një. Tamam një mënyrë tjetër për të thënë F**k you! Sa më pëlqen një qëndrim i tillë femre. Hapur dhe açik. Që nuk çan asnjë gjë për palën e tretë (të cilën ca na e quajnë opinion) që na i ka bërë çupkat majmunka dhe papagaj. Kokëqethura është e kënaqur sido që të jetë reagimi. Ajo i mirëpret miqtë dhe e di që do të ketë armiq.

Ta lemë politikën. Ky stil kërkon besim. Jo të gjitha mund ta mbajnë. Sigourney Weaver e përdori këtë stil, po ashtu Kirstie Alley. Kurse Sinead O'Connor e ka mbajtur gjatë pjesës më të madhe të karierës së saj. Të tria këto kanë sy të mëdhenj dhe tipare të holla. Ka një interpretim: O'Connor dhe të tjerat duan që ne ta dimë se ato refuzojnë të përdorin mënyrat konvencionale të të menduarit për gratë. Ato besojnë se flokëprerjet konvencionale janë kaq shumë të rrënjosura në kulturën seksiste, saqë nuk mund të mbahen më pa kompromentuar identitetin e mbajtëses. Disa njerëz i qethin flokët zero, jo për atë që përmban ky stil, por për atë që ky stil nuk është.



Disa zeroqethura reagojnë ndaj 'protestave' të grave që pëlqejnë stilet konvencionale duke thënë me emocion se ato mund të jenë shumë mirë femra dhe feministe, por ato, gratë e tjera, e shohin qethjen zero si armiqësore dhe provokuese. Po kush janë ato që duhet të komentojnë se si e shikojmë ne veten si gra?

Pankët e kanë përdorur këtë gjë me entuziazëm. Madje O'Connor merr akoma pusulla prej tyre ku i thonë se ajo duhet të bashkohet me ta. Zeroqethja po fiton shumë popullaritet mes burrave gjë që ka ardhur prej influencës së lordëve të basketbollit Charles Barkley dhe Michael Jordan. Është akoma shumë herët për të thënë se ky stil do ta kalojë kufirin e gjinisë. Disa modele e përdorin për arsyet e tyre. Nganjëherë Parisi mund të bëjë ato, që Hollivudi nuk i bën dot.

Burrat nuk para i honepsin gratë e qethura zero. Supozojnë se gruaja është lezbike. Llogjika e tyre thotë: Gratë mbajnë flokë për të na kënaqur ne. Nëse i presin flokët, kjo duhet të jetë, se ato nuk duan të na kënaqin më, dhe kjo do të thotë që janë fusharake. Ja një nonsens i zakonshëm seksist.

Dita e njëmbëdhjetë

U ngrita në 5.30 am. Avioni nisej në 9.30, por në aeroport bënin kontrolle të imta sipas televizionit për shkak të ngjarjeve në Londër. Do më përcillnin të dyja çupkat e shkollës. Kalimi ishte pa probleme se si duket kontrolli i imtë zbatohej për fluturime drejt Londrës. Dhe ja ku isha, ulur pranë Gate 3, duke pritur orën teksa pija lëng portokalli. Më parë, Valka, me tagrin e diplomates, më shoqëroi deri në një farë pike. "U tregove e mrekullueshme!" Dhe ka qënë, qysh se e njoh, një shoqe e mrekullueshme, në kuptimin e plotë e të drejtpërdrejtë të fjalës.

Fluturimi për në Budapest zgjati një orë. Re të bardha e të vogla, që çuditërisht, po të shikoje me kujdes, formonin fytyra njerëzish të shtrirë, jo të gjallë, të të gjitha kohërave. Çudi, një fytyrë m'u duk si Kastro. S'po u besoja syve. Pashë më me vëmendje. Në përgjithësi ishin njerëz të moshuar, por kishte edhe fëmijë. Njerëz me kapele, çallma etj. Sipas epokave dhe kombësive. Det me njerëz. Gra mondane. Kishte edhe kafshë. Varreza gjigande e kohës. U drodha. Përse ta shoh unë?

Në Budapest më duhej të prisja tre orë, kështu që u ula në një bar të aeroportit, pranë Gate 17, duke pirë një Redbull 6 Eurosh. Fillova vëzhgimet rrotull. Në tavolinën fqinjë, një japonez i lezetshëm se ç'punonte me vegla dhe kufje dhe shkruante. Çfarë janë këta ..ezët ore! I respektoj. Ora 12 pa 15. Ohu, kush priste! E urrej pritjen.

Se nga m'u zhduk një japoneze tip agjenteje, karateiste. Ja kisha ngulur sytë në aeroportin e Varshavës sikur t'i thosha, "Të zbulova!", por ajo ma ktheu me vështrim, "Mos më ça kung-funë!" Në një tavolinë tjetër, gjysëm metri para meje, një grua relativisht e re, me dy çupa të vogla, po ma heqin frymëzimin. (E ktheva në kohën e tashme tregimin se është më emocionale). Kjo grua qenkërka e luajtur! Qenkërka grua! Sy jeshil. Ka veshur një fustan të hollë. Çfarë po bën kjo kështu?! Ububu, turp! E ngriti fustanin siç është ulur dhe ka nxjerrë të brendshmet e zeza. Unë shkruaj çfarë shoh. I shtangur. Duhet të jetë shqiptare. Mos, i rashë në të. Deri tani po flisnin një gjuhë të pakuptueshme për mua, kur gruaja i tha njerës prej çupave, "Çfarë ke ti sot, kështu?!" Si nuk ka turp kjo, o njerii?!Apo nuk të shikon edhe në kokërdhok të syrit. Sytë e vet i ka bërë si dreqi, me bojë jeshile. Ma shpifi. Ndihmë! Oiii! Ajo rrezik ka dalë për punë.

Mbrapa meje, një çun rreth të tridhjetave dhe nja dy vajza rreth njëzetekatër, janë ulur e bisedojnë anglisht. Sapo u hodha sytë e mora vesh që ishin shqiptarë. Ai zullapi ishte nderë në stol gjysëm shtrirë, kishte hapur këmbët dhe kishte vënë një dorë mbi … intimet e tij, fliste anglisht e u jepte mendje dy vajzave, të cilat, në fakt dukeshin që nuk kishin shumë. Shpejt e tradhëtuan veten dhe thanë edhe fjalë shqip. Morali: "O shqiptarë trapa, nuk ju bën gjuha internacionalë e të integruar e me kulturë."

Prit, o prit, se kjo gruaja me çupat e vogla po e tepron. Ngre fustanin deri te turpi. Pse kush jam unë të injorohem kështu? I fus gruas një të pyetur duke e shkruar pyetjen njëkohësisht në fletoren time:

- Në ç'gjuhë flisni me fëmijët? – Më kthen një përgjigje femre, pa lidhje.
- Në ç'gjuhë po flisni tani?
- Finlandisht.
- Aha!
- Po ti ku po shkon? Për punë po shkon? Më pyeti ajo sa për muhabet.

Ku e ka fjalën ajo kur thotë punë? Pyeta veten. Uuu, më marrtë të keqen, më marrtë, vroma!

- Në Shqipëri, - i thashë. Kthehem nga pushimet. – Dhe e theksova fjalën pushimet.

Dhe vazhdova të shkruaj. Ajo po u thoshte çupave se unë isha nga Shqipëria. Vura re se kalamajtë i fusnin nga një "bre" finlandishtes së tyre. Janë veriorë, thashë unë me vete. Bobo, edhe një orë. S'm'u durua dhe e pyeta gruan:

- Nga jeni tamam? –
- Nga Finlanda. –
- Nga jeni me origjinë? –
- Nga Mali i Zi. -

I hoqa të tëra kuriozitetet. Të brendshmet e saj të zeza nuk po i duroja dot më se, pavarësisht se nuk i shikoja, e dija që ishin aty, hapur, tërë rënkim. U largova i pështirosur. M'u dha të mendoja se çfarë pashë ishte shoqëria jonë moderne pa kozmetikë, si puna e rrugicave prapa pallateve. Më në fund porta u hap dhe shkova në avion. Vendi im ishte nga ana e korridorit. Para meje ishte një grua e re me një çupë rreth 5-6 vjeç, të cilën ajo e vuri në mes dhe vet u ul nga ana e dritares. "Kjo është mama', thashë me vete. Pastaj çupa u mbështet te krahu i së ëmës si për të fjetur dhe ktheu tytën e topit nga unë. Dhe, pa dyshim, lëshoi një tymëse. Përse nuk ulërita, unë e di. Kaq llahtar i vërtetë ishte sa këtej e tutje të mitë do t'më duken ekzotike.

Kur erdhi ushqimi, sanduiçi i zakonshëm, gruaja as që u interesua për të bijën, t'i hapte sanduiçin, apo ta pyeste se çfarë donte për të pirë. Hante vetë si e babëzitur dhe më bëri të mendoj me një mirëkuptim të madh se sigurisht gratë vetëm fatin kanë të keq, kurse kusuret i heqin të tjerët. M'u desh mua të merresha me çupkën e vogël e të pafajshme. Vajza nuk e mbërtheu mirë gotën plastike me koka-kola dhe lëngu u derdh mbi pantallonat e mia. Arsenali i sharjeve për atë grua më erdhi paketë e plotë dhe në shumë gjuhë, por, sa çudi, u përmbajta. "Budallaçkë, i thoshte gruaja vajzës, përse s'e mbajte fort?"

Në Rinas më priste kunati, por edhe një çudi. Pasaporta ime e re dilte në kompjuter me dy emra. U desh një ndërhyrje dhe kalova. Një peripeci me një polic rrugor dhe heroi mbërriti i lodhur në shtëpi mbasditen e një të shtune.

I terezitur në një kolltuk, po shikoja në darkë vonë, një film me Tom Hanksin hipokondriak. Dhjetra burra kalojnë dhe nuk e shkelin një lule margaritë në mes të rrugës. Një këmbë e vetme gruaje kalon dhe e bën lulen petë. Po pse o autor amerikan e bën këtë film? Për shkakun tuaj, shumë gra do të thonë 'sa i urreka ky gratë!' e do të spekullojnë. Mendo. Dhe, në restorant me Megin, tre sombrero i këndojnë asaj. Jeta është një varkë ku ti i bën të tëra. E pajisur kjo varkë mirë ose jo, si të të ketë rënë në pjesë ose si e ke patur durimin për ta ndërtuar vetë. I zoti ose jo për ta vozitur këtë varkë të jetës tënde, varet nga ty. Destinacioni? Një takëm e marrin vesh në rrugë e sipër kurse një takëm e kanë shënuar në hartën e ambicieve dhe ëndërrave të tyre. Drejtimi? Instinkti? Pyet veten. Pak njerëz rrinë zgjuar. Gati të gjithë flenë. Tom Hanks e di që do të vdes për pak muaj. Po si do të jetë vallë të jetosh duke e ditur që do të vdesësh së shpejti? Po si do të ishte po të jetoje i vdekur?

Natë e paanë. Qiell i paanë. Yje pa anë. Det i paanë. Dhe ata në mes, si perlë në guaskë. A do të vije e dashur me mua atje, në mes ujit dhe ajrit? Bien yje, bien yje. Ti këndon. Deti bëhet jeshil ndërsa afrohet. Duhet të mos harrojmë të falenderojmë për jetën që kemi. Ndërkohë mos ndaloni së ndezuri një qiri për mua sa herë t'ju jepet rasti. A po jo, e dashur?

Larg gjërave të njeriut!

Poloni, Gusht 2006

Shënim i autorit:

Çfarë jemi ne? Po të isha mekanik, mekanik poet, do të thoshja: “Ne jemi dado të salduara fatalisht në makinën e çmendur të kohës, kurse poetët “Engjëj që nuk gjejnë karar”.

Miq, kur na i thonë gjërat drejt, ashtu si janë, na vjen hidhur dhe kërkojmë nëpër shkrim diçka që të na përjashtojë. Kur përjashtimin nuk e gjejmë atëhere ne ulërijmë. Ky libër është si ai imazhi që kanë të tjerët për ty. Mendova që njeriu është mirë ta dijë, pastaj le të zgjedhi rrugën që do, njeriun që do, jetën që do. Të gjithë e dinë dhe të gjithë e shohin. Përse të mos thuhet publikisht kur mes tonë i analizojmë? Nuk është aq keq sa duket? Spekulloj? Jam negativ? Jam humbës? Jo, jam i çiltër dhe i brengosur.

Nëse, sidoqoftë, ju mendoni se jeni përfshirë, lexoni rregullin 26 që ju përjashton shprehimisht. Në rast se nuk doni të përjashtoheni, ju jeni një njeri i ndershëm, ose doni të gërriceni.

Ju dua të gjithëve dhe një e nga një.

Vladimir